



RAPORT VJETOR 2021

MESAZHI I KRYETARIT TË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE	4
HYRJE.....	6
1. STRATEGJIA AUTORITETIT	10
2. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËSHUARA NË REZOLUTËN E KUVENDIT PËR RAPORTIN VJETOR TË AUTORITETIT, PËR VITIN 2021.....	12
3. MASAT E MARRA NË ZBATIM TË REKOMANDIMEVE TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONE TË TJERA KUSHTETUESE OSE TË PAVARURA NDAJ AUTORIT	20
4. REKOMANDIMET E LËSHUARA NË PROGRES-RAPORTIN E BE-së DHE DETYRIME TË TJERA NDËRKOMBËTARE NDAJ AUTORITETIT.....	22
5. TË DHËNA LIDHUR ME AKTIVITETIN E AUTORITETIT PËR KRYERJE INSPEKTIMESH OSE HETIMESH ADMINISTRATIVE, VENDIME TË SANKSIONEVE ME GJOBË NË RAPORT ME VITET E FUNDIT.....	23
6. QEVERISJA E AUTORITETIT	27
6.1 Vendimmarrja mbi licencat/autorizimet	27
6.2 Ecuria e proceseve gjyqësore	29
7. AUTORITETI SI RREGULLATOR PËR NJË TREG AUDIOVIZIV TË PËRGJEGJSHËM	31
7.1 Shqyrtimi tematik i përmbajtjeve të emetuara	31
7.2 Monitorimet e përmbajtjeve	34
7.3 Qasja ndaj fenomenit të piraterisë në transmetimet audiovizive	39
8. KËSHILLI I ANKESAVE.....	40
9. AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË ZBATUESHMËRISË LIGJORE.....	43
9.1 Referencat ligjore mbi të cilat mbështetet aktiviteti i institucionit	43
9.2 Plotësimi i akteve nënligjore të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të OSHMA-ve.....	43
9.3 Nevoja për ndryshime të kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e institucionit.....	44
9.4 Mbikëqyrja e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave.....	45
10. AUTORITETI SI NXITËS I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT AUDIOVIZIV	55
10.1 Angazhimi i Autoritetit në zhvillimet teknologjike të tregut audioviziv	55
10.2 Kontributi i Autoritetit në mbështetje të studimeve shkencore.....	56
11. TRANSMETIMET NUMERIKE.....	58
11.1 Lirimi i brezit të Dividendit Digjital.....	58
11.2 Kompensimi financiar	58
11.3 Kontrata AMA – RTSH	60
11.4 Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave	62
11.4.1 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audiovizive	62
11.4.2 Koordinimi i frekuencave të brezit audioviziv.....	64

11.4.3	Planifikimi i frekuencave për shërbimet audio.....	66
11.5	Adresimi i interferencave të shkaktuara nga operatorët audio/audiovizive	67
12.	AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË TRANSPARENCËS DHE RRITJES SË IMAZHIT INSTITUCIONAL.....	69
12.1	Organizimi i brendshëm i institucionit	69
12.2	Programi i transparencës	70
12.3	Aktivitete të Autoritetit.....	70
12.4	AMA në bashkëpunim me partnerët.....	74
12.5	Marrëveshjet e bashkëpunimit	77
12.6	Publikimi i Buletinit Periodik të AMA-s.....	78
12.7	Menaxhimi i performancës së burimeve njerëzore.....	79
13.	TREGUESIT FINANCIARË DHE MENAXHIMI I BURIMEVE	80
13.1	Menaxhimi i burimeve financiare.....	80
13.2	Realizimi i burimeve të financimit në vitin 2021	80
13.3	Detyrimet financiare të OSHMA-ve.....	84
13.4	Përdorimi i burimeve financiare në vitin 2021.....	85
13.4.1	Shpenzimet dhe investimet në vitin 2021	85
13.4.2	Ecuria e investimeve	87
13.5	Pasqyrat Financiare	88
ANEKS 1.....		91
ANEKS 2.....		102

MESAZHI I KRYETARIT TË AUTORITETIT TË MEDIAVE AUDIOVIZIVE

E nderuar znj. Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë,

Të nderuar anëtarë të Komisionit Parlamentar për Edukimin dhe Mjetet e informimit Publik,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Shqipërisë,

Viti 2021 pasoi një vit jo fort të zakonit për shoqërinë në tërësi dhe, rrjedhimisht, edhe për operatorët audio dhe audiovizivë në vendin tonë. Situata dhe pasojat, me të cilat na përballi Pandemia e COVID-19, ishin të pranishme në veprimtarinë e secilit prej nesh dhe institucioneve tona. Gjatë vitit të shkuar, një meritë të madhe kanë të gjitha OSHMA-të, të cilat treguan gatishmëri në transmetimin pa pagesë të njoftimeve nga autoriteti shëndetësor, si pjesë e fushatës së informimit dhe ndërgjegjësimit të publikut në kushte të pazakonta, duke ndikuar drejtpërdrejt në përballimin e pasojave nga COVID-19. Operatorët audio dhe audiovizivë, gjithashtu, u angazhuan në informimin pa ndërprerje të situatës epidemiologjike në vend dhe masave që duheshin mbajtur parasysh nga publiku.

Autoriteti i Mediave Audiovizive, për herë të parë që nga themelimi i tij, 21 vite më parë, u angazhua në monitorimin e mbulimit mediatik, nga OSHMA-të, të fushatës elektorale për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të datës 25 prill 2021. Realizimi i kësaj detyre mund të konsiderohet, pa frikë, një proces i suksesshëm jo vetëm për faktin se raportet e AMA-s ishin burim reference për raporte të monitoruesve vendas dhe ndërkombëtarë, por, mbi të gjitha, sepse nuk pati asnjë kundërshtim të gjetjeve prej operatorëve audio dhe audiovizivë.

Në zbatim të detyrave dhe funksioneve të AMA-s, të përcaktuara në ligjin nr. 97/2013, në Strategjinë dhe Planin e Veprimit të Autoritetit për vitet 2021-2023, Autoriteti ka vijuar punën me monitorimin e përmbajtjeve audiovizive të transmetuara nga OSHMA-të. Për shkak të situatës pandemike, një vëmendje e shtuar i është kushtuar transmetimeve me këtë temë, me fokus reklamat për medikamentet, apo trajtimin të çështjeve shëndetësore, në përgjithësi.

Mbrojtja e fëmijëve, nga përmbajtjet e papërshtatshme, ka vijuar të jetë një ndër përparësitë tona gjatë monitorimit të transmetimeve audiovizive. Përpos kësaj, jemi angazhuar edhe në veprimtari gjithëpërfshirëse, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe mendimeve, mbi zhvillimet më të fundit në këtë fushë, por dhe nevojave për t'i shërbyer sa më mirë publikut dhe sidomos fëmijëve, përmes transmetimeve audio/audiovizive. Andaj, gjatë vitit raportues organizuam një konferencë ndërkombëtare me temë “Mbrojtja e fëmijëve në mediat audiovizive”. Kjo konferencë, në të cilën referuan ekspertë nga Britania e Madhe, Belgjika, Gjermania, si dhe profesorë e ekspertë të fushës nga vendi dhe rajoni, shërbeu si një platformë e mirë mendimi dhe shkëmbimi informacioni mbi përmirësimin e punës sonë, por, mbi të gjitha, mbi normat dhe vlerat që duhen mbajtur parasysh gjatë raportimeve për fëmijët.

Autoriteti ka vijuar praktikën e bashkëpunimit dhe mbështetjes së partnerëve në sektorin audio dhe audioviziv në vendin tonë, me qëllim ndërveprimin me publikun për të kryer matje dhe studime të nivelit të

njohurive, pritshmërive dhe kërkesave të tij. Me mbështetjen e AMA-s kanë ardhur në shqip një sërë botimesh të cilat i shërbejnë studiuesve të fushës, stafeve pedagogjike, studentëve dhe publikut të interesuar.

Lirimi i brezit frekuencor 700 MHz (Digjital Dividend 2), ka marrë një vëmendje të posaçme gjatë vitit raportues. Për këtë proces, i cili duhet të finalizohet brenda muajit qershor 2022, AMA është angazhuar maksimalisht, përmes ndërtimit të një agjende takimesh bilaterale, me vendet fqinje në rajon, si dhe tryezash e diskutimesh me të gjitha grupet e interesit brenda vendit. Në fund të vitit të shkuar, AMA miratoi Planin Numerik Frekuencor (pa përfshirë brezin 700 MHz) për transmetimet audiovizive numerike tokësore në Republikën e Shqipërisë dhe inicioi procesin e koordinimit të brezit UHF me vendet fqinje, proces që është ende në zhvillim e sipër.

Një fokus i veçantë, gjatë vitit raportues, i është kushtuar forcimit të bashkëpunimit me institucionet homologe në rajon dhe me organizmat ndërkombëtare ku aderohet AMA.

Për sa i përket ankesave, të mbërritura në institucion nga individë, shoqata e organizata të shoqërisë civile, vlen të theksojmë se ka pasur një fluks të shtuar. Krahasuar me një vit më parë, kur në institucion kanë mbërritur 120 ankesa, gjatë këtij viti kemi shqyrtuar mbi 300 të tilla. Krahas ankesave, Autoriteti ka ndjekur një politike proaktive në qasjen ndaj OSHMA-ve në lidhje me zbatimin e detyrimeve që parashikon ligji dhe Kodi i Transmetimit.

Raporti vjetor, që po ju paraqesim, tregon punën e detajuar të Autoritetit, gjatë vitit 2021, bazuar në objektivat specifike dhe funksionet institucionale, në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi.

Autoriteti do të vijojë punën, me përkushtim e profesionalizëm, në përmbushje të rolit dhe misionit të tij si rregullator i transmetimeve audio dhe audiovizive në vendin tonë.

Ju faleminderit për vëmendjen Tuaj!

HYRJE

Në përmbushje të detyrave dhe funksioneve të AMA-s, të përcaktuara në ligjin nr. 97/2013, në Strategjinë dhe Planin e Veprimit të Autoritetit, për vitet 2021-2023, si dhe në përmbushje të rekomandimeve të Bashkimit Evropian dhe Kuvendit të Shqipërisë, gjatë vitit 2021, Autoriteti është angazhuar maksimalisht t'i shërbejë shoqërisë shqiptare përmes rregullimit, mbështetjes dhe nxitjes së tregut audioviziv të përgjegjshëm dhe cilësor.

Në vitin 2021 ka pasur një gjendje më të përmirësuar, sa i përket pandemisë COVID-19, e megjithatë, Autoriteti ka vijuar monitorimin për zbatimin e masave dhe protokolleve të Ministrisë së Shëndetësisë, për parandalimin e përhapjes së infeksionit, të shkaktuar nga COVID-19, në radhët e personelit që angazhohet brenda mjediseve të redaksive e studiove të regjistrimit dhe transmetimit, si dhe respektimin e kufizimeve për pjesëmarrjen e publikut në programet audiovizive të drejtpërdrejta ose të regjistruara.

Vlen për t'u theksuar se të gjitha OSHMA-të kanë treguar gatishmëri në transmetimin pa pagesë të njoftimeve nga autoriteti shëndetësor, si pjesë e fushatës së informimit dhe ndërgjegjësimit të publikut në kushte të pazakonta, duke ndikuar drejtpërdrejt në përballimin e pasojave nga COVID-19. Redaksitë e OSHMA-ve, gjatë periudhës raportuese, janë angazhuar, përmes reporterëve, redaktorëve dhe moderatorëve, për të informuar pa ndërprerje mbi situatën epidemiologjike në vendin tonë, por dhe duke trajtuar dhe analizuar aspekte të ndryshme, që lidheshin me aktualitetin dhe sfidat në përballjen me pandeminë. AMA ka mbajtur një qasje proaktive, duke komunikuar rast pas rasti, me operatorët, në lidhje me respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga ligji 97/2013, i ndryshuar, për rastet e raportimeve, bisedave dhe debateve në studio, emisioneve të ndryshme për sa i përket përcjelljes së mesazheve, që i shërbejnë informimit të saktë dhe shterues për situatën, duke shmangur panikun e popullatës.

Në procesin e monitorimit të përmbajtjeve audiovizive të transmetuara, AMA është fokusuar më shumë, gjatë vitit 2021, te reklamat mbi medikamentet, si dhe te emisionet për shëndetin. Situata e krijuar nga pandemia COVID-19 ka shtuar kohën programore nga OSHMA-të për aspekte të shëndetit. Duke u nisur nga interesi për mbrojtjen e qytetarëve nga abuzimet me transmetimet mbi këtë temë, AMA ka realizuar shqyrtime me fokus reklamat për medikamentet, apo të trajtimit të çështjeve shëndetësore në përgjithësi. Përrastet e reklamave të fshehura, kur nuk janë zbatuar kërkesat e rregullores “Për komunikimet audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare, format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e reklamave”, si dhe kuadrit nënligjor në fuqi që normon publicitetin e barnave, Autoriteti ka tërhequr vëmendjen e OSHMA-ve, si dhe ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me Agjencinë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore. Mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e papërshtatshme ka vijuar të jetë në fokus të monitorimit të përmbajtjeve audiovizive.

AMA ka kërkuar periodikisht nga OSHMA-të që të mbulojnë, në mënyrë të vërtetë, të paanshme dhe objektive, temat që lidhen me pandeminë COVID-19. Duke vlerësuar maksimalisht rolin dhe kontributin e redaksive audiovizive, në përmbajtjet e transmetuara mbi aktualitetin dhe analizat mbi trajtimin e situatës, AMA i ka ftuar ato të mbajnë parasysh interesat e publikut, balancën në paraqitjen e opinionëve, krijimin e hapësirave për ekspertët e mirëfilltë të fushës. Autoriteti, si institucion rregullator, ka kërkuar shmangien e fenomeneve të tilla si konfuzioni apo deformimi i rezultateve shkencore të konfirmuara, ka nxitur

zgjerimin/balancimin e paraqitjes së ideve dhe opinioneve, duke shmangur forume debati vetëm me individë jo ekspertë të fushës, të cilat krijojnë paqartësi dhe pasiguri te ndjekësit e programeve audiovizive.

Për herë të parë, në 21 vite aktivitet, AMA u angazhua drejtpërdrejt në monitorimin e mbulimit mediatik të OSHMA-ve, gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet e përgjithshme parlamentare të datës 25 prill 2021. Më herët, AMA vendoste në dispozicion të KQZ-së infrastrukturën e saj monitoruese. Monitorimi i pasqyrimin të fushatës zgjedhore mund të konsiderohet pa frikë një proces i suksesshëm, jo vetëm për faktin se raportet e AMA-s ishin burim reference për raporte të monitoruesve vendas dhe ndërkombëtarë, por, mbi të gjitha, sepse nuk pati asnjë kundërshtim të gjetjeve prej operatorëve audio dhe audiovizivë.

Prej muajit mars 2021, AMA e ka ushtruar aktivitetin e tij administrativ me 4 anëtarë, 3 prej të cilëve u ka përfunduar mandati. Ky fakt ka krijuar ngërç në punën e AMA-s, për shkak të pamundësisë për miratimin e vendimeve të cilat kërkojnë shumicë të cilësuar (5 vota).

Referuar përcaktimeve ligjore, AMA lëshon dhe heq licencat dhe autorizimet me shumicë të cilësuar. Mungesa e kuorumit të nevojshëm ligjor ka bërë të pamundur vendimmarrjet për marrje licence, rinovim dhe heqje të licencave/autorizimeve.

AMA, pavarësisht mungesës së anëtarësisë së plotë, ka vijuar të ushtrojë kompetencat dhe funksionet që i ngarkon ligji organik, për çështjet brenda fushës së kompetencës, si plotësimi i kuadrit nënligjor, monitorimi i përmbajtjeve programore, shqyrtim i kërkesave të ndryshme drejtuar autoritetit, vijimi i procedimeve të ndryshme administrative, shqyrtimi i aplikimeve edhe kërkesave për marrje licence/autorizimi etj.

Në tetor të vitit 2021, AMA zhvilloi Konferencën Ndërkombëtare me temë “Mbrojtja e fëmijëve në mediat audiovizive”. Konferenca ishte konceptuar dhe organizuar në tre panele diskutimi në të cilat referuan ekspertë nga Britania e Madhe, Belgjika, Gjermania si dhe profesorë e ekspertë të fushës nga vendi dhe rajoni.

Zhvillimi i veprimtarive ka qenë një sfidë për vitin 2021, pasi frika për përhapjen e virusit Covid-19 dhe masat e qeverisë, për minimizimin e grumbullimeve, kanë ulur ritmin e organizimit të veprimtarive në mjedise të mbyllura dhe me praninë e shumë pjesëmarrësve. Pavarësisht këtyre pengesave, AMA ka zhvilluar një sërë veprimtarish dhe takimesh me homologë/grupe interesi apo bashkëpunëtorë duke respektuar protokollin e COVID-19.

Autoriteti, gjatë vitit 2021, ka vijuar praktikën e bashkëpunimit dhe mbështetjes së partnerëve në sektorin audio dhe audioviziv në vendin tonë. Autoriteti i Mediave Audiovizive ka financuar një sërë projektesh, disa prej të cilave janë konkretizuar me botime librash apo broshurash. Botimet e fundit, që i janë shtuar bibliotekës së AMA-s dhe gjithë palëve të interesuara, janë: "Teknologjia e transmetimeve audio/audiovizive në kohën digjitale"; "Post-Truth": "Lufta e re kundër së vërtetës dhe si t'i kundërpërgjigjemi"; "Gazetaria në demokraci"; "Historia e mediave – nga fillimet e deri në ditët e sotme"; "Komunikimi politik online - si ta përdorim web-in për të ndërtuar konsensusin dhe nxitje pjesëmarrjen?"; "Studime Albanologjike - Gazetaria tradicionale përballë audiencave të reja; "Rregullimi i nivelit maksimal të volumit në transmetimet audiovizive"; "Dezinformimi/Lajmet e rreme" (identifikimi i problemeve që lidhen me dezinformimin/lajmet e rreme në mediat audiovizive); "Kodi i transmetimit dhe të rinjtë, sa dhe si e njohin

atë”; “Materiale të ndryshme studimore mbi administrimin e frekuencave”; “COVID-19: Adresimi i ndikimit të dezinformacioneve dhe teorive konspirative përmes edukimit mbi median dhe informacionin”; “Mediat dhe zgjedhjet - Sfidat në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni e Veriut”.

Autoriteti i Mediave Audiovizive është pjesë e Aleancës Kundër Gjuhës së Urrejtjes, në përbërje të së cilës janë katër institucione dhe një organizatë jo-fitimprurëse. Gjatë vitit 2021, Aleanca ka vijuar takimet dhe diskutimet mbi dukurinë e gjuhës së urrejtjes dhe pasojat e saj në shoqëri. Gjithashtu, në bashkëpunimin me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është ndërmarrë një fushatë sensibilizuese për të sfiduar urrejtjen dhe diskriminimit në media, me qëllim ndërgjegjësimin e sa më shumë aktorëve apo elementëve të shoqërisë shqiptare.

Në kuadër të masave të ndërmarra për lirimin e brezit të brezit frekuencor 700 MHz (Digital Dividend 2), i cili duhet të finalizohet brenda muajit qershor 2022 (referuar vendimeve të organizmave ndërkombëtarë) AMA, gjatë periudhës raportuese, është angazhuar maksimalisht, duke marrë pjesë në takime bilaterale me Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, Greqinë, Kroacinë, Kosovën dhe me vende të tjera fqinje, për t'i informuar mbi ndryshimet e ndodhura në Planin e ri Numerik Frekuencor të Shqipërisë, si dhe për të kërkuar angazhimin e tyre maksimal në përshtetjen e procedurave të koordinimit.

AMA, në muajin nëntor 2021, miratoi Planin Numerik Frekuencor (pa përfshirë brezin 700 MHz) për transmetimet audiovizive numerike tokësore në Republikën e Shqipërisë dhe në zbatim të këtij vendimi, inicioi procesin e koordinimit të brezit UHF me vendet fqinje, proces që është ende në zhvillim e sipër.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar edhe përmirësimit të aseteve teknike pranë studios së monitorim/arshivës. Gjatë vitit 2021 u bë i mundur instalimi i pajisjeve të reja për regjistrimin e subjekteve audio, në të gjithë territorin e vendit. Falë këtij investimi, AMA, tashmë mund të ndjekë, në kohë reale, tërësinë e programeve që transmetojnë të gjithë subjektet audio FM lokale, rajonale apo kombëtare. Gjithashtu, në funksion të monitorimit të proceseve zgjedhore, u investua në sektorin e përpunimit të të dhënave në periudhën zgjedhore, duke bërë të mundur blerjen e një softi për përpunimin e të dhënave sasiore të subjekteve audio dhe audiovizive në transmetim. Programi u ndërtua mbi bazën e kërkesave dhe rekomandimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në Metodologjinë për monitorimin e zgjedhjeve.

Në zbatim dhe të rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë, gjatë vitit 2021, AMA ka lidhur 2 marrëveshje bashkëpunimi me institucione, aspektet e punës së të cilave lidhen me fushën e veprimit të Autoritetit, me qëllim krijimin e hapësirave dhe lehtësimin e formave të koordinimit të punës.

Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare nënshkruan, në datë 03.11.2021, Memorandumin e Bashkëpunimit me qëllim garantimin dhe mbështetjen operacionale, teknike dhe ligjore në fushat me interes të përbashkët për të dyja palët.

Gjithashtu, është nënshkruar Marrëveshja e Mirëkuptimit “Mbi bashkëpunimin dhe ndërveprimin ndërinstitucional” midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA). Në zbatim të kësaj marrëveshjeje, më datë 07.06.2021, midis palëve është nënshkruar Kontrata e Shërbimit me objekt “Ndjekja/Pjesëmarrja në grupet studimore të ITU-së, që trajtojnë çështjet rregullatore, teknike, të transmetimeve audio/audiovizive”. Ky material do t'i vijë në ndihmë AMA-s, për përgatitjen paraprake mbi çështjet që do të diskutohen dhe miratohen në Konferencën Botërore të Radiokomunikacionit (WRC) e cila

do të zhvillohet në vitin 2023, çështje për të cilat administrata shqiptare, si anëtare me të drejta të plota në ITU, do të ketë vendimmarrje.

Në fokus të veçantë, gjatë vitit raportues, ka qenë forcimi i bashkëpunimit mes institucioneve homologe, në rajon dhe më gjerë. Në këtë drejtim, përfaqësuesit e AMA-s, gjatë vitit 2021, kanë marrë pjesë në më shumë se 37 konferenca, takime, tryeza diskutimi brenda e jashtë vendit, me homologët dhe bashkëpunëtorët për tema që lidhen me veprimtarinë e autoritetit. Po ashtu, gjatë vitit 2021, AMA, si në vitet e mëparshme, ka mbajtur kontakte të vazhdueshme me homologët, në kuadër të pjesëmarrjes në organizmat evropiane apo rajonale të medias audiovizive, si EPRA, ERGA, BRAF, MNRA, REFRAM etj.

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Armela Krasniqi, në muajin korrik, ka zhvilluar një takim prezantues me Përfaqësuesen e Lartë për Lirinë e Medias në OSBE, Vjenë, znj. Teresa Ribeiro. Gjatë këtij takimi, Krasniqi u ndal në shtyllat kryesore të aktivitetit të Autoritetit, si mbrojtja dhe të drejtat e fëmijëve, mbrojtja e gazetarëve, të drejtat e autorit, transpozimi i direktivës AVMS 2018/1808 të BE-së dhe në çështje të tjera të hapësirës mediatike, të cilat kërkojnë vëmendje në vijimësi.

Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, edhe gjatë vitit 2021 dhe vijimit të pandemisë së krijuar nga Covid-19, në përmbushje të detyrave, objektivave të përcaktuara, angazhimeve dhe rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë, ka vijuar mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit të Transmetimit dhe të rregulloreve të miratuara nga AMA.

Gjatë gjithë periudhës raportuese, Këshilli i Ankesave ka shqyrtuar mbi 300 ankesa, të ardhura nga individë, shoqata e organizata të shoqërisë civile. Pjesa më e madhe e shqetësimeve dhe ankesave të ardhura kishin si objekt të tyre shkeljen e të drejtave të njeriut, të normave ligjore dhe etike, shkeljen e të drejtave të fëmijëve, cenimin e dinjitetit, si dhe disa ankesa të shtuara ndaj rrjeteve sociale, portaleve dhe gazetave.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Këshilli i Ankesave u ka tërhequr vëmendjen operatorëve në 22 raste; në dy raste u ka kërkuar atyre zhvendosjen e orarit të transmetimit për dy seriale filmike, sipas përcaktimeve të Kodit të Transmetimit. Operatorët reagues në kohë të shpejtë, duke marrë në konsideratë respektimin e kërkesave dhe normave etike të Kodit të Transmetimit.

1. STRATEGJIA AUTORITETIT

Strategjia dhe Plani i Veprimit të Autoritetit janë miratuar nga AMA me Vendimin nr. 94, datë 14.10.2020.

Plani i Veprimit përcakton objektivat strategjike të Autoritetit për periudhën 2021-2023, duke marrë në konsideratë faktin se ka objektiva të cilat zgjaten në kohë, përderisa përkojnë me procese të vijueshme të punës së Autoritetit, për shkak të zhvillimeve të reja apo ndryshimeve a përmirësimeve të kuadrit ligjor. Qëllimet strategjike të Autoritetit, të cilat do të mbulojnë periudhën trevjeçare 2021-2023, shoqërohen me objektivat specifike, si më poshtë:

1. Sigurimi dhe nxitja e diversitetit dhe pluralizmit:

- a. Krijimi i lehtësirave në ofrimin e një panorame mediatike pluraliste dhe pasqyrimi i vlerave, aspiratave dhe identitetit të shoqërisë shqiptare, nëpërmjet nxitjes së debatit demokratik dhe gjithëpërfshirjes.
- b. Nxitja e promovimit të prodhimit programor audioviziv cilësor në gjuhën shqipe, si dhe sigurimi i rritjes së shumëllojshmërisë së shërbimeve audiovizive nga OSHMA-të publike dhe private.
- c. Mbrojtja e pluralizmit nga AMA, nëpërmjet forcimit të mbikëqyrjes dhe rregullimit të shërbimeve transmetuese, marrëveshjeve për licencimin e OSHMA-ve, si dhe, në veçanti, çështjet e pronësisë dhe kontrollit të OSHMA-ve.

2. Përmirësimi i cilësisë dhe efektivitetit të rolit të mbikëqyrjes dhe rregullimit:

- a. Përmirësimi i zbatueshmërisë së kodeve dhe rregullave të transmetimit, njohja e përballimi i sfidave të rregullimit, përkatësisht amendimi dhe hartimi i legjislacionit, krahas ndryshimeve të hovshme teknologjike, në harmoni me legjislacionin e BE-së, si dhe mënyrat dhe format e zbatimit të tyre në praktikë.
- b. Riaktivizimi i iniciativës së AMA-s dhe koordinimi i tërësishëm, me të gjithë faktorët institucionalë, në luftën kundër piraterisë dhe në mbrojtjen e të drejtave të autorit.
- c. Vijimi i mbikëqyrjes së zbatimit të Kontratës së Shërbimit të lidhur me RTSH-në, duke nxitur zhvillimin e mëtejshëm të saj përmes garantimit të konkurrencës së ndershme, në përputhje me kriteret e parashikuara në ligj.

3. Qasje proaktive për transmetime audiovizive të përgjegjshme:

- a. Hartimi dhe realizimi i një sërë veprimtarish që promovojnë edukimin mediatik, duke nxitur aftësinë e audiencave për të vlerësuar dhe kuptuar përmbajtjet audiovizive, në një mjedis mediatik në zhvillim.
- b. Realizimi, organizimi, mbështetja dhe nxitja e kërkimit, duke përfshirë bashkëpunimin me publikun, transmetuesit dhe palët e tjera të interesuara, për të pasur një përfshirje aktive në çështjet e rregullimit të transmetimeve audiovizive.

4. Ngritje e kapaciteteve dhe mirëqeverisje:

- a. Rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë së rregullatorit, nëpërmjet fuqizimit të besueshmërisë së publikut, duke zbatuar procese dhe procedura, që janë të hapura e të kontrollueshme, si dhe duke publikuar raportime të qarta e periodike mbi punën e tij, me vëmendje të veçantë ndaj procesit të monitorimit të ankesave.
- b. Vijimi i lehtësimit të barrës burokratike, për subjektet që Autoriteti licencon/ autorizon, duke kërkuar mënyra më efikase për të arritur qëllimet e tij.
- c. Ngritja e kapaciteteve të institucionit nëpërmjet trajnimit të stafit aktual apo nëpërmjet shkëmbimit të praktikave të mira me autoritetet rregullatore rajonale, evropiane etj.
- d. Përmirësimi i përdorimit të teknologjisë së informacionit, për të shmangur rreziqet e mundshme nga sulmet apo hyrjet e paautorizuara në sistemin TIK, si dhe për rritjen e efikasitetit dhe qasjes në publik.

2. ZBATIMI I REKOMANDIMEVE TË LËSHUARA NË REZOLUTËN E KUVENDIT PËR RAPORTIN VJETOR TË AUTORITETIT, PËR VITIN 2021

1) Pas finalizimit me sukses të procesit të digjitalizimit në Republikën e Shqipërisë, AMA të ndjekë në vijim shqetësimet e operatorëve lokalë, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të duhura të problematikave të ngritura nga operatorë lokalë.

Problematikat e operatorëve lokalë kanë qenë pjesë e rekomandimeve drejtuar Autoritetit në raportet e mëparshme vjetore, problematika të cilat buronin kryesisht nga procesi i digjitalizimit.

Disa nga problematikat dhe çështjet e parashtruara prej përfaqësuesve të operatorëve lokalë, në takimet e zhvilluara dhe në komunikimet shkresore, lidhen me tarifat e larta dhe të pambështetura në kosto të aplikuara nga Radio Televizioni Shqiptar (RTSH) për mbështetjen në rrjetin numerik, rishikimin e tyre, procedurat burokratike për procesin e kompensimit të pjesshëm financiar (sipas ligjit nr. 34/2017 “Për lirimin e brezit të Digjital Dividendit”, të ndryshuar), shpërndarjen e reklamës shtetërore, pajisjen me frekuencë lokale në secilin allotment, tarifat e të drejtës së autorit, ndryshimin e zonës së ofrimit të shërbimit për shkak të mbështetjes së programeve të tyre në rrjetet private kombëtare të transmetimit etj.

Sikurse është raportuar, nga ana jonë, në raportimet periodike dhe vjetore, në takimet e zhvilluara nga AMA, me qëllim gjetjen e zgjidhjeve të problematikave të ngritura nga operatorët, janë ftuar të marrin të marrin pjesë operatorët lokalë, operatori publik si dhe përfaqësues të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Sa i përket tarifave të mbështetjes në rrjetin numerik të RTSH-së, theksojmë se në nenin 122, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se tarifat e mbështetjes në rrjetin numerik, të cilat duhet të hartohen bazuar në parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit, propozohen nga RTSH dhe miratohen nga AMA.

RTSH, në përgjigje të kërkesave të AMA-s, ka informuar që procesi i rishikimit të tarifave të mbështetjes do të kryhet pas përfundimit të transmetimeve analoge në gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, duke bërë me dije se llogaritja e tarifave do të bazohet në kostot reale të vënies në funksionim të rrjetit të RTSH-së, në ndryshim nga tarifat e aplikuara deri tani.

AMA kishte parashikuar të niste procesin e rishikimit të tarifave nga RTSH, duke qenë se, në fund të vitit 2020, përfundoi procesi i digjitalizimit të transmetimeve audiovizive. Ndërkohë, në kuadër të procesit të lirimit të brezit DD2, në përfundim të asistencës teknike të ofruar nga ITU, në bashkëpunim me rregullatorin hungarez, është miratuar nga AMA, në 26 nëntor 2021 plani i ri numerik frekuencor (pa përfshirë brezin DD2).

Duke qenë se procesi i lirimit të brezit DD2 do të shoqërohet me ndryshime në kushtet e licencës të operatorëve lokalë/rajonale/kombëtare, sikurse ndryshimi i zonës së shërbimit, ndryshimi i parametrave teknikë të transmetimit dhe, për pasojë, edhe me ndryshim të detyrimeve financiare, AMA vlerëson që procesi i rishikimit të tarifave të ndërmerret pas finalizimit të procesit të lirimit të brezit DD2, i cili është përcaktuar, në aktet ligjore në fuqi, më datë 30 qershor 2022.

Gjithashtu, në mbështetje të operatorëve lokalë/rajonale, AMA ka vijuar zbatimin e ligjit nr. 34/2017, të ndryshuar. Duke pasur parasysh se disa subjekte analogë nuk janë mbështetur në rrjetet numerike apo për shkaqe të tjera, të parashikuara në ligj, licencat e tyre janë hequr apo janë bërë të pavlefshme, AMA ka rishikuar numrin e subjekteve përfitues, rishikim i cili është shoqëruar me zgjatjen e periudhës së kompensimit të tyre nga 6.46 muaj në rreth 7.8 muaj.

Lidhur me shpërndarjen e reklamës shtetërore (publike) operatorët lokalë janë informuar se ligji nr. 97/2013, i ndryshuar, nuk parashikon rregulla apo kritere mbi mënyrën e prokurimit të reklamave shtetërore. Kryerja e procedurave të prokurimit të reklamave shtetërore realizohet nga secili institucion publik.

Procesi i prokurimit mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 1195, datë 05.08.2008 “Për blerjen, zhvillimin, prodhimin dhe bashkëprodhimin e programeve apo të reklamave për transmetim nga operatorët radiotelevizivë ose botim në median e shkruar, dhe për kontratat, për kohë transmetimi, nga organet e administratës shtetërore”.

Me qëllim trajtimin e kësaj problematike, AMA, në raportin vjetor të veprimtarisë së Autoritetit për vitin 2020, ka parashtruar pranë Kuvendit mundësinë e rishikimit/ndryshimit të kuadrit legjislativ lidhur me reklamën shtetërore.

Sa i takon kërkesës së operatorëve lokalë për t’u pajisur me frekuenca për ndërtimin e rrjeteve lokale/rajonale, AMA, në çdo takim dhe komunikim me këta operatorë, ka bërë me dije se kanalet frekuencore të cilat, bazuar në planin numerik të frekuencave, i përkasin operatorëve lokalë/rajonale në allotmente të caktuara (Kukës, Elbasan, Korçë, Gjirokastrë) janë kanale të brezit 700 MHz (i njohur si brezi DD2). Bazuar në vendimet ndërkombëtare, ky brez frekuencash duhet të lirohet nga përdorimi për shërbimet audiovizive pasi do të kalojë për përdorim për shërbimet e lëvizshme. Në këto kushte, aktualisht, është e pamundur ndërtimi i rrjeteve numerike lokale/rajonale.

Operatorët lokalë/rajonale kanë paraqitur kërkesë për t’u pajisur me licencë kombëtare transmetimi numerik audioviziv, me frekuencën e brezit VHF dhe AMA, në korrespondencat shkresore, ka bërë me dije se bazuar në kapacitetet transmetuese, që përfitohen nga plani i frekuencave numerike të Shqipërisë, përcakton mënyrën e përdorimit dhe shfrytëzimit të tyre. Në rastin e frekuencave të planifikuara për 1 mbulim kombëtar (11 allotmente) në brezin VHF, AMA ende nuk ka miratuar vendimin administrativ për shfrytëzimin e tyre, nëse do të përdoren për mbulim lokal (deri në një qark), rajonal (deri në 4 qarqe) apo kombëtar. Në takimet e zhvilluara, subjektet janë informuar se ky brez frekuencor nuk përdoret për transmetime televizive numerike, në asnjë vend evropian.

Një ndër problematikat e ngritura nga Shoqata e Transmetuesve Radiotelevizivë Kabllorë dhe Valorë është dhe ajo e ndryshimit të vazhdueshëm të tarifave për të drejtën e autorit, nga S.U.A.D.A kundrejt operatorëve kabllorë, sa herë që kjo e fundit bën ndryshime në strukturat e saj drejtuese.

Pavarësisht se përcaktimi dhe miratimi i tarifave për të drejtat e autorit nuk është në tagrin e Autoritetit tonë, AMA, në rolin e rregullatorit të shërbimeve audiovizive, palë interesi në këtë proces, së shpejti do të

koordinojë zhvillimin e një tryeze të përbashkët me qëllim rishikimin e mundësive për gjetjen e zgjidhjeve përfundimtare.

Po ashtu, Shoqata e Transmetuesve Radiotelevizivë Kabllorë dhe Valorë, në mënyrë shkresore dhe në takimet e zhvilluara, ka kërkuar ndërmjetësimin e Autoritetit me OSHEE-në, i cili u kërkon operatorëve kabllorë heqjen e kabllove të tyre nga shtyllat elektrike.

AMA, me shkresën nr. 2382/1 prot., datë 08.09.2020, ka përcjellë këtë shqetësim të Shoqatës pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe Ministrisë së Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes.

Nga ana tjetër, AMA, me qëllim lehtësimin e veprimtarisë së subjekteve audio/audiovizivë, me shkresën nr. 3604 prot., datë 10.11.2021, i ka kërkuar OSHEE-së mbajtjen e një takimi me qëllim diskutimin, analizimin e kërkesës së operatorëve lokalë dhe gjetjen e zgjidhjeve.

2) *Të japë kontributin e saj në procesin e transpozimit në legjislacionin kombëtar të Direktivës së BE-së 2010/13/BE “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë”, e cila ka pësuar ndryshime në fund të vitit 2018. Këto ndryshime, ndër të tjera, synojnë mbrojtjen më të mirë të të miturve, rregulla të reja për platformat online, ndryshime në rregullat e komunikimeve me natyrë tregtare.*

Në kudër të kontributit të AMA-s në procesin e transpozimit të Direktivës së BE-së 2018/1808, në cilësinë e Autoritetit rregullator të shërbimeve audio/audiovizive në RSH, AMA ka realizuar një punë paraprake me qëllim njohjen me ndryshimet e Direktivës 2010/13 “Për shërbimin mediatik me zë dhe figurë për mediat audiovizive”.

Ndryshimet kryesore në Direktivën AVMS lidhen me përfshirjen në fushën e zbatimit të saj të platformave për shpërndarjen e videove, përcaktimin e detyrimeve të ofruesve të platformave të ndarjes së videove, rishikimin e detyrimeve për ofruesit e shërbimeve audiovizive me kërkesë (on demand service), rishikimin e rregullave për transmetuesit audiovizive për mbrojtjen e të miturve nga përmbajtjet e dëmshme etj. Po ashtu, në këtë dokument gjejmë trajtim edhe një sërë çështjesh të tjera si nxitja e bashkërregullimit dhe e vetërregullimit përmes kodeve të sjelljes, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen e të miturve kundrejt komunikimeve tregtare, rregulla mbi rritjen e transparencës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike. Një vend i posaçëm në të, i kushtohet edhe sigurimit të aksesit në informacion të personave me nevoja të veçanta shqisore.

Duke njohur rëndësinë e transpozimit të kësaj direktive, në përmbushje jo vetëm të detyrimeve ndërkombëtare, që lidhen me procesin e integritetit të vendit tonë në BE, por edhe në kuadër të përmirësimit të kuadrit kombëtar ligjor dhe nënligjor në fushën e mediave audio/audiovizive, AMA, me shkresën nr. 2682 prot., datë 06.08.2021, i është drejtuar Kuvendit dhe Ministrisë së linjës për iniciimin e procesit të transpozimit të Direktivës 2018/1808. Referuar ndryshimeve që sjell kjo Direktivë, procesi i transpozimit kërkon përfshirjen edhe të institucioneve të tjera, për çështje të caktuara.

Në vijim të kërkesës së AMA-s dhe me propozim të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 6144/1 prot., datë 17.09.2021, si dhe në kuadër të procesit të rishikimit të Planit Kombëtar të Integritetit Evropian (PKIE) për periudhën 2020-2024, në MIE janë zhvilluar dy takime me përfaqësues nga AMA dhe institucione të tjera, të cilat mund të preken nga ndryshimet e Direktivës 2010/13/BE, si Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës, Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve etj. Kjo referuar faktit se ndryshimet që sjell kjo Direktivë prekin fushat e veprimit të institucioneve të tjera për çështje të caktuara.

Në përfundim të takimeve është rënë dakord për transpozimin e pjesshëm të kësaj Direktive, duke shtuar, në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, disa nga nenet e direktivës, të cilat e ndryshojnë/përmirësojnë atë, sikurse janë: mbrojtja e fëmijëve, aksesit në media të personave me aftësi të veçanta, çështjet e juridiksionit, promovimi i veprave evropiane etj. Ndërkohë, rregullimi në ligj i aktivitetit të platformave për ndarjen e videove (video sharing platform), shërbimi i cili, aktualisht, nuk normohet në legjislacionin vendas, është shtyrë në një moment të dytë, pasi është i nevojshëm një diskutim më i gjerë, me disa institucione të përfshira në këtë proces, me qëllim përcaktimin e kompetencave dhe përgjegjësisë përkatëse.

Transpozimi i pjesshëm i Direktivës është planifikuar në PKIE 2022-2024, për t’u realizuar në tremujorin e katërt të vitit 2022.

AMA, në cilësinë e rregullatorit ka identifikuar dispozitat në fuqi të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, lidhur me mbrojtjen e fëmijëve, reklamën, juridiksionin, aksesueshmërinë e personit me aftësi të kufizuara etj., të cilat preken nga ndryshimet e Direktivës (BE) 2018/1808.

Ndërkohë, informojmë se MIE përfitoi një asistencë teknike (TAIEX workshop) lidhur me eksperiencat e vendeve të BE-së për implementimin e direktivës 2018/2018. Në kuadër të kësaj asistence, me qëllim njohjen me praktikën më të mirë të vendeve të BE-së, si dhe me problematikat e ndeshura në këto vende gjatë transpozimit të direktivës 2018/2018, në shkurt 2022 u zhvillua një seminar dyditor me ekspertët e BE-së.

3) Të vijojë të luajë një rol proaktiv dhe nxitës në arritjen e përmirësimit dhe të forcimit të mbrojtjes së të drejtave të punës dhe të drejtave sociale të gazetarëve në sektorin audio dhe audioviziv, si një çështje e rëndësishme dhe me ndikim të drejtpërdrejtë në lirinë e medias e cila nënvizohet edhe në Raportin e Progresit të KE-së.

Sa i takon lirisë së medias dhe të drejtave të gazetarëve, Autoriteti i Mediave Audiovizive, në pozicionin e rregullatorit në tregun audioviziv, ka shërbyer si nxitës dhe mbështetës i politikave për rregullimin e mjedisit mediatik, edukimin e gazetarëve të rinj dhe publikimin e të dhënave në lidhje me performancën e tregut. AMA ka vijuar bashkëpunimin me grupet e interesit në fushën e medias duke organizuar dhe mbështetur trajnime dhe studime të tregut audioviziv.

4) Të ndjekë me ministritë përgjegjëse dhe në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë, zgjidhjen e problemit të mungesës së interpretëve/përkthyesve për transmetimin me gjuhën e shenjave dhe,

në të njëjtën kohë, të kërkojë zbatimin e detyrimit ligjor për transmetimet me bazë gjuhën e shenjave, nga ana e operatorëve audiovizivë me licencë kombëtare, si një detyrim që garanton të drejtën e informimit të komuniteteve me nevoja të veçanta shqisore.

Problematika e transmetimeve për personat me nevoja të veçanta shqisore është problematikë e përsëritur.

Aktualisht, vetëm operatori publik, RTSH, transmeton një edicion informativ në gjuhën e shenjave. Sikurse kemi bërë me dije në raportimet e mëparshme, AMA, duke i konsideruar tepër të rëndësishme transmetimet për personat me nevoja të veçanta shqisore, që prej vitit 2017 e në vijim, ka pasur komunikime të herëpashershme shkresore me operatorët privatë audiovizivë të pajisur me licencë kombëtare: “Top Channel”, “Klan” dhe “Vizion +” dhe me institucionet publike, ministrinë përgjegjëse për çështjet e arsimit, për përgatitjen e interpretëve/përkthyesve të gjuhës së shenjave, si dhe të personelit shkencor në këtë fushë dhe për çështjet e aftësisë së kufizuar.

Duke qenë se operatorët kombëtarë kanë ngritur shqetësimin mbi mungesën e interpretëve/përkthyes të gjuhës së shenjave, AMA me shkresën nr.1232 prot., datë 11.03.2021, i është drejtuar Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe asaj të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për nxitjen dhe marrjen e masave të mëtejshme për konkretizimin e transmetimeve audiovizive për personat me nevoja të veçanta shqisore, përmes përgatitjes së interpretëve/përkthyesve të gjuhës së shenjave.

Përgjigjja e ardhur nga Ministria e Arsimit na vë në dijeni se “përgatitja e interpretëve të gjuhës së shenjave është në politikat prioritare të arsimit të lartë” (Shkresa 1565/1 prot., datë 20.04.2021).

Këshilli i Ankesave do të vijojë edhe më tej komunikimin me Ministrinë e Arsimit, duke i theksuar nevojën për hapa konkretë e të shpejtë në lidhje me zgjidhjen e kësaj çështjeje, e cila është mjaft e ndjeshme për “komunitetin me nevoja të veçanta shqisore”.

5) Të japë kontributin e saj konkret në përafrimin me standardet ndërkombëtare të kërkesave ligjore për transparencën e pronësisë mbi mediat, financimin e mediave dhe kufizimet e tyre, problematika të cilat theksohen edhe në Raportin e Progresit të KE-së.

Lidhur me transparencën e pronësisë mbi mediat dhe financimin e tyre, AMA, në cilësinë e zbatuesit të ligjit në fuqi nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, prej vitit 2016, publikon Buletinin Periodik.

Në fund të muajit tetor 2021 u kompletua Edicioni 7 i Buletinit, që përkon me periudhën kohore 01.01.2020 – 31.12.2020. Edhe në këtë Edicion janë përfshirë treguesit ekonomikë e financiarë, teknikë e teknologjikë, mbi përmbajtjet e transmetuara, burimet njerëzore të angazhuara etj. Gjithashtu, ka dhe transparencë mbi të dhënat e pronësisë në aktivitetin audio/audioviziv, ku janë hedhur tregues mbi strukturimin pronësor, përqendrimin e kontribuesve të OSHMA-ve në degë të ndryshme të industrisë, si dhe pjesëmarrja pronësore për secilën OSHMA.

Sa i përket financimit të mediave, kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi parashikon se subjektet që kërkojnë pajisjen me licencë/autorizim për ushtrimin e veprimtarisë audio/audiovizive, në aplikimin e tyre duhet të

depozitojnë origjinën dhe shumën e financimeve të parashikuara për kohëzgjatjen e licencës/autorizimit dhe AMA, gjatë shqyrtimit të aplikimeve, verifikon burimet financiare që zotërojnë aplikuesit, si dhe aspektet e funksionimit ekonomik dhe financiar të subjekteve.

Në rastet e kalimit të të drejtave të mbajtësit të licencës për transmetime audio ose audiovizive, nga një subjekt tregtar te një tjetër, AMA i kërkon, subjektit blerës të kuotave, burimet financiare justifikuese ligjore për masën e blerjes së tyre (referuar vlerës së kontratës).

AMA, lidhur me kufizimet e pronësisë (rishikimin e tyre) në mënyrë të përsëritur, gjatë raportimeve, në kuadër të hartimit të kontributeve për disa kapituj të acquis të Bashkimit Evropian, ka theksuar se institucioni përgjegjës për këtë rekomandim nuk është AMA.

Lidhur me çështjet sa më sipër, AMA do të vijojë të zbatojë detyrat funksionale të parashikuara në ligjin organik dhe për çdo iniciativë për përmirësimin/rishikimin e kuadrit ligjor dhe rregullator mbetet e hapur për të dhënë kontributin e saj.

6) *Të jetë pjesë aktive, përmes propozimeve konkrete, në diskutimet për ndryshimet ligjore të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar“, si për sa i takon krijimit të një kuadri rregullator për mediat online si një realitet i ri në industrinë mediatike ashtu edhe të adresimit të opinionit të Komisionit të Venecias, për të bërë të mundur që këto ndryshime të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe parimet e lirisë së medias.*

Sikurse është raportuar, si në raportet vjetore të AMA-s për vitet 2019 dhe 2020, edhe në raportet periodike për Kuvendin, nga Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është ndërmarrë iniciativa ligjore, për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, objekt i të cilit është përfshirja e ofruesve të shërbimeve të publikimeve elektronike në fushën e zbatimit të ligjit tonë organik.

AMA, si organ kolegjal, me vendimin nr. 169, datë 18.11.2019, ka dhënë mendim për projektligjin.

Aktualisht ky projektligj, është në fazë rishikimi pranë Kuvendit të Shqipërisë dhe AMA do të japë kontributin e vet gjatë fazës së rishikimit pranë këtij institucioni, rishikim që synon përmirësimin e përmbajtjes së projektligjit dhe reflektimin në tekst të propozimeve të Komisionit të Venecias.

7) *Të punojë për zbatimin e rekomandimeve të papërmbushura të Kontrollit të Lartë të Shtetit, në mënyrë të veçantë rekomandimin lidhur me operacionet IT (Help Desk) për shërbimet e brendshme dhe të jashtme në fushën e sigurisë.*

Lidhur me zbatimin e rekomandimeve të lëna nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, pas auditimit të ushtruar në AMA, me objekt “Performanca e përdorimit të Internetit në Administratën Publike”, sikurse jeni informuar më parë, janë marrë masa për ndërtimin e kufizimeve të aksesimit të shërbimit wireless për parandalimin e sulmeve ose hyrjeve të paautorizuara në pajisjet e institucionit; është vendosur serveri backup me parametra optimale si serveri primar me qëllim rritjen e sigurisë së informacionit; janë hartuar regjistrat e risqeve mbi infrastrukturën TIK, si dhe janë dokumentuar incidentet e ndodhura gjatë kësaj periudhe dhe masat e marra për zgjidhjen e tyre; vijon monitorimi mbi sasinë dhe cilësinë e internetit të përdorur, me qëllim përcaktimin e nevojave të mundshme etj.

Lidhur me blerjen e programit Helpdesk, ku çdo departament do të ketë akses për problematikat dhe kërkesat e tyre, si dhe departamenti IT do të procedojë me hedhjen e të gjitha konfigurimeve në këtë sistem, ju bëjmë me dije se në korrik 2021 është zhvilluar procedura e prokurimit, e cila më pas është anuluar për shkak të mangësive në dokumentacionin e procedurës së prokurimit.

AMA ka zhvilluar përsëri procedurën e prokurimit të programit Helpdesk në tetor 2021, por edhe kjo procedurë ka dështuar për shkak se nuk është dorëzuar asnjë ofertë në përputhje me kërkesat e parashikuara në dokumentat përkatëse.

Në dhjetor 2021 është rihapur procedura e prokurimit dhe në përfundim të kësaj procedure është shpallur operatori fitues me të cilin në vijim do të lidhet kontrata e shërbimit për implementimin e programit Helpdesk.

8) *Të vijojë përpjekjet për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes AMA-s dhe AKEP-it, për parandalimin dhe/ose ndalimin e piraterisë audiovizive online, duke pasur parasysh edhe realitetin e ri kur mediat, bazuar në internet, kanë një zhvillim të pandalshëm dhe efekt të jashtëzakonshëm në industrinë mediatike.*

Në kuadër të këtij rekomandimi, pas komunikimeve të përsëritura shkresore midis AMA dhe AKEP, në muajin shtator 2021 u zhvillua një takim me qëllim diskutimin dhe dakordësimin e fushave të bashkëpunimit me interes të përbashkët midis dy autoriteteve.

Në këtë takim palët ranë dakord për nënshkrimin e një memorandumi bashkëpunimi, i cili u formalizua me nënshkrimin e tij, më datë 3 nëntor 2021.

Memorandumi përcakton bashkëpunimin, ndër të tjera, për çështjet si më poshtë:

- Lirimin e brezit 700 MHz (brezi DD2), nga transmetimet audiovizive dhe kalimin në administrim të këtij brezi nga AKEP, brenda afateve të përcaktuara në aktet kombëtare dhe ndërkombëtare;
- Ngritjen e një TASK-FORCE me përfaqësues të përbashkët nga të dy institucionet me qëllim luftën kundër paligjshmërisë në transmetimet pa të drejta autori përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe zhvillimin e veprimtarisë vetëm nga subjekte të licencuara/autorizuara nga autoritetet rregullatore;
- Ngritjen e një grupi të përbashkët, i cili do të ndjekë në vijueshmëri problemet e interferencave të shkaktuara nga subjekte, veprimtaria e të cilëve përfshihet në fushën e veprimit të këtyre institucioneve si dhe interferencave që raportohen nga autoritetet rregullatore të vendeve fqinjë; etj.

9) *Të japë kontributin e saj duke luajtur një rol proaktiv në përmirësimin e legjislacionit mbi reklamat publike për të bërë të mundur rritjen e transparencës në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare, kërkesë e cila theksohet edhe në Raportin e Progresit të KE-së.*

Ritheksojmë, në mënyrë të përsëritur, se në dispozitat e ligjit tonë organik jepen përkufizimet e reklamave politike dhe institucionale, por nuk parashikohen rregulla apo kritere mbi mënyrën e prokurimit të tyre.

AMA, në kuptim të detyrave funksionale, monitoron tërësinë e programeve të transmetuara nga ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizive, ndërkohë që është jashtë sferës së veprimtarisë së AMA-s kryerja e procedurave të prokurimit të reklamave shtetërore, të cilat, aktualisht, prokurohen nga secili institucion publik.

Për sa më sipër, AMA ka informuar më në detaje në raportimet e mëparshme periodike, në Kuvend, si dhe në raportimet e BE-së.

10) AMA të luaj një rol nxitës dhe proaktiv në bashkëpunim me aktorët dhe faktorët përkatës, duke bërë të mundur përmirësimet e nevojshme ligjore për një proces vetërregullimi; shqetësim i cili theksohet edhe në raporte të ndryshme ndërkombëtare dhe që ka një ndikim të drejtpërdrejtë në lirinë e medias.

Lidhur me rolin nxitës dhe proaktiv të AMA-s në kuadër të proceseve të vetërregullimit, AMA mbetet e hapur dhe e gatshme, në çdo kohë, në mbështetjen e nismave të tilla nga aktorë dhe faktorë të ndryshëm.

3. MASAT E MARRA NË ZBATIM TË REKOMANDIMEVE TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONE TË TJERA KUSHTETUESE OSE TË PAVARURA NDAJ AUTORIT

Avokati i Popullit “Rekomandim lidhur me ofrimin e shërbimit të sinjalit audioviziv në fshatin Strelcë, Njësia Administrative Gore, Maliq”.

Në vijim të këtij rekomandimi (nr. 7 prot., datë 05.01.2021), AMA, ka informuar Avokatin e Popullit sa më poshtë:

AMA është autoriteti rregullator në fushën e shërbimeve audio/audiovizive që ushtron aktivitet mbështetur në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Ndër funksionet kryesore të AMA-s është edhe mbikëqyrja e zbatimit të kontratës së shërbimit të lidhur me Radiotelevizionin Shqiptar (RTSH). Kontrata e shërbimit të transmetimit publik konsiderohet si akti që rregullon marrëdhënien midis AMA-s dhe RTSH-së, si operator publik, misioni i të cilit është informimi, edukimi e argëtimi i publikut përfshirë pakicat kombëtare. Në dokumentin e Kontratës së Shërbimit të Transmetimit Publik gjejmë rregullim çështjet juridike, programore dhe teknike.

AMA, në cilësinë e rregullatorit të shërbimeve audio/audiovizive monitoron veprimtarinë e operatorit publik për të qenë në harmoni me kërkesat e ligjit. Në këtë kuadër, AMA, në mënyrë të vazhdueshme, ka monitoruar mbulimin e territorit dhe cilësisë së sinjaleve të RTSH-së dhe, nga monitorimet e kryera, ka rezultuar se zona të caktuara në vend nuk arrihen të mbulohen me sinjal numerik, duke mos ofruar në këtë mënyrë shërbim audioviziv në këto zona (ku përfshihet edhe Fshati Gore, për të cilin është depozituar ankesa).

Rezultatet e monitorimeve, në çdo rast, i janë bërë me dije vetë operatorit publik dhe janë përfshirë në raportimet e kryera nga AMA, pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Po ashtu, AMA, për çdo problematikë lidhur me operatorin publik, ka mbajtur korrespondenca shkresore dhe ka zhvilluar takime të përbashkëta me RTSH-në me qëllim diskutimin dhe gjetjen e zgjidhjeve të duhura.

Ndërkohë, në dispozitat ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e RTSH-së, parashikohet ndër të tjera edhe detyrimi për mbulimin e territorit me shërbim audioviziv nga ky operator. Në nenin 121 të ligjit parashikohet se: “*Programet kombëtare të RTSH-së duhet të mbulojnë territorin e banuar nga të paktën 90 për qind e shtetasve të Republikës së Shqipërisë. Brenda 5 vjetëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të paktën njëri nga rrjetet e RTSH-së duhet të mbulojë 99 për qind të popullsisë*”.

Pra, detyrimi i operatorit publik është mbulimi i territorit të banuar nga të paktën 90% të shtetasve, ndërsa për pjesën e popullatës që mbetet pa shërbim audioviziv tokësor, kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi parashikon ofrimin e shërbimit audioviziv mbështetur në rrjetin satelitor.

Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 292, datë 02.05.2012 “Për miratimin e Strategjisë së Kalimit nga Transmetimet Analoge në Transmetimet Numerike” (bashkëlidhur të cilit është miratuar edhe plani i veprimit) theksohet se: ... *për shkak të konfiguracionit të thyer të terrenit, asnjë operator shqiptar nuk do të*

jetë në gjendje të mbulojë me shumë se 90 - 95% të territorit të vendit. Për pjesën e mbetur do të duhet të parashikohet mbulimi nëpërmjet satelitit, siç është realizuar edhe në vende të tjera.

Në zbatim të Rekomandimit të Avokatit të Popullit, në datën 18 janar 2021, AMA ka zhvilluar një takim me ekspertë, në nivel teknik, të operatorit publik. Në këtë takim, përfaqësuesit e RTSH-së informuan se RTSH, krahas shërbimit të ofruar në rrjet tokësor, ofron gjithashtu 7 programe, mbështetur në rrjetin satelitor, shërbim i cili mund të aksesohet në çdo zonë. Në këto kushte, alternativa për marrjen e shërbimit audioviziv në zonat që nuk mbulohen me sinjal tokësor është përmes satelitit.

4. REKOMANDIMET E LËSHUARA NË PROGRES-RAPORTIN E BE-së DHE DETYRIME TË TJERA NDËRKOMBËTARE NDAJ AUTORITETIT

Disa nga rekomandimet e progres raportit të BE-së për Shqipërinë, për vitin 2021:

- *Kërkesat ligjore për transparencën e pronësisë dhe financimit të medias, dhe kufizimet e saj, si dhe kërkesat për reklamat shtetërore të jenë në përputhje me praktikën më të mira ndërkombëtare*
- *Të sigurojë zbatimin e Kodit të Punës dhe të forcojë mbrojtjen e të drejtave të punës dhe të drejtave sociale të gazetarëve shqiptarë. (Kapitulli 23).*

Lidhur me transparencën e pronësisë mbi mediat dhe financimin e tyre, AMA, në cilësinë e zbatuesit të ligjit në fuqi nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, prej vitit 2016, publikon Buletinin Periodik.

Në Buletinin Periodik të AMA-s, që publikohet çdo vit, si një set treguesish ekonomikë e financiarë, teknikë e teknologjikë, mbi përmbajtjet e transmetuara, burimet njerëzore të angazhuara etj., bëhen transparente dhe të dhëna mbi pronësinë në aktivitetin audio/audioviziv. Aty përfshihen tregues mbi strukturimin pronësor, përqendrimin e kontribuesve të OSHMA-ve në degë të ndryshme të industrisë, si dhe pjesëmarrja pronësore për secilën OSHMA. Në këtë linjë është dhe edicioni 7 i Buletinit Periodik, që është në proces aktualisht.

Sa i përket financimit të mediave, kuadri ligjor dhe nënligjor në fuqi parashikon se subjektet, që kërkojnë pajisjen me licencë/autorizim për ushtrimin e veprimtarisë audio/audiovizive, në aplikimin e tyre duhet të depozitojnë origjinën dhe shumën e financimeve të parashikuara për kohëzgjatjen e licencës/autorizimit dhe AMA, gjatë shqyrtimit të aplikimeve, verifikon burimet financiare që zotërojnë aplikuesit, si dhe aspektet e funksionimit ekonomik dhe financiar të subjekteve. Në rastet e kalimit të të drejtave të mbajtësit të licencës për transmetime audio ose audiovizive, nga një subjekt tregtar te një tjetër, AMA i kërkon subjektit blerës të kuotave, burimet financiare justifikuese ligjore për masën e blerjes së tyre (referuar vlerës së kontratës).

AMA, lidhur me kufizimet e pronësisë (rishikimin e tyre) në mënyrë të përsëritur, gjatë raportimeve në kuadër të hartimit të kontributeve për disa kapituj të *acquis* të Bashkimit Evropian, ka theksuar se institucioni përgjegjës për këtë rekomandim nuk është AMA.

5. TË DHËNA LIDHUR ME AKTIVITETIN E AUTORITETIT PËR KRYERJE INSPEKTIMESH OSE HETIMESH ADMINISTRATIVE, VENDIME TË SANKSIONEVE ME GJOBË NË RAPORT ME VITET E FUNDIT

Një ndër detyrat funksionale të AMA-s është verifikimi i respektimit të kushteve të licencës dhe/ose autorizimit nga subjektet që ushtrojnë veprimtari audio dhe/ose audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Mbështetur në nenin 78 të ligjit nr. 97/2013, AMA ka të drejtë të ushtrojë kontroll të veprimtarisë programore, financiare, teknike dhe organizative të mbajtësit të një licence dhe/ose autorizimi. AMA, gjithashtu, ka kompetencë të vendosë sanksione sipas nenit 133, “Gjobat” për subjektet që veprojnë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Sanksionet gjobë mund të vendosen nga inspektorët ose nga vetë AMA me nismën e tyre ose pas ankimit të subjekteve të interesuara.

Gjatë vitit 2021, nga AMA janë vendosur 15 sanksionë me gjobë, të ndërmarra si më poshtë:

- Drejtoria e Mbikëqyrjes: 13 vendime të sanksioneve me gjobë
- Drejtoria Juridike dhe Licencave: 2 vendime të sanksioneve me gjobë.
-

Drejtoria e Mbikëqyrjes

Lidhur me respektimin e të drejtave të transmetimit, Autoriteti, gjatë viteve 2018 dhe 2019 ka kryer një numër të konsiderueshëm inspektimesh të subjekteve kabllore në terren. Gjatë vitit 2020, numri i inspektimeve ka qenë në rënie, kjo shkaktuar dhe nga pandemia e COVID-19 si dhe nga kërkesat në rënie të subjekteve për ndërhyrje nga ana jonë. Ndërsa, në vitin 2021 numri i inspektimeve për subjektet OSHMA është dyfishuar në krahasim me vitin paraardhës.

Të gjitha ankesat/kërkesat e operatorëve për ndërhyrje mbi mosrespektimin e të drejtës së transmetimit nga subjektet kabllore, AMA i ka realizuar duke iu dhënë përgjigje të gjithë subjekteve ankuese, si dhe duke marrë masat përkatëse në rast shkeljesh.

Pjesa dërmuese e ankesave për shkeljen e të drejtave të transmetimit, gjatë vitit 2021, lidhet me fenomenin e piraterisë televizive nga shoqëria “Tibo” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e programit audioviziv të të tretëve. Mbajtësi i të drejtave, shoqëria “Digit-Alb” sh.a., në mënyrë të përsëritur ka kërkuar marrjen e masave ndaj këtij operatori, duke qenë se ka njoftuar zgjidhjen e kontratës së bashkëpunimit.

Në vijim, informacioni në formë krahasuese për periudhën 2018-2021:

SUBJEKTI	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
Digit Alb	11 ankesa për 28 subjekte	6 ankesa për 10 subjekte		48 ankesa për 8 subjekte. Nga këto 41 ankesa janë vetëm për subjektin TIBO

Tring	05 ankesa për 12 subjekte	2 ankesa për 2 subjekte	18 ankesa për 23 subjekte	4 ankesa për 4 subjekte
Klan	-	-	5 ankesa për 5 subjekte	9 ankesa për 5 subjekte. Nga këto 5 ankesa janë vetëm për subjektin TIBO

Në lidhje me veprimtarinë inspektuese, Drejtoria e Mbikëqyrjes në AMA, gjatë vitit 2021, përmes grupeve të veta të inspektimit, ka ushtruar 118 kontrolle të aktivitetit të OSHMA-ve.

Në përfundim të kontrolleve dhe shqyrtimit të procedurave përkatëse administrative, janë marrë masat si më poshtë:

Trembëdhjetë (13) vendime për sanksione me gjobë ndaj subjekteve OSHMA, që janë konstatuar në shkelje të ligjit nr.97/2013, të ndryshuar, prej të cilave:

- 13 sanksione me gjobë ndaj subjekteve përsëritës të shërbimit të të tretëve (kabllorë, iptv, ott) nga të cilat 12 gjoba janë lënë në fuqi nga Këshilli i AMA-s (tre nga gjobat kanë ulje të masës) dhe 1 është brenda afatit për t'u ankimuar.
- Për 12 raste është vendosur tërheqja e vëmendjes ndaj subjekteve OSHMA.

Përveç sa më sipër, AMA, pas verifikimeve dhe shqyrtimeve përkatëse, ka kryer sekuestrimin e pajisjeve transmetuese të 3 subjekteve, të cilët ushtronin aktivitet audioviziv pa licencimin ose autorizimin e AMA-s.

Siç vihet re, në krahasim me vitet e mëparshme, aktivitetet e paligjshme audiovizive, pa licencimin ose autorizimin e AMA-s, janë gjithnjë në rënie.

Në vijim, informacioni në formë krahasuese me katër vitet e mëparshme:

VITI	INSPEKTIMET	GJOBA TOTAL (SHFUQIZUAR)	TËRHEQJE VËMENDJE	SEKUESTRIME
2018	224	27 (10)	49	11
2019	162	19 (5)	22	9
2020	55	5 (2)	13	3
2021	118	13	12	3

Për sa i përket veprimtarisë monitoruese, Drejtoria e Mbikëqyrjes, gjatë vitit 2021, është fokusuar në monitorimin e programeve mbi tematikën e tyre, respektimin e parashikimeve ligjore për transmetimin e reklamave dhe për evidentimin e volumit të reklamave në televizionet kombëtare, sikurse edhe në

monitorimin e programeve të lira në platformat numerike tokësore. Gjithashtu, një fokus të veçantë ka pasur dhe monitorimi për respektimin e të drejtës së transmetimit për filmat artistikë, në platforma/programe të ndryshme. Për vitin 2021 janë kryer 1056 orë monitorime për të drejtat e transmetimit për filmat artistikë.

Drejtoria Juridike dhe Licencave

Për verifikimin e respektimit të detyrimit ligjor, njoftimit pranë autoritetit licencues të ndryshimeve të ndodhura në të dhënat për marrjen e licencës/autorizimit, AMA, në mënyrë periodike, ka kontrolluar në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), strukturën e pronësisë së OSHMA-ve. Gjatë vitit 2019, AMA ka iniciuar hetim administrativ për 6 subjekte dhe në përfundim të procedimeve administrative, janë miratuar ndryshimet në strukturën e pronësisë për 4 subjekte audio/audiovizivë, ndërsa është sanksionuar për mosdhënie informacioni për ndryshimet në pronësi 1 subjekt. Gjatë vitit 2020, AMA, ka ndëshkuar 1 subjekt, me vendim për dënimin me gjobë nr. datë 23.12.2020, në masën 120.000 lekë. Ky sanksion, pas ushtrimit të ankimit administrativ, është shfuqizuar nga AMA, me vendimin nr. 8, datë 18.01.2021.

Gjatë vitit 2021 janë iniciuar 5 hetime administrative dhe janë dënuar për kundërvajtjen administrative, “Mosnjoftim i ndryshimeve të ndodhura në të dhënat e licencës/autorizimit”, me sanksion gjobë:

- Nr. 1, datë 02.03.2021, vendosur ndaj shoqërisë “RRTL-OTT” sh.p.k., autorizuar për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në rrjet IP, OTT, në masën 120,000 leke, shfuqizuar me vendimin e AMA-s, nr. 50, datë 26.03.2021;
- Nr. 2, datë 02.03.2021 vendosur ndaj shoqërisë “Selenice Kabllor” sh.p.k., për subjektin “Selenice Kabllor”, në masën 120, 000 lekë, shfuqizuar me vendimin e AMA-s nr. 41, datë 11.03.2021.

Ecuria financiare e sanksioneve me gjobë gjatë vitit 2021

<i>lekë</i>	
Çelja në fillim të vitit 2021	306,903,197
+ Vendime të dënimeve me gjobë në 2021	17,240,000
+ Kamatëvonesa të lindura në vitin 2021	0
- Detyrime të shlyera nga vendime të dënimeve me gjobë dhe kamatëvonesat e lindura	2,553,100
- Vendime të dënimeve me gjobë të shfuqizuara/ulur masa/shuar titulli ekzekutiv nga përmbaruesi	2,360,000
Detyrimi në fund të vitit 2021	319,230,097

Masa e detyrimeve të lindura prej 15 sanksioneve me gjobë, në vitin 2021, është 17,240,000 lekë.

Masa e uljes në vlerën 2,360,000 lekë për “Vendime të sanksioneve me gjobë të shfuqizuara/ulur masa/shuar titulli ekzekutiv nga përmbaruesi” rezulton prej:

- Me vendim të AMA-s nr. 8, datë 18.01.2021, është shfuqizuar sanksioni me gjobë nr. 6, datë 23.12.2020, në masën 120,000 lekë.
- Me vendime të AMA-s janë shfuqizuar 2 (dy) vendime të sanksioneve me gjobë, të vitit 2021, në masën 240,000 lekë, konkretisht: sanksioni me gjobë nr. 1, datë 02.03.2021 (shfuqizuar me vendimin nr. 50, datë 26.03.2021) dhe sanksioni me gjobë nr. 2 datë 02.03.2021 (shfuqizuar me vendimin nr. 41, datë 11.03.2021).
- Me 2 (dy) vendime të AMA-s janë ulur masat e dënimit të sanksioneve me 2,000,000 lekë, konkretisht: me vendimin nr. 95, datë 26.11.2021 është ulur masa e sanksionit me gjobë nr. 12, datë 11.10.2021 dhe me vendimin nr. 103, datë 21.12.2021 është ulur masa e sanksionit me gjobë nr. 13, datë 01.11.2021.

6. QEVERISJA E AUTORITETIT

6.1 Vendimmarrja mbi licencat/autorizimet

Prej muajit mars 2021, AMA e ka ushtruar aktivitetin e vet administrativ me 4 anëtarë, 3 prej të cilëve u ka përfunduar mandati, duke krijuar impas në punën e AMA-s, për shkak të pamundësisë për miratimin e vendimeve të cilat kërkojnë shumicë të cilësuar (5 vota).

Referuar përcaktimeve ligjore, AMA lëshon dhe heq licencat dhe autorizimet me shumicë të cilësuar. Mungesa e kuorumit të nevojshëm ligjor ka bërë të pamundur vendimmarrjet për marrje licence, rinovim dhe heqje të licencave/autorizimeve. Kështu, në përfundim të procedurave të brendshme administrative, pritet vendimmarrje nga organi kolegjal për: 2 aplikime fillestare (licencë shërbimi programi dhe licencë transmetimi audio analoge), 22 subjekte audio/audiovizive, nga të cilët 16 aplikime për rinovim autorizimi dhe 6 aplikime për rinovim licence.

Megjithatë, pavarësisht ushtrimit të aktivitetit administrativ jo në anëtarësi të plotë, AMA, edhe gjatë vitit raportues, ka miratuar një tërësi aktesh dhe vendimesh, të cilat kanë ndikuar pozitivisht në fushën e medias audiovizive. Kështu, gjatë këtij viti, janë miratuar vendime administrative që kërkojnë shumicë të thjeshtë si trajtimi dhe shqyrtimi i ankesave të subjekteve të sanksionuar për kundërvajtje administrative, miratimi i ndryshimeve në të dhënat e paraqitura në kërkesën për marrje licence/autorizimi në përputhje me legjislacionin në fuqi. Përveç kryerjes së funksioneve në cilësinë e organit kolegjal, gjatë periudhës raportuese, vend të rëndësishëm kanë edhe aspekte të tjera të veprimtarisë administrative të AMA-s, si përfaqësimi i institucionit në proceset gjyqësore ku është palë AMA, kryerja e kontrolleve dhe inspektimeve të ndryshme ndaj subjekteve, që ushtrojnë veprimtari audiovizive, bashkëpunimi dhe këshillimi me organe të tjera shtetërore.

Po ashtu, AMA, bazuar në kompetencat e dhëna prej ligjit organik, ka vijuar, edhe gjatë këtij viti, punën për plotësimin e kuadrit rregullator me legjislacion sekondar, me miratimin e vendimeve për çeljen e procedurave të lëshimit të licencave, në varësi të disponibilitetit të kapaciteteve të lira teknike.

Në zbatim të nenit 59 të ligjit të posaçëm, AMA ka çelur disa gara për licencë transmetimi audio analoge. Caktimi i frekuencave të transmetimit nga AMA, në çdo rast, ka respektuar parimet e parashikuara në ligj, si objektiviteti, transparencja, mosdiskriminimi dhe disponueshmëria e frekuencave të lira. Në kuadër të transparencës dhe për t'i dhënë mundësi çdo pale të interesuar për të marrë pjesë në procesin e konkurrimit, çelja e çdo gare është publikuar në faqen e internetit të AMA-s dhe në disa organe shtypi.

Në fillim të vitit 2021, pas shqyrtimit të aplikimeve të depozituara, në vijim të shpalljeve publike, AMA:

- Me vendimin nr. 3, datë 18.01.2021, ka vendosur dhënien e licencës lokale të transmetimit audio analoge, shoqërisë “I.B.C- TELECOM” sh.p.k., për subjektin audio “Radio I.B.C”, për të mbuluar me sinjal bashkitë “Shkodër dhe Vau i Dejës”.
- Me vendimin nr. 10, datë 02.02.2021, ka vendosur zgjerimin e zonës së licencimit të shoqërisë “Media New Vizion” sh.p.k., për subjektin audio “Radio 1”, për të mbuluar me sinjal “Bashkitë Elbasan, Cërrik dhe Belsh”.

- Me vendimin nr. 21, datë 16.02.2021, ka vendosur dhënien e licencës lokale të transmetimit audio analoge, shoqërisë “ABEG” sh.p.k., për subjektin audio “Radio ST”, për të mbuluar me sinjal “Qarqet Tiranë dhe Durrës”.

Po ashtu, në zbatim të nenit 60 të ligjit organik, AMA, me nismën e vet ose me kërkesën e subjekteve të interesuara, ka çelur disa gara, për dhënien e licencës së shërbimit të programit audioviziv, duke marrë në konsideratë ekzistencën e kapaciteteve të lira teknike në rrjetet numerike të operatorit publik dhe operatorëve privatë lokalë të transmetimit.

Konkretisht:

- AMA, me vendimin nr. 155, datë 24.12.2020, çeli garën për lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv të përgjithshëm, në allotmentin Tiranë (Qarqet Tiranë dhe Durrës). Në vijim të njoftimit të AMA-s, depozitoi aplikim shoqëria “Inter Active Media” sh.p.k., (data 14 janar 2021), i cili rezultoi i paplotë dhe AMA, me vendimin nr. 90, datë 09.11.2021, vendosi rrëzimin e aplikimit dhe mosdhënien e licencës për këtë subjekt.
- AMA, me vendimin nr. 9, datë 02.02.2021, çeli procedurën për lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv, tematik informativ në allotmentin Tiranë (Qarqet Tiranë dhe Durrës). Në vijim të këtij njoftimi, depozitoi aplikim shoqëria “Evro Media” sh.p.k., aplikim, i cili nuk është shqyrtuar nga AMA, për shkak të mungesës së kuorumit të nevojshëm ligjor.
- AMA, me vendimin nr. 20, datë 05.02.2021, çeli procedurën për lëshimin e 1 (një) licence lokale të shërbimit të programit audioviziv, të përgjithshëm në “Qarqet Fier dhe Vlorë”, garë për të cilën nuk u shfaq interes.

Sa i përket lëshimit të autorizimeve për ofrim shërbimi programi audioviziv, kuadri ligjor dhe nënligjor i të cilave ndryshon nga procesi i lëshimit të licencave, nuk ka pasur pengesë, pasi për lëshimin e tyre, është aplikuar neni 64, pika 5, e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, që përcakton se: *“Autorizimi jepet brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës së plotësuar. Refuzimi i aplikimit bëhet gjithmonë kundrejt një vendimi të arsyetuar. Nëse AMA nuk shprehet brenda afatit të mësipërm, nga data e marrjes së aplikimit të plotë, autorizimi konsiderohet i miratuar”*. Në zbatim të kësaj dispozite ligjore, janë pajisur me autorizim 14 subjekte audiovizivë mbështetur në rrjet kabllor, internet, OTT (nga të cilët 6 janë subjekte të rinj dhe 8 subjekte të autorizuar për shërbim kabllor, që kanë aplikuar për zgjerimin e zonës së ofrimit të shërbimit). Këto autorizime janë lëshuar në muajin prill 2021 e në vijim, duke aplikuar miratimin e autorizimeve në heshtje dhe më tej, njoftimin në formë shkresore.

AMA, në cilësinë e organit kolegjal, përmes vendimmarrjes së tij, ka pajisur me autorizim 2 subjekte, për 1 subjekt ka vendosur zgjerimin e zonës së shërbimit, si dhe ka vendosur refuzimin e aplikimit për zgjerim zone për 2 subjekte.

Një ndër kushtet e licencës/autorizimit të subjekteve OSHMA është detyrimi për të njoftuar AMA-n për ndryshime në të dhënat e licencës dhe autorizimit. Bazuar në nenin 133, të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, mosnjoftimi i ndryshimeve të ndodhura në të dhënat e subjektit të licencuar/autorizuar përbën kundërvajtje administrative që ndëshkohet me gjobë nga 120 000 lekë deri në 2 000 000 lekë. Ky detyrim ligjor ka si qëllim vënien në dijeni dhe njohjen e autoritetit rregullator me çdo ndryshim të të dhënave që i licencuari/autorizuari ka paraqitur në kërkesën për marrjen e

licencës/autorizimit, të tilla si: ndryshimet në pronësi, që është nga më të rëndësishmit, ndryshimet në administrimin apo drejtimin e shoqërisë, emrin e subjektit, ndryshime në strukturën programore etj.

Nga ana tjetër, AMA, kryesisht, në mënyrë periodike, verifikon në faqen zyrtare të Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), statusin, objektin e veprimtarisë si dhe të dhëna të tjera për subjektet e licencuar/autorizuar nga autoriteti. Në vijim të verifikimeve të kryera, AMA ka iniciuar, rast pas rasti, procedimet administrative ndaj OSHMA-ve duke kërkuar informacion dhe dokumentacion ligjor mbi ndryshimet në të dhënat për licencë/autorizim si dhe rast pas rast duke vendosur sanksionet përkatëse.

Ndërkohë 12 subjekte të licencuar/autorizuar kanë njoftuar autoritetin për ndryshimet e ndodhura në strukturën e pronësisë dhe më tej AMA ka proceduar me miratimin e këtyre ndryshimeve. Në shumicën e rasteve, ndryshimet kanë ndodhur brenda vetë strukturës së ortakëve por ka edhe raste të transferimit të të drejtave të licencës/autorizimit nga një subjekt tregtar në një tjetër, apo të ndryshimit të formës së subjektit tregtar nga person fizik në person juridik.

6.2 Ecuria e proceseve gjyqësore

E drejta për të investuar pushtetin gjyqësor, lidhur me vendimmarrjet administrative të autoritetit tonë, nga palët e prekura nga këto akte administrative, është një instrument i së drejtës, që e ka bërë AMA-n palë në procese të ndryshme gjyqësore.

Kryesisht, aktet administrative, ligjshmëria dhe themeltësia e të cilave është objekt shqyrtimi gjyqësor, lidhen me dënimet administrative ndaj subjekteve audio dhe/ose audiovizive, vendimet për heqjen/pavlefshmërinë e licencës etj.

Po ashtu, AMA, si person juridik publik, në mungesë të shlyerjes vullnetare të detyrimeve financiare nga ana e OSHMA-ve, ka investuar organet gjyqësore duke kërkuar prej subjekteve audio/audiovizive debitorë të shlyejnë detyrimet financiare ndaj AMA-s ose Buxhetit të Shtetit. Po ashtu, AMA i është drejtuar gjykatave kompetente edhe në cilësinë e palës kërkuuese, sikurse është edhe rasti i paraqitjes së kërkesave për lëshimin e urdhrave të ekzekutimit.

AMA, gjatë vitit 2021, është përfshirë në 25 procese gjyqësore në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, nga të cilat:

a) 11 procese gjyqësore në cilësinë e palës paditëse:

- Fituar (7);
- Humbur (1);
- Mospranim (1);
- Në proces (2)

b) 14 procese gjyqësore në cilësinë e palës së paditur

- Fituar (4);
- Humbur (1);

- Mospranim (2);
- Në proces (7).

Përveç proceseve gjyqësore në gjykim në shkallë të parë, AMA ka vijuar me ndjekjen e proceseve gjyqësore, të cilat janë në proces gjykimi në Gjykatën Administrative të Apelit dhe në Gjykatën e Lartë, çështje këto të mbartura nga vitet paraardhëse.

Si në vitet e kaluara edhe gjatë periudhës raportuese, ekzekutimi i vendimeve të AMA-s të shndërruara në tituj ekzekutivë, në zbatim të nenit 132 të ligjit organik, ka vijuar të kryhet përmes shërbimit privat përmbarimor. Për vitin 2021, AMA ka lidhur kontrata shërbimi për ekzekutimin e 19 titujve ekzekutivë, ndërkohë që gjatë kësaj periudhe kanë vijuar edhe procedurat për ekzekutimin e titujve në zbatim të kontratave të lidhura në vitet e kaluara.

Gjatë periudhës raportuese, 9 subjekte debitorë kanë shlyer detyrimet kundrejt AMA-s, nga të cilët:

- 7 prej tyre, detyrime financiare ndaj Autoritetit;
- 2 prej tyre, detyrime për sanksione me gjobë.

Pasqyrimi në mënyrë të përmblodhur i çështjeve gjyqësore në gjykim, në tri shkallët e gjyqësorit, jepet në Aneksin nr. 2, bashkëlidhur.

7. AUTORITETI SI RREGULLATOR PËR NJË TREG AUDIOVIZIV TË PËRGJEGJSHËM

7.1 Shqyrtimi tematik i përmbajtjeve të emetuara

Gjatë vitit 2021, shqyrtimet tematike për përmbajtjet e transmetuara u fokusuan në këto aspekte:

- a. mbrojtja e fëmijëve nga përmbajtjet e papërshtatshme;
- b. gjuha e urrejtjes dhe diskriminimi;
- c. reklamat dhe komunikimet tregtare, në mënyrë të veçantë për reklamat që kanë lidhje me shëndetin dhe medikamentet.
- d. mbi buketën programore të RTSH-së, në zbatim të kërkesave të Kontratës së Shërbimit.

Dukuritë më evidente nga këto shqyrtime ishin:

- Evidentim i shkeljeve etike. Ato kanë qenë të natyrës së transmetimit të pamjeve të rënda, të qëndrimeve të papërshtatshme, të ndikimit ndaj të ftuarve etj., si shkelje të kërkesave të ligjit 97/2013, i ndryshuar, apo Kodit të Transmetimit për median audiovizive, sipas të cilave transmetimet audiovizive respektojnë personalitetin, dinjitetin dhe të drejtat e liritë e tjera themelore të njeriut; si dhe që kjo veprimtari respekton në mënyrë të veçantë të drejtat, interesin më të lartë të fëmijës, si dhe kërkesat ligjore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
- Transmetim reklame të ndaluar, nga moderatorë të programeve. Vlen të përmendim se janë promovuar barna mjekësore, duke qenë në kundërshtim me rregulloren e miratuar që më datë 19.03.2018 “Për komunikimet audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e reklamave”, konkretisht me nenin 19, pika 10, ku saktësohet se: “Gjatë transmetimeve televizive është e ndaluar që realizuesit e programit dhe pjesëmarrësit në të, të bëjnë reklamimin e barnave”.
- Reklama të fshehura në emisionet mbi çështje të shëndetit, në kundërshtim me kërkesat e rregullores “Për komunikimet audio dhe/ose audiovizive me natyrë tregtare format, kushtet dhe koha ditore e lejuar për transmetimin e reklamave”, konkretisht neni 19, pika 9, ku thuhet se: “OSHMA-ja nuk duhet të transmetojë komunikim me natyrë tregtare, në të cilën mjeku bën reklamë ose publicitet, në favor të aktivitetit të tij personal apo të një institucioni të fushës së shëndetit”. Gjithashtu në Kodin e Transmetimit, në sesionin 7, pika 7.6, thuhet se: “Reklamat në transmetimet audiovizive për trajtimet mjekësore janë të ndaluara. Ndalohet që mjeku të merret me reklamë të çfarëdo lloji, me përjashtim të rasteve kur ato kanë qëllim shkencor dhe edukativ”.
- Mosrespektim të kërkesave për sponsorizimin. Në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 45, pika 1, germa b, thuhet se: “Shërbimet e sponsorizuara nuk duhet të nxisin drejtpërsëdrejti blerjen apo porositjen e mallrave apo shërbimeve, veçanërisht duke bërë përmendje të posaçme promovionale për këto mallra e shërbime.” Në pikën 3, po në këtë nen, përmendet se: “Sponsorizimi i shërbimeve të transmetimit audio dhe audioviziv ose programeve nga shoqëri, persona ose sipërmarrje, veprimtaria kryesore e të cilave përfshin prodhimin

ose shitjen e barnave, produkteve farmaceutike dhe shërbimeve mjekësore, mund të përmendë vetëm emrin ose të tregojë stemën ose imazhe të tjera të tipit përfaqësues të subjektit të sponsorizimit, por nuk mund të reklamojë barna, prodhime të veçanta ose shërbime të caktuara mjekësore që jepen vetëm me recetën e mjekut.”

- Tejkallim i kohës për reklamat dhe komunikimet tregtare. Bazuar në nenin 41 të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar: “Transmetimi i një programi në një shërbim transmetimi mund të përfshijë ndërfitjen e reklamave dhe shitjeve të drejtpërdrejta. Kohëzgjatja e reklamave ose shitjeve të drejtpërdrejta nuk duhet të kalojë 12 minuta për një orë transmetim. Këtu nuk përfshihen njoftimet e OSHMA-së, në lidhje me programet e veta dhe produktet ndihmëse për këto programe, njoftimet për sponsorizimin dhe vendosjen e mallrave në programe”.
- Është sinjalizuar, me shkresa zyrtare, Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, AKBPM, për raste të identifikuar të transmetimit të reklamave mbi barnat mjekësore që nuk kanë përmbushur kërkesat e Rregullores “Për publicitetin e barnave”, bazuar në Urdhrin nr. 25 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, datë 17.01.2019. Veçanërisht shkeljet janë për nenin 9, ku nuk identifikohet qartë me të shkruar dhe lexuar shënimi i detyrueshëm se: “Përpara përdorimit, lexoni me kujdes udhëzimet për përdorimin, dhe konsultohuni me farmacistin ose mjekun tuaj për rreziqet ose efektet e padëshiruara të mundshme”.
- Transmetimi i reklamës politike. Në një rast ka pasur emetim të reklamës politike (jashtë periudhës së fushatës elektorale), duke qenë në kundërshtim me nenin 41, pika 2, të ligjit nr. 97/2013, i ndryshuar, që e cilëson të ndaluar.

Në tabelën e mëposhtme jepen dhe rastet kur AMA ka dërguar tërheqje vëmendjeje:

Nr	Kategoria e shkeljes	OSHMA	Emisioni
1	Transmetim i reklamës politike (jashtë periudhës së fushatës elektorale).	NEWS 24	Edicioni i lajmeve
2	Njoftim për AKBPM për identifikim të reklamimit të barnave (pa recetë).	AKBPM	-
3	Reklamë e fshehtë	RTSH	“Trupi dhe shëndeti”
4	Tërheqje vëmendje për mospublikimin e koeficientëve të ndeshjeve sportive.	RTSH, KLAN, TOP CHANNEL, VIZION PLUS, DIGITALB, TRING, ADTN, NEWS 24, ORA NEWS, REPORT TV, ABC NEWS, EURONEWS ALBANIA, SYRI TV, FAX NEWS	Emisionet sportive

5	Tërheqje vëmendje për respektimin e kërkesave dhe standardeve ligjore për publicitetin e barnave.	RTSH, KLAN, TOP CHANNEL, VIZION PLUS, NEWS 24, ORA NEWS, REPORT TV, ABC NEWS, EURONEWS ALBANIA, SYRI TV, FAX NEWS	Hapësirat publicitare
6	Transmetim mesazhi informues dhe ndërgjegjësesues për fushatën e vaksinimit të popullatës	Të gjitha OSHMA-të	Hapësirat publicitare
7	Shkelje etike. Qëndrime të papërshtatshme.	KLAN	“Zonë e lirë”
8	Shkelje etike. Transmetim të pamje të rënda.	NEWS 24	Edicioni i lajmeve
9	Shkelje etike. Transmetim i pamjeve të rënda.	ABC NEWS	Edicion i lajmeve
10	Kërkesë për informacion për AKU mbi promocionin e produkteve si suplement ushqimor me veti kuruese	AKU	-
11	Reklamë e fshehur.	NEWS 24	“Klinika 24”
12	Reklamë e fshehur.	ABC NEWS	“Doktor Plastik”
13	Shkelje etike. Qëndrime të papërshtatshme.	FAX NEWS	Intervistë
14	Shkelje etike. Qëndrime të papërshtatshme	VIZION PLUS	“Quo Vadis”
15	Shkelje etike. Qëndrime të papërshtatshme	ABC NEWS	“T’ka mami yll”
16	Reklamë e ndaluar.	TOP CHANNEL	“Fiks Fare”
17	Reklamë e ndaluar.	KLAN	“E diela shqiptare”
18	Reklamë e ndaluar.	VIZION PLUS	“Fake off”
19	Reklamë e ndaluar.	KLAN	“Stop”
20	Mosrespektim të kohëzgjatjes së hapësirës reklamuese.	REPORT TV	-
21	Mosrespektim të kohëzgjatjes së hapësirës reklamuese.	NEWS 24	-
22	Shkelje etike. Qëndrime të papërshtatshme.	TOP CHANNEL	“Për’puthen”

23	Shkelje etike. Qëndrime të papërshtatshme.	KLAN	“Love Story 2”
24	Reklamë e fshehur.	KLAN	“Opinion”
25	Reklamë e fshehur produkteve të një kompanie private.	RTSH, KLAN, TOP CHANNEL, VIZION PLUS, NEWS 24, ORA NEWS, REPORT TV, ABC NEWS, EURONEWS ALBANIA, A2/CNN, SYRI TV, FAX NEWS	Edicion lajmesh

7.2 Monitorimet e përmbajtjeve

Për monitorimin e transmetimeve digjitale në Studion e Monitorimit dhe Arkivës së AMA-s, në periudhën janar – dhjetor 2021, kanë qenë në regjistrim 48 njësi regjistrimi, ku përveç subjekteve audio dhe audiovizive, janë në regjistrim edhe platformat Digitalb Satelitor, Digitalb Tokësor, Tring Satelitor, Tring Tokësor dhe Vodafone.


Në terma statistikorë, në total, gjatë këtij viti, janë regjistruar:

- në transmetimet digjitale, në total, janë regjistruar **420,000 (48*365*24)** orë transmetime audiovizive dhe rreth **34,500 (4*12*30*24)** orë transmetime audio.

Krahasuar me vitet e mëparshme janë si më poshtë:

Viti	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
Orë regjistrime televizione	69,000	70,000	142,000	178,000	299,500	410,000	420,000
Orë regjistrime radio	5,000	5,000	5,650	15,700	26,200	30,000	34,500

ECURIA E ORËVE TË REGJISTRIMIT PËR RADIO DHE TELEVISIONE



Krahas regjistrimeve të transmetimeve audio dhe audiovizive, që janë pjesë e Arkivës së Autoritetit të Mediave Audiovizive, puna në Studion e Monitorimit fokusohet në monitorimin e:

A. Edicioneve informative:

Edicione informative, në subjektet audio dhe audiovizivë kombëtarë:

*Janë monitoruar rreth **2,600 edicione informative (1,500 (4*365) edicione të subjekteve audiovizivë kombëtarë dhe 1100 (3*365) edicione të subjekteve audio kombëtare).***

Të dhënat prezantohen në Aneksin Nr. 1, (të dhënat e monitorimit të edicioneve kryesore në OSHMA-të kombëtare) bashkëlidhur këtij raporti.

B. Reklamave;

Monitorimi i reklamave në subjektet audiovizivë kombëtarë:

*janë rreth **25,500 orë** programe të monitoruara.*


Sa i takon monitorimit të edicioneve kryesore informative të OSHMA-ve kombëtare, nga AMA realizohet vlerësimi i një edicioni në ditë, si bartës i linjës editoriale. Të dhënat sasiore të proporcionalitetit kohor, në

edicionet informative kryesore, publikohen rregullisht çdo muaj në website-n e institucionit, në një rubrikë të veçantë.

Krahasuar me vitet e mëparshme, të dhënat janë si më poshtë:


a. Monitorime edicione lajmesh

	Kategoria e OSHMA-ve	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
1	Televizione	900	900	1,340	1500	1500	1500	1500
2	Radio	600	600	770	1000	1100	1100	1100



b. Monitorime reklamash

	Kategoria e OSHMA-ve	Viti 2015	Viti 2016	Viti 2017	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020	Viti 2021
1	Subjekte audiovizive kombëtarë	14,000	14,000	16,000	17,500	17,500	25,500	25,500



b. Monitorimi i fushatës zgjedhore

Për herë të parë, në 21 vite aktivitet, AMA ka monitoruar mbulimin mediatik të OSHMA-ve gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet e përgjithshme të 25 prillit 2021. Më herët, AMA vinte në dispozicion të KQZ-se infrastrukturën e saj monitoruese.

Kodi Zgjedhor i ndryshuar, në nenin 85, përcakton, për herë të parë, që monitorimi i fushatës zgjedhore në mediat audiovizive kryhet nga AMA dhe që monitorimi kryhet në të gjithë territorin ku zhvillohen zgjedhjet. Në zbatim të Kodit Zgjedhor, KQZ, me vendimin nr. 2, datë 30.01.2021 miratoi metodologjinë e monitorimit të medias audio dhe audiovizive, akt në të cilin parashikohen procedurat dhe teknikat që duhet të ndjekë AMA, gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore.

Përpara fillimit të fushatës zgjedhore si dhe në vazhdimësi të saj, AMA ka komunikuar në mënyrë periodike me gjithë OSHMA-të, (shkresa zyrtare, publikime në adresën zyrtare në web, kontakte të drejtpërdrejta etj.)

duke iu bërë me dije kërkesat e Kodit Zgjedhor dhe akteve nënligjore, të miratuara nga KQZ, dhe rëndësinë e zbatimit të tyre.

Në zbatim të detyrimeve të Kodit Zgjedhor mbi aktivitetet e ndaluara nga KQZ, AMA monitoroi programet e operatorëve kombëtare dhe informative, duke nisur nga kontrolli, disa herë në ditë, i faqes zyrtare të internetit të KQZ-së, konkretisht, te rubrika “Aktivitete të ndaluara”, për një periudhë 4 muaj para datës së zgjedhjeve.

Gjatë procesit elektoral, për zgjedhjet parlamentare të vitit 2021, AMA monitoroi 27 kanale (23 TV dhe 4 Radio) në mënyrë të pandërprerë, gjatë 30 ditëve të fushatës elektorale. Një numër tjetër kanalesh u monitorua me përzgjedhje, bazuar në metodologjinë e miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Një tjetër kategori subjektësh OSHMA, të përfshirë në monitorim, ishin subjektet e pajisura me autorizim për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor, internet, IPTV etj.

Për periudhën 1 (një) mujore të fushatës zgjedhore, në Studion e Monitorimit dhe Arkivës kanë qenë në regjistrim 48 (dyzetetë) njësi regjistrimi për subjektet audiovizive dhe 4 (katër) njësi regjistrimi për subjektet audio, që në terma statistikorë përkthehen në 34,500 orë regjistrime audiovizive dhe 2,880 orë regjistrime audio.

AMA përcolli çdo ditë, në KQZ, raportin ditor të monitorimit për datat 26 mars – 23 prill 2021, dhe, për datat 24-25 prill 2021, për respektimin e heshtjes zgjedhore.

Raportet ditore të monitorimit përmbanin të dhënat e mëposhtme:

- Kohën e monitorimit të secilit prej OSHMA-ve në monitorim, për transmetimet nga ora 08:00-00:00.
- Minutazhin e transmetimeve për secilin subjekt zgjedhor.
- Hapësirën për çdo aktor politik.
- Radhën e vendosjes së kandidatëve në edicionet informative.
- Transmetimet live.
- Raportin gjinor të mbulimit të mediatik të kandidatëve.

Mbështetur në Kodin Zgjedhor, AMA, në mënyrë periodike, ka miratuar raportet përmbledhëse të monitorimit duke i propozuar KQZ-së marrjen e masave të parashikuara në Kodin Zgjedhor, për mosdepozitimin e regjistrimeve në AMA; kompensimin e kohës së transmetimit në edicionet informative si dhe masa administrative për rastet e shkeljeve; për respektimin e kriterëve për transmetimin e reklamave politike; për respektimin e kriterëve për publikimin e sondazheve zgjedhore; për zbatimin e kërkesave të Kodit për periudhën e heshtjes zgjedhore; si dhe tërheqje vëmendjeje për respektimin e raportit të përfaqësimit gjinor.

- AMA, me vendimin nr. 51, datë 06.04.2021, ka miratuar raportin e monitorimit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të, për periudhën 26 mars 2021 - 03 prill 2021,
- AMA, me vendimin nr. 56, datë 14.04.2021, ka miratuar raportin e monitorimit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të, për periudhën 04 prill 2021 - 11 prill 2021,
- AMA, me vendimin nr. 59, datë 22.04.2021, ka miratuar raportin e monitorimit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të, për periudhën 12 prill 2021 - 19 prill 2021,
- AMA, me vendimin nr. 62, datë 27.04.2021, ka miratuar raportin e tabelave përmbledhëse të monitorimit të mbulimit të fushatës zgjedhore nga OSHMA-të, për periudhën 26 mars - 23 prill 2021, si dhe

respektimin e periudhës së heshtjes zgjedhore, si dhe tabelat kumulative për pasqyrimin e fushatës zgjedhore, në periudhën 26 mars – 23 prill 2021.

Vlen të theksohet se, për raportet e monitorimit të mediave audio/audi vizive, ka pasur një numër të ulët ankesash/kërkesash nga OSHMA-të drejtuar AMA-s. Këto kërkesa kishin të bënin më shumë me sqarime procedurale sesa me rishikimin e treguesve të monitorimit.

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në funksion të përmirësimit të kapaciteteve monitoruese, duke nisur që nga teknologjia që përdoret në studion e monitorimit dhe, më tej, edhe kualifikimi i stafit për të kryer matje cilësore, ka siguruar bashkëpunimin e Këshillit të Europës në Tiranë, për të përmirësuar studion e monitorimit. Aktualisht, janë zhvilluar disa takime mes Kryetares së Autoritetit dhe përfaqësuesit të KiE në Tiranë, dhe ekspertëve përkatës në Strasburg, me qëllim gjetjen e burimeve të financimit dhe ekspertizën e duhur për të ndërhyrë në modernizimin e studios së monitorimit në AMA.

7.3 Qasja ndaj fenomenit të piraterisë në transmetimet audiovizive

Një tjetër përmasë e rëndësishme e punës sonë, për vitin 2021, ka qenë marrja e masave kundër piraterisë përmes internetit. Gjatë këtij viti janë ushtruar kontrole të shumta në subjektet ISP (internet service provider) të paautorizuara nga AMA për ofrimin e shërbimit audioviziv. Ky është një fenomen i shpërndarë tashmë në gjithë botën, ku pirateria nëpërmjet internetit është shtuar së tepërmi dhe po kthehet në një problem shqetësues ndërkombëtar. Autoriteti i Mediave Audiovizive, nëpërmjet specialistëve të saj, si dhe bashkëpunimit me operatorët privatë (Digitalb dhe Tring) ka identifikuar një sërë shtesh (linqe) pirate, që transmetojnë produkte audiovizive pa autorizimin e AMA-s, si filma artistikë apo evente sportive. Këto site, i janë dërguar organit kompetent AKEP, për marrjen e masave për mbylljen e aksesit në territorin e vendit.

Nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit midis AMA-s dhe AKEP-it, në datën 03.11.2021, si dhe ngritja e grupeve të përbashkëta të punës, në zbatim të tij, do t'i japë një qasje tjetër këtij fenomeni, në vitet në vijim. Është për t'u theksuar se, edhe me vullnetin e mirë të dy institucioneve, fenomeni i piraterisë nëpërmjet internetit kërkon një investim dhe bashkëpunim të më shumë institucioneve të tjera ligjzbatuese si policia e shtetit, krimi ekonomik, krimi kibernetik etj.

Duhet theksuar se këto subjekte, me ushtrimin e aktivitetit të tyre të paligjshëm, shkaktojnë një dëm të madh ekonomik dhe dëmtim të imazhit për subjektet e autorizuar/licencuara nga AMA. Gjithashtu, ky fenomen shkakton dhe një dëm ekonomik në bilancin e të ardhurave të shtetit.

Siç u theksua dhe më lart, bashkëpunimi ndërinstitucional është një domosdoshmëri për reduktimin e këtij fenomeni.

8. KËSHILLI I ANKESAVE

Shqyrtimi i ankesave

Edhe gjatë vitit 2021, në situatën e vijimit të pandemisë së krijuar nga Covid-19, në përmbushje të detyrave, objektivave të përcaktuara, angazhimeve dhe rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë, Këshilli i Ankesave pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA) ka vijuar mbikëqyrjen e zbatimit të Kodit të Transmetimit dhe të rregulloreve të miratuara nga AMA.

Këshilli i Ankesave ka shqyrtuar, me kujdes dhe profesionalizëm, ankesat e dërguara në AMA, përmes postës, e-mailit zyrtar të Autoritetit, rrjeteve sociale dhe strukturës së Call Center.

Gjithashtu, Këshilli i Ankesave ka vijuar shtimin e kontakteve me Bordet e Shqyrtimit të Ankesave pranë OSHMA-ve, me agjencitë dhe organizatat për mbrojtjen e fëmijëve: - në veçanti me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale, si një agjenci e cila ndjek drejtpërdrejt problemet që lidhen me fëmijët, duke i referuar pranë Këshillit të Ankesave rastet e evidentuara në mediat audiovizive; - me grupin e deputetëve “Miq të fëmijëve” në Parlament, me strukturat parlamentare dhe ministrore për Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut (SELP), si dhe me aktorë dhe faktorë të rëndësishëm në fushën e mediave audiovizive.

Këshilli i Ankesave ka trajtuar dhe propozuar masat përkatëse për qindra ankesa, të dërguara në AMA nga qytetarë, institucione dhe organizata të ndryshme, mbi probleme të përmbajtjeve audiovizive.

Pjesa më e madhe e shqetësimeve dhe ankesave, të ardhura përmes postës zyrtare, postës elektronike, apo strukturës së Call Center, kishin si objekt të tyre shkeljen e të drejtave të njeriut, të normave ligjore dhe etike, shkeljen e të drejtave të fëmijëve, cenimin e dinjitetit, si dhe disa ankesa të shtuara ndaj rrjeteve sociale, portaleve dhe gazetave.

Këshilli i Ankesave është kujdesur që, në çdo rast, ankuesit të merrnin një përgjigje paraprake, para se të njihen me konkluzionet përfundimtare, brenda afateve të parashikuara ligjore. Por, gjithashtu, ka refuzuar, bazuar në ligjin përkatës, ankesat e paidentifikuara dhe të paplotësuara, sipas përcaktimeve në Formularin e Ankesës, dokument që është lehtësisht i aksesueshëm në faqen zyrtare të Autoritetit.

Gjithsej, gjatë gjithë periudhës raportuese, Këshilli i Ankesave ka shqyrtuar mbi 300 ankesa; pjesa më e madhe e tyre janë dërguar pranë Autoritetit nga individë, nga shoqata e organizata të shoqërisë civile.

Për shkak të objektit të njëjtë, një pjesë e konsiderueshme e ankesave - në këtë rast, për tre emisione televizive - janë konsideruar si një ankesë e vetme.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Këshilli i Ankesave u ka tërhequr vëmendjen operatorëve në 22 raste; në dy raste u ka kërkuar atyre zhvendosjen e orarit të transmetimit për dy seriale filmike, sipas përcaktimeve të Kodit të Transmetimit. Operatorët reagues në një kohë të shpejtë, duke marrë në konsideratë respektimin e kërkesave dhe normave etike e ligjore të Kodit të Transmetimit; në dy raste të tjera u është kërkuar operatorëve audiovizivë respektimi i të drejtës së përgjigjes, kërkesë që është respektuar nga operatorët; në tre raste është kërkuar korrigjim/korrektim i informacionit të transmetuar; në 5 raste u është kërkuar operatorëve paraqitja e pretendimeve dhe më pas, është konkluduar në arsyetimin final; në tri raste është kërkuar nga subjekte të ndryshme informacion në lidhje me një fushatë të iniciuar nga AMA, dhe në 13 raste ankesat janë rrëzuar, pasi ose ishin jashtë afateve të përcaktuara nga ligji, ose ishin jashtë objektit të

punës së Këshillit të Ankesave, ose u mungonin elementë të rëndësishëm për të vijuar me shqyrtimin e ankesave.

Vlen të theksohet që, në një rast, ku pati disa ankesa për një emision televiziv, drejtuesit e operatorit audioviziv kërkuan falje publike për shkeljen e etikës.

Sipas objektit, ankesat paraqiten si më poshtë:

- 35% me objekt shkeljen e të drejtave të fëmijëve, privatësisë së tyre;
- 31% me objekt shkeljen e të drejtave të njeriut, etikës dhe moralit publik;
- 11% rezultuan jashtë objektit të punës së AMA-s, përcaktuar nga ligji nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- 6% për të drejtën e përgjigjes;
- 5% për verifikim informacioni;
- dhe pjesa tjetër kishin objekt të ndryshëm.

Aktivitete

Në zbatim të objektivave, të prioriteteve të përcaktuara nga AMA dhe të detyrave të lëna nga Kuvendi i Shqipërisë, veç procesit të përditshëm të marrjes dhe trajtimit të ankesave, Këshilli i Ankesave ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në disa aktivitete të përbashkëta, me partnerë institucionalë dhe ndërkombëtarë.

Këtu mund të përmendim pjesëmarrjet në të gjitha takimet/mbledhjet në nivel parlamentar dhe ministror mbi Strategjinë për Edukimin Ligjor të Publikut (ndër të tjera, kemi informuar Rrjetin e SELP-së, gjatë periudhës 2021-2023 është parashikuar një anketim/konsultim publik për Kodin e Transmetimit për median audiovizive, përfundimet e të cilit do të na shërbejnë për procesin e përmirësimit të këtij dokumenti të rëndësishëm); aktivitetet për zhvillimin e medias shqiptare sa u përket sfidave për parandalimin e gjuhës së urrejtjes dhe diskriminimit të çdo forme; zhvillimit dhe sfidave për të ardhmen të teknologjisë mediatike; dhe disa aktiviteteve me fokus mbrojtjen e fëmijëve nga transmetimet e dëmshme audiovizive.

Gjatë vitit 2021, Këshilli i Ankesave ka iniciuar dhe ndjekur disa projekte për tema të rëndësishme që lidhen me transmetimet audiovizive, si media dhe BE, Kodi i Transmetimit dhe të rinjtë, AMA dhe përvoja më e mirë e monitorimit të fushatave elektorale etj.

Në këtë kontekst, duhet theksuar se Këshilli i Ankesave ishte pjesëmarrës aktiv në monitorimin e fushatës elektorale për zgjedhjet e përgjithshme politike të 25 prillit, sipas përcaktimeve ligjore, dhe pjesëmarrës në takimet dhe konsultimet me përfaqësues të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ).

Mandatet e Këshillit të Ankesave

Në nëntor 2021 përfundoi mandati 3-vjeçar i Kryetarit të Këshillit të Ankesave, ndërsa gati një muaj më vonë përfunduan mandatet e të dy anëtarëve të Këshillit. Me zgjedhjen e anëtarëve të rinj të AMA-s pritet plotësimi i tre vendeve vakante të Këshillit të Ankesave. Aktualisht është shpallur procedura për Kryetarin e Këshillit të Ankesave dhe më pas do të vijojë procedura edhe për dy anëtarët.

9. AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË ZBATUESHMËRISË LIGJORE

9.1 Referencat ligjore mbi të cilat mbështetet aktiviteti i institucionit

AMA e mbështet veprimtarinë e vet administrative dhe rregullatore në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe në legjislacionin sekondar (rregullore, vendime dhe udhëzime) të miratuar në bazë dhe zbatim të ligjit të posaçëm organik. Gjithashtu, veprimtaria e AMA-s ushtrohet në përputhje me Kushtetutën, ligjet dhe aktet nënligjore, që rregullojnë fushën e medias audio dhe audiovizive.

Kuadri ligjor, mbi të cilin mbështetet veprimtaria administrative e Autoritetit të Mediave Audiovizive, nuk ka pësuar shtesa apo ndryshime gjatë periudhës raportuese. Gjatë kësaj periudhe, përmes legjislacionit sekondar është plotësuar kuadri ligjor me akte rregullatore që synojnë krijimin e një mjedisi rregullator, që lehtëson zhvillimin e sektorit të transmetimeve audiovizive.

9.2 Plotësimi i akteve nënligjore të domosdoshme për ushtrimin e aktivitetit të OSHMA-ve

AMA, në cilësinë e autoritetit rregullator për shërbimet audio dhe audiovizive, ka të drejtë dhe kompetencë për të hartuar akte nënligjore në zbatim të ligjit organik, dhe në këtë kuadër, edhe gjatë vitit 2021, është punuar për hartimin apo ndryshimin e legjislacionit sekondar, me qëllim që, brenda kuadrit ligjor, të përmirësohet aktiviteti i AMA-s dhe të lehtësohet veprimtaria e operatorëve audio/audiovizivë.

Në zbatim të përcaktimeve të legjislacionit organik dhe në funksion të transparencës institucionale, por edhe të nevojës për marrjen e mendimeve, propozimeve dhe komenteve të grupeve të interesit, hartimi i kuadrit nënligjor është shoqëruar me kryerjen e procesit të konsultimit dhe këshillimit publik.

AMA, në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në vitin 2021 ka miratuar aktet nënligjore si më poshtë:

- Rregulloren “Për kriteret dhe masat rregulluese për bashkëpërdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH-së”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 39, datë 11.03.2021. Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat për bashkëpërdorimin e infrastrukturës së transmetimit të RTSH-së, nga ofruesit e shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv, të licencuar për transmetime audio dhe/ose audiovizive tokësore dhe subjektet e licencuar për ofrimin e shërbimit të programit audio/audioviziv.
- Rregulloren “Për procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve për shfrytëzimin e multipleksit”, miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 40, datë 11.03.2021. Qëllimi i kësaj rregulloreje është zgjidhja e mosmarrëveshjeve midis mbajtësve të licencave kombëtare, rajonale e lokale të transmetimeve numerike audio dhe licencave kombëtare numerike të transmetimit audioviziv, operatorit publik (RTSH) dhe OSHMA-ve lidhur me shfrytëzimin e multipleksit, rrjetit numerik.
- Rregulloren “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e autorizimit për përdorimin e frekuencave të brezit HF, për ofrimin e shërbimit audio” miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 63, datë 27.04.2021. Kjo rregullore përcakton rregullat, kriteret dhe procedurat për dhënien e autorizimit për përdorimin e

frekuencave të brezit HF, për ofrimin e shërbimit audio në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe Planit Kombëtar të Frekuencave.

Nga ana tjetër, në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, AMA, ka hartuar projektregulloren “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio analoge”. Ky projektakt synon të përmirësojë dhe plotësojë dispozitat procedurale dhe materiale për lëshimin dhe rinovimin e licencave të transmetimit audio analoge, proces që deri tani është kryer në zbatim të rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio”, miratuar nga AMA në vitin 2016, me ndryshimet përkatëse.

Projektregullorja, në kuadër të procesit të këshillimit publik, është publikuar në faqen zyrtare të AMA-s, bazuar në nenin 48 të ligjit nr. 97/2013, sipas të cilit “*Në procesin e këshillimit publik, AMA publikon dokumentet rregullatore të propozuara dhe kërkon paraqitjen me shkrim të mendimit të palëve të interesuara, brenda një afati kohor të publikuar, i cili nuk duhet të jetë më pak se 30 ditë.*” AMA ka përcjellë për mendim projektdraftin në Autoritetin e Konkurrencës, i cili është shprehur dakord për të.

Po ashtu, duke qenë se ky akt nënligjor ka impakt në veprimtarinë e subjekteve audio, AMA, në muajin shkurt, ka zhvilluar takime konsultative me subjektet audio, me qëllim diskutimin e ndryshimeve të propozuara dhe marrjen e komenteve dhe sugjerimeve të tyre.

Propozimet e palëve për lehtësimin e procedurave të rilicencimit, rishikimin e tarifave financiare të licencës audio, zgjatjen e afatit të vlefshmërisë së licencës dhe të tjera, janë në fazën e vlerësimit nga AMA.

9.3 Nevoja për ndryshime të kuadrit ligjor që rregullon veprimtarinë e institucionit

Direktiva 2010/13/BE e Parlamentit Evropian dhe Këshillit, datë 10 mars 2010, “Për koordinimin e disa dispozitave të parashikuara me ligj, rregullore apo akte administrative në shtetet anëtare, lidhur me ofrimin e shërbimit të transmetimeve me zë dhe figurë”, e cila është e transpozuar plotësisht në ligjin nr. 97/2013, ka pësuar ndryshime në fund të vitit 2018 (Direktiva 2018/1808, datë 14.11.2018).

Ndryshimet kryesore në Direktivën AVMS lidhen me përfshirjen, në fushën e zbatimit të saj, e platformave për shpërndarjen e videove, përcaktimin e detyrimeve të ofruesve të platformave të ndarjes së videove, rishikimin e detyrimeve për ofruesit e shërbimeve audiovizive me kërkesë (on demand service), rishikimin e rregullave për transmetuesit audiovizive për mbrojtjen e të miturve nga përmbajtjet e dëmshme etj. Po ashtu, në këtë dokument gjejmë trajtim edhe një sërë çështjesh të tjera si nxitja e bashkërregullimit dhe e vetërregullimit përmes kodeve të sjelljes, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen e të miturve kundrejt komunikimeve tregtare, rregulla mbi rritjen e transparencës së pronësisë së ofruesve të shërbimeve mediatike. Një vend i posaçëm në të, i kushtohet edhe sigurimit të aksesit në informacion të personave me nevoja të veçanta shqisore.

Referuar parashikimeve të Direktivës së ndryshuar, shtetet anëtare ngarkohen për miratimin e ndryshimeve ligjore dhe nënligjore, për të qenë në pajtueshmëri me këtë akt, në shtator 2021. Në kuadër të angazhimeve

që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit, harmonizimi i legjislacionit të fushës audiovizive me “*acquis communautaire*” është detyrim për Shqipërinë.

Duke njohur rëndësinë e transpozimit të kësaj direktive, në përmbushje jo vetëm të detyrimeve ndërkombëtare që lidhen me procesin e integritetit të vendit tonë në BE, por edhe në kuadër të përmirësimit të kuadrit kombëtar ligjor dhe nënligjor në fushën e mediave audio/audiovizive, AMA, me shkresën nr. 2682 prot, datë 06.08.2021, i është drejtuar Kuvendit dhe Ministrisë së linjës për iniciimin e procesit të transpozimit të Direktivës 2018/1808. Referuar ndryshimeve që sjell kjo direktivë, procesi i transpozimit kërkon përfshirjen edhe të institucioneve të tjera për çështje të caktuara.

Në vijim të kërkesës së AMA-s dhe me propozim të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) me shkresën nr. 6144/1 prot., datë 17.09.2021, si dhe në kuadër të procesit të rishikimit të Planit Kombëtar të Integritetit Evropian (PKIE) për periudhën 2020-2024, në MIE, janë zhvilluar dy takime me përfaqësues nga AMA dhe institucione të tjera, të cilat mund të preken nga ndryshimet e Direktivës 2010/13/BE, si Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës, Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve, etj. Kjo referuar faktit se ndryshimet që sjell kjo direktivë, prekin fushat e veprimit të institucioneve të tjera, për çështje të caktuara.

Në përfundim të takimeve është dakordësuar transpozimi i pjesshëm i kësaj direktive, duke përfshirë në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, disa nga nenet e direktivës, të cilat ndryshojnë/përmirësojnë atë, sikurse janë: mbrojtja e fëmijëve, aksesit në media të personave me aftësi të veçanta, çështjet e juridiksionit, promovimi i veprave evropiane etj. Ndërkohë rregullimi në ligj i aktivitetit të platformave për ndarjen e videove (video sharing platform), shërbim i cili, aktualisht, nuk normohet në legjislacionin vendas, është shtyrë në një moment të dytë, pasi është i nevojshëm një diskutim më i gjerë me disa institucione të përfshira në këtë proces, me qëllim përcaktimin e kompetencave dhe përgjegjësi përkatëse.

Transpozimi i pjesshëm i direktivës është planifikuar në PKIE 2022-2024, për t’u realizuar në tremujorin e katërt të vitit 2022.

AMA, në cilësinë e rregullatorit ka identifikuar dispozitat në fuqi të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, lidhur me mbrojtjen e fëmijëve, reklamën, juridiksionin, aksesueshmërinë e personit me aftësi të kufizuara etj., të cilat preken nga ndryshimet e Direktivës (BE) 2018/1808.

9.4 Mbikëqyrja e shfrytëzimit të spektrit të frekuencave

Në kuadër të finalizimit të procesit të digjitalizimit, fokusi kryesor, edhe gjatë vitit 2021, sa i takon mbikëqyrjes së shfrytëzimit të spektrit të frekuencave, ka qenë monitorimi në terren lidhur me shtrimin e infrastrukturës numerike nga operatorët privatë kombëtarë audiovizivë, identifikimi i mbulimit me sinjal numerik audioviziv të territorit të vendit si dhe verifikimi i mbështetjes së operatorëve lokalë/rajonale në rrjetet kombëtarë numerike.

Nga monitorimet e kryera në të gjitha qarqet e vendit, në përfundim të procesit të digjitalizimit, rezulton se RTSH dhe operatorët privatë kombëtarë numerikë nuk mbulojnë me sinjal numerik zona të caktuara të vendit, si më poshtë:

1. OPERATORI PUBLIK SHQIPTAR, RTSH

QARKU BERAT

- Lagjet mbas Kalasë së Beratit
- Njësia administrative Roshnik
- Njësia administrative Sinjë
- Njësia administrative Potom
- Njësia administrative Çëpan.

Rreth 5% e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU KORÇË

- Njësia administrative Voskopojë
- Njësia administrative Dardhë
- Çerrave (qendër)
- Njësia administrative Mokërr (pjesërisht)
- Njësia administrative Gorë
- Njësia administrative Barmash.

Rreth 6 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARQET TIRANË – DURRËS

- Njësia administrative Shëngjergj
- Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
- Njësia administrative Krujë
- Njësia administrative Cudhi.

Rreth 2 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU ELBASAN

- Komuna Labinot (Fushë-Xibrakë)
- Njësia administrative Qukës (pjesërisht)
- Njësia administrative Lunik (Kostenjë, Dranovicë, Orenjë, Streblevë).

Rreth 1 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU VLORE

- Njësia administrative Borsh (pjesërisht)
- Njësia administrative Himarë (pjesërisht)
- Fshatrat e lumit të Vlorës (Drashovicë, Kotë, Brataj, Tërbaç, Velçë, Vranisht, Kuç).

Rreth 3 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU SHKODËR

- Njësia administrative Ana e Malit.
- Njësia administrative Vau i Dejës (pjesërisht).
- Njësia administrative Kelmend.

Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU GJIROKASTËR

- Njësia administrative Picar
- Njësia administrative Zagore
- Njësia administrative Kurvelesh
- Njësia administrative Krahës
- Njësia administrative Qesarat
- Njësia administrative Dropull i sipërm
- Njësia administrative Pogon.

Rreth 19 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU DIBËR

- Njësia administrative Maqellarë (pjesërisht)
- Njësia administrative Sllovë, Kala e Dodës.

Rreth 6% e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU KUKËS

- Njësia administrative Lek Bibaj.

Rreth 2 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

2. SHOQËRIA “MEDIA VIZION”

QARKU BERAT

- Njësia administrative Kuçovë
- Njësia administrative Polican
- Njësia administrative Çorovodë.

Rreth 19% e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU KORÇË

- Njësia administrative Voskopojë
- Njësia administrative Dardhë
- Njësia administrative Cërravë
- Njësia administrative Mokër.

Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU TIRANË

- Njësia administrative Zall Bastar
- Njësia administrative Shëngjergj
- Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
- Njësia administrative Krrabë
- Njësia administrative Ndroq.

Rreth 2 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU Durrës

- Njësia administrative Krujë
- Njësia administrative Cudhi.

Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU SHKODËR

- Njësia administrative Malësia e Madhe
- Njësia administrative Pukë
- Njësia administrative Vau i Dejes
- Njësia administrative Fushë - Arrëz
- Njësia administrative Ana- Malit.

Rreth 8 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU KUKËS

- Njësia administrative Bajram Curri
- Njësia administrative Has.

Rreth 12 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU PESHKOPI

- Njësia administrative Peshkopi
- Njësia administrative Bulqizë
- Njësia administrative Klos
- Njësia administrative Maqellarë
- Njësia administrative Burrel.

Rreth 41 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU LEZHË

- Njësia administrative Rrëshen.

Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU ELBASAN

- Njësia administrative Përrenjas
- Njësia administrative Librazhd
- Njësia administrative Qukës
- Njësia administrative Peqin
- Njësia administrative Gramsh.

Rreth 8 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU GJIROKASTËR

- Njësia administrative Tepelenë
- Njësia administrative Përmet
- Njësia administrative Këlcyrë
- Njësia administrative Krahës
- Njësia administrative Picar
- Njësia administrative Zagorie
- Njësia administrative Kurvelesh
- Njësia administrative Qesarat

- Njësia administrative Dropull
- Njësia administrative Pogon.

Rreth 40 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU VLORE

- Njësia administrative Delvinë
- Njësia administrative Dhërmi
- Njësia administrative Borsh
- Njësia administrative Konispol
- Fshatrat e lumit të Vlorës (Drashovicë, Kotë, Brataj, Tërbaç, Velcë, Vranisht, Kuç etj.).

Rreth 7 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

3. SUBJEKTI TV “KLAN”

QARKU KORÇË

- Njësia administrative Voskopojë
- Njësia administrative Dardhë
- Njësia administrative Çërravë
- Njësia administrative Mokër (pjesërisht).

Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU TIRANË

- Njësia administrative Zall Bastar
- Njësia administrative Shëngjergj
- Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
- Njësia administrative Krrabë
- Njësia administrative Ndroq.

Rreth 2 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU DURRËS

- Njësia administrative Krujë
- Njësia administrative Cudhi.

Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU SHKODËR

- Njësia administrative Malësia e Madhe
- Njësia administrative Pukë
- Njësia administrative Fushë – Arrëz
- Njësia administrative Ana e Malit.

Rreth 8 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU GJIROKASTËR

- Njësia administrative Krahës
- Njësia administrative Picar
- Njësia administrative Zagorie
- Njësia administrative Kurvelesh
- Njësia administrative Qesarat
- Njësia administrative Dropull
- Njësia administrative Pogon.

Rreth 25 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU VLORE

- Njësia administrative Borsh
- Njësia administrative Konispol
- Fshatrat e lumit të Vlorës (Drashovicë, Kotë, Brataj, Tërbaç, Velcë, Vranisht, Kuç etj.).

Rreth 3 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

4. SUBJETET TV “TOP –CHANNEL”, “DIGIT-ALB” DHE “ADTN”

QARKU BERAT

- Njësia administrative Kuçovë
- Njësia administrative Poliçan (DIGITALB” DHE “ADTN”)
- Njësia administrative Çorovodë.

Rreth 19 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU KORÇË

- Njësia administrative Ersekë
- Njësia administrative Leskovik
- Njësia administrative Voskopojë

- Njësia administrative Dardhë
- Njësia administrative Cërravë
- Njësia administrative Mokër.

Rreth 6 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU FIER

- Pjesërisht Bashkia Divjakë.

Rreth 0.3 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU TIRANË

- Bashkia Kavajë
- Njësia administrative Zall Bastar
- Njësia administrative Shëngjergj
- Njësia administrative Baldushk (pjesërisht)
- Njësia administrative Krrabë
- Njësia administrative Ndroq
- Pjesërisht Bashkia Vorë.

Rreth 6 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU DURRËS

- Njësia administrative Krujë
- Njësia administrative Cudhi.

Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU SHKODËR

- Njësia administrative Malësia e Madhe
- Njësia administrative Vau i Dejës
- Njësia administrative Fushë - Arrëz
- Njësia administrative Ana- Malit.

Rreth 8 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU KUKËS

- Njësia administrative Bajram Curri
- Bashkia Kukës

- Njësia administrative Has.

Rreth 75% e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU DIBËR

- Njësia administrative Bulqizë
- Njësia administrative Peshkopi (“DIGIT-ALB” DHE “ADTN”)
- Njësia administrative Klos
- Njësia administrative Maqellarë
- Njësia administrative Burrel.

Rreth 41% e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU LEZHË

- Njësia administrative Rrëshen.

Rreth 4 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU ELBASAN

- Njësia administrative Përrenjas
- Njësia administrative Librazhd (“DIGITALB” DHE “ADTN”)
- Njësia administrative Qukës
- Njësia administrative Peqin
- Njësia administrative Gramsh.

Rreth 8 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU GJIROKASTËR

- Njësia administrative Tepelenë
- Njësia administrative Përmet
- Njësia administrative Këlcyrë
- Njësia administrative Krahës
- Njësia administrative Picar
- Njësia administrative Zagorie
- Njësia administrative Kurvelesh
- Njësia administrative Qesarat
- Njësia administrative Dropull
- Njësia administrative Pogon.

Rreth 40 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

QARKU VLORË

- Njësia administrative Borsh
- Njësia administrative Selenicë
- Njësia administrative Himarë (“DIGITALB” DHE “ADTN”)
- Njësia administrative Dhërmi (“DIGITALB” DHE “ADTN”)
- Njësia administrative Konispol.
- Njësia administrative Delvinë (“DIGITALB” DHE “ADTN”).
- Fshatrat e lumit të Vlorës (Drashovicë, Kotë, Brataj, Tërbaç, Velcë, Vranisht, Kuç etj.).

Rreth 16 % e popullsisë së këtij qarku nuk mbulohet me shërbim.

Në nivel kombëtar, përqindja e popullsisë së pambuluar me shërbim audioviziv numerik është paraqitur në tabelën si vijon për çdo operator.

Nr.	Subjekti	Përqindja e popullsisë e pambuluar me shërbim audioviziv numerik
1	RTSH	2.8%
2	TV Klan	3%
3	Top Channel	11%
4	Digitalb	11%
5	Media Vizion	7.5%
6	ADTN	11%

Gjithashtu, gjatë vitit 2021, është kryer monitorim i shfrytëzimit të spektrit audio, në sistemin e qendëruar të monitorimit, si dhe në terren, në kuadër të ankesave të paraqitura në AMA për interferencë, si dhe në kuadër të çeljes së garave për frekuenca audio FM, për të identifikuar nëse frekuencat e propozuara për çelje gare janë të pastra nga ndërhyrje të ndryshme nga vendet fqinjë apo nga ndërhyrje të brendshme.

10. AUTORITETI SI NXITËS I ZHVILLIMIT TË SEKTORIT AUDIOVIZIV

10.1 Angazhimi i Autoritetit në zhvillimet teknologjike të tregut audioviziv

“Teknologjia dhe infrastruktura e transmetimeve audio/audiovizive në kohën digjitale”

AMA, në bashkëpunim me shoqatën “Inxhinierëve Broadcasting Shqiptarë”, gjatë vitit 2021, ka mundësuar realizimin e projektit me titull “Teknologjia dhe infrastruktura e transmetimeve audio/audiovizive në kohën digjitale”. Ky projekt kishte për qëllim përmbushjen e objektivave si më poshtë:

- Përditësimin e njohurive mbi teknologjinë digjitale DVB-T2.
- Arkitektura e rrjetit DVB-T2, përshkrimi i të gjitha hallkave si dhe trajtimi nga ana teoriko-praktike të gjithë aspekteve dhe diferencimi me transmetimet DVB-T.
- Përditësimin e njohurive teorike dhe praktike për karakteristikat në radiofrekuencë të rrjetit DVB-T2, detajet teknike të zonave të mbulimit, allotmentet, kapacitetet transmetuese.
- Përditësimin e njohurive mbi Teknologjinë T-DAB dhe teknologjitë e avancuara digjitale për transmetimet audio.
- Thellimin e njohurive teoriko-praktike për karakteristikat në radiofrekuencë të transmetimeve audio/audiovizive digjitale, mbrojtja nga interferencat e shërbimeve të tjera si radionavigacioni, LTE etj.
- Njohjen dhe përdorimin e duhur të pajisjeve monitoruese në radio frekuencë si dhe pajisjet që përdoren për teknologjitë digjitale.
- Praktika më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare në implementimin e rrjeteve digjitale.

Aktivitetet e zhvilluara në përmbushje të objektivave ishin:

- *Konferencë/trajnim teorik mbi transmetimet digjitale;*

Me praninë e përfaqësuesve inxhinierë dhe teknikë të operatorëve audio/audiovizivë, përfaqësues të autoriteteve kombëtare vendimmarrëse dhe palëve të interesuara si ekspert të fushës apo edhe studentë të universiteteve teknike.

- *Seanca teoriko - praktike dhe matjeve të sinjaleve DVB-T2;*

Me praninë e palëve të interesuara, në 5 qarqe të vendit dhe me vizita trajnuese/matje në pika antenash transmetuese të sinjaleve DVB-T2 për qytete të ndryshme si Tiranë (Dajt), Elbasan, Vlorë, Shkodër dhe Fier.

- *Konferencë përmbledhëse e të gjithë aktivitetit trajnues;*

Një përmbledhje dhe përditësim i praktikave më të mira të përdorura nga operatorët kombëtarë, një rishikim i gjetjeve dhe sugjerime për përmirësime në të ardhmen.

- *Publikimi i një broshure/buletin teknik me ISBN.*

Përmbledhje e materialeve trajnuese, të përdorura në aktivitetet e mësipërme, dhe paraqitja e tyre si një referencë për të ardhmen, për të gjitha palët e interesuara në lidhje me teknologjinë dhe infrastrukturën e transmetimeve audio/audiovizive në kohën digjitale.

Projekti zgjati 10 muaj dhe u finalizua me sukses në dhjetor 2021.

10.2 Kontributi i Autoritetit në mbështetje të studimeve shkencore

“Konvergenca e medias dhe fenomeni i post të vërtetës”

Në vijim të publikimit në shqip të literaturës së huaj, AMA ka mbështetur, gjatë vitit 2021, projektin “Konvergenca e medias dhe fenomeni i post të vërtetës”, realizuar nga Qendra “New Policy Group”. Objektivi kryesor ishte përkthimi dhe publikimi me ISBN i librit “Post-Truth: Lufta e re kundër të vërtetës dhe si t’i kundërpërgjigjemi”, i autorit Mathew D’Ancona, si dhe organizimi i eventeve (tryeza diskutimi mbi këtë publikim dhe problematikat aktuale në tregun audioviziv) në disa qytete të vendit. Sjellja e D’Ancona në shqip është një pasurim për bibliotekën personale të punonjësve në median audiovizive, si dhe në të gjithë tregun mediatik, por dhe për ekspertët, pedagogët e studentët që studiojnë për shkencat e komunikimit dhe gazetari.

Problematikat dhe pikëpamjet, që shtjellon libri, janë pjesë e debatit, që zhvillohet sot mbi efektin të vërtetave në media, për rolin dhe ndikimin që ka te publiku paraqitja e të ashtuquajturave “të vërteta alternative” ose “fakteve alternative”, të cilat ushqejnë drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt makineritë e propagandës dhe dezinformimit – që, në fakt, janë instrumentalizimi i informacionit nga grupe politike, të biznesit etj.

“Përkthime nga literatura e huaj në shqip”

Ky projekt ka si produkte kryesore përkthimin dhe publikimin (me ISBN) të tri veprave:

- **“Du journalism en démocratie” (“Gazetaria në demokraci”) të autores Géraldine Muhlmann, botim i vitit 2017.**

Libri “Gazetaria në demokraci” është shumë i rëndësishëm në fushën e mediave dhe gazetarisë. Ai ka si qëllim të hulumtojë rolin e gazetarisë e, në të njëjtën kohë, të studiojë natyrën e gazetarisë dhe rolin e saj në demokraci. Për këtë arsye, autorja thotë se, shpesh, ka një debat të madh mbi gazetarinë. Muhlman niset në analizën e idesë se, sot, gazetaria është vënë në pikëpyetje, pasi gjithnjë e më shumë po akuzohet si një profesion jo fort i ndershëm, që shpesh shërben për të dhënë një pamje jo fort të drejtë të panoramës socio-politike. Ajo bën pyetje të rëndësishme si: Çfarë duhet të jetë gazetaria? Çfarë idealesh duhet të promovojë ajo? Sipas saj, sot, diskutimi mbi gazetarinë rrallë shkon përtej analizës së fjalës së lirë dhe analizës së pushtetit të katërt. Analiza që bën Muhlman niset nga një bazë e fortë e traditës filozofike për të arritur në konkluzionin se gazetaria duhet të marrë një dimension të ri e të rinovohet. Vetë gazetaria është esenciale për demokracinë e shkon paralel me të, duke mundësuar jo vetëm shpalosjen e realitetit, por edhe një mënyrë për të ofruar informacion dhe zgjidhje të konflikteve të ndryshme. Ky tekst është esencial për publikun e gjerë, i ndjeshëm për cilësinë e informacionit. Po kështu, ky libër është i rëndësishëm për studentët e gazetarisë, pasi i mëshon faktit se gazetaria nuk është vetëm profesion por një mision në funksion të ruajtjes së demokracisë.

- **“Une histoire des medias-des origines à nos jours” (“Historia e mediave – nga fillesat e deri më ditët e sotme”) të autorit Jean-Noël Jeanneney, botim i vitit 2015.**

Libri “Historia e mediave” reflektonte jo vetëm natyrën specifike që ka analiza e subjektit, por plotësohet nga elementë të rëndësishëm personalë të autorit si njohës i mirë dhe aktiv profesionalisht në botën e mediave. Qëllimi i librit është të ofrojë një panoramë të gjerë të historisë së shoqëritë perëndimore kanë ndërtuar mekanizma për të njohur veten dhe të tjerët. Historia e medieve lidhet fillimisht me ndryshimet teknologjike, por forcohet në përpjekjet e grupeve të ndryshme shoqërore për të manifestuar identitetin e tyre. E ky identitet lidhet me konceptin e lirisë së shtypit, që sipas autorit ka qenë një prej fitoreve më të mëdha e të vështira të medieve. Autori kështu shpjegon se si aktorë të ndryshëm shoqërorë, publikë apo privatë kanë kërkuar po kështu mënyra të ndryshme për të influencuar mediat, duke filluar nga gazetatat, televizioni deri tek internet. Përmes historisë së medieve, autori na jep gjithashtu një material për të reflektuar mbi të ardhmen e medieve dhe komunikimit masiv.

- **“La comunicazione politica online” (“Komunikimi politik online - si ta përdorim web-in për të ndërtuar konsensusin dhe nxitur pjesëmarrjen?”), të autorit Gianluca Giansante, botim i vitit 2014.**

Libri “Komunikimi politik online” është ndërtuar në formën e një manuali shpjegues mbi mediet e reja dhe përdorimin e tyre në fushat politike. Ai nis nga disa konstatime të rëndësishme: së pari, nevoja e përdorimit të rrjetit për të krijuar një raport besimi mes politikës dhe qytetarëve; së dyti, ai kërkon të shpjegojë mënyrat sesi pjesëmarrja dhe hapësira virtuale mund të ndikojnë në aktivizimin politik-social jashtë rrjetit.

Ky libër ndërtohet mbi bazën e dy shqetësimeve të mësipërme duke analizuar format e komunikimit dhe fushatat politike në hapësirën virtuale. Më pas autori na jep një vështrim kritik, por edhe raste praktike të përdorimit të medieve, në të gjitha format e tyre, duke analizuar specifikisht llojet e ndryshme të rrjeteve sociale, faqet e internetit, blogjet apo format bazike të komunikimit. Në këtë kuptim, ky libër manual shpjegon strategjitë e komunikimit që duhet të përdoren për të arritur efikasitet maksimal në rrjet. Libri, në pamje të parë, i dedikohet aktorëve, politikanëve, por dhe shoqërisë civile, duke analizuar mënyrën optimale të përdorimit të rrjetit, por, në anën tjetër, publiku më i gjerë, mund të kuptojë sesi funksionojnë rrjetet sociale. Përmes këtij libri, publiku mund të japë një vlerësim kritik mbi aktivitetin e politikanëve dhe të marrë pjesë me të vërtetë politikisht dhe në hapësirën virtuale.

“Gazetaria tradicionale përballë audiencave” Konferenca Shkencore e Departamentit të Gazetarisë dhe Komunikimit, e mbështetur nga AMA

“Gazetaria tradicionale përballë audiencave” është studimi shkencor, i financuar së fundmi, nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, në bashkëpunim me Departamentin e Gazetarisë dhe Komunikimit, gjetet e së cilit u prezantuan në Konferencën Shkencore, mbajtur në mjediset e Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë, më 15 tetor 2021. Ak. Prof. Dr. Artan Fuga dhe Përgjegjësi i Departamentit të Gazetarisë Prof. Assoc. Dr. Mark Marku, përgëzuan bashkëpunimin e frytshëm të dy institucioneve ndër vite, të cilat janë konkretizuar në 6 projekte të mëdha të kërkimit shkencor.

11. TRANSMETIMET NUMERIKE

11.1 Lirimi i brezit të Dividendit Digjital

Pas finalizimit me sukses të procesit të digjitalizimit të transmetimeve audiovizive, një tjetër proces, po kaq i rëndësishëm dhe në të njëjtën kohë edhe sfidues për rregullatorin, është procesi i lirit të brezit të Dividentit Digjital, i njohur si brezi DD2. Lirimi i brezit DD2 nga transmetimet audiovizive dhe dhënia në përdorim e këtij brezi për shërbimet e lëvizshme 5G, do të ndikojë në zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor të vendit, duke siguruar përmbushjen e kërkesës në rritje të përdoruesit për trafik dhe ofrimin e shërbimeve me shpejtësi të lartë interneti.

Lidhur me procesin e lirit të brezit DD2, me iniciativë të MIE, është përfituar asistencë teknike nga ITU në bashkëpunim me rregullatorin hungarez, për gjetjen e zgjidhjeve teknike efektive. Gjatë periudhës gusht 2020-prill 2021, AMA ka bashkëpunuar ngushtësisht me ekspertët si dhe grupin e punës me përfaqësues nga MIE dhe AKEP, duke marrë pjesë në takimet online me konsulentët, duke shkëmbyer me e-mail informacionet e nevojshme ligjore/teknike, si dhe për hartimin e një plani frekuencor numerik, pa përfshirë brezin DD2.

Konsulenca teknike u finalizua më 13 prill 2021, me organizimin e një seminari virtual mbi “Planifikimin e frekuencave për DVB-T2 në brezin e mbetur UHF”, ku u prezantuan zgjidhjet teknike të propozuara nga konsulentët.

Konsulentët kanë paraqitur disa versione të planit të ri numerik (pa përfshirë brezin DD2) ku janë parashikuar edhe kanale frekuencore për ndërtimin e rrjeteve lokale/rajonale, por në një numër shumë të kufizuar, pasi brezi audioviziv është reduktuar së tepërmi me lirin e brezit 700 MHz. Duke marrë në konsideratë numrin e rrjeteve kombëtare në vendin tonë (2 rrjete numerike publike dhe 5 rrjete numerike private) si dhe marrëveshjet e koordinimit të frekuencave me vendet fqinje, është e pamundur të ketë numër të konsiderueshëm të frekuencave për rrjete numerike lokale/rajonale.

Gjatë periudhës qershor- nëntor 2021, AMA ka vijuar procesin e koordinimit me operatorët kombëtarë numerikë (RTSH dhe operatorët privatë), me anë të komunikimeve me e-mail si dhe takimeve të ndryshme, në nivel teknik dhe të lartë drejtues, me qëllim arritjen e një dakordësie të unifikuar nga të gjithë palët e interesit, për përcaktimin e versionit përfundimtar të Planit Numerik Frekuencor.

Pas arritjes së dakordësisë nga të gjithë operatorët audiovizivë kombëtarë, AMA, më 26 nëntor 2021, miratoi Planin e ri Numerik Frekuencor (pa përfshirë brezin DD2).

11.2 Kompensimi financiar

AMA, gjatë vitit 2021, në zbatim të ligjit nr. 34/2017, “Për lirin e frekuencave të Digjital-Dividendit”, të ndryshuar, me vendimin nr. 69, datë 19.05.2021 miratoi disa ndryshimeve në vendimin nr. 38, datë 07.03.2019 “Për përcaktimin e subjekteve audiovizive analogë lokalë/rajonale që përfshihen në skemën e kompensimit financiar sipas ligjit nr. 34/2017, të ndryshuar”.

Me vendimin e sipërcituar u hoqën nga lista e subjekteve përfituesve, si më poshtë:

Nr.	Emri tregtar/ televizioni vendor	Berat	Korcë	Fier	Tiranë	Shkodër	Vlorë	Elbasan	Gjirokast	Dibër	Totali/ subjekt
1	“Tv Scan”			12.916	16.647			5.303			34.866
2	“Report TV”	7.316	10.987	15.717	20.257						54.277
3	“TV Lobi”		3.785								3.785
4	“TV Berati”	7.315									7.315
5	“TV UTV Education”		10.987		20.257			13.904			45.149
6	“CLUB TV”		10.987		20.257			8.838			40.082
7	“TV Apollon”			12.915			11.969				24.884
8	TV “A2”	-			20.257						20.257
9	“TV SOT 7”		10.987								10.987
10	“News 24 TV”			12.916	16.647		6.086				35.649
11	”Fax News”				15.451						15.451
12	“TV Ora News”			12.916	21.212		4.565				38.692
13	”TV Channel One”			12.916	23.717			1.768			38.401
14	"TV BBF"				16.647						16.647
15	"TV Shijak"				12.779						12.779
16	"Tv Syri"				20.257						20.257
17	TV "4+"			2.464							2.464
18	TV "Kopliku"					10.506					10.506
19	TV "BS"					10.506					10.506
20	Tv "Channel 7"								1.741		1.741
21	Tv "Channel 1"					10.506					10.506
22	Tv "ABC News"			12.916	16.647			7.070			36.633
23	TV "Euro Balkans News" (ish "TV IN")				12.876						12.876
24	TV "Premium Channel"				20.257		11.969				32.226
25	Tv "Alpo"								3.686		3.686
26	TV "Antena Nord"					6.161					6.161
27	TV "Star plus"					8.014					8.014
28	"ONE TV Vlora"						9.129				9.129

29	"TV Klaudiana"							13.904			13.904
30	"TV Mati"									2.153	2.153
	Totali euro/ allotment	14.631	47.735	95.675	274.16 5	45.693	43.719	50.787	5.427	2.153	579.984

- 7 (shtatë) subjekte për të cilat AMA kishte marrë vendime për heqje/konstatim pavlefshmërie të licencës dhe që nuk kanë investuar më tej organet gjyqësore.
- 4 (katër) subjekte, që nuk kanë depozituar asnjë dokumentacion për përfitimin e kompensimit financiar, pavarësisht njoftimeve të AMA-s.
- 1 (një) subjekt, që nuk paraqiti dokumentacion financiar vijues, pavarësisht njoftimeve të AMA-s.
- 2 (dy) subjekteve iu hoqën allotmentet për të cilat nuk paraqitën dokumentacion financiar.

Në vijim të vendimit nr. 69, datë 19.05.2021, përqindja takuese e fondit 1,000,000 euro (vënë në dispozicion AMA-s për këtë kategori subjektsh përfituese) u rrit nga 53.87% në 65.55% ose nga 6.46 muaj në 7.866 muaj.

Për sa më sipër, AMA ka vijuar me procesin e kompensimit financiar për ish-operatorët ekzistues analogë lokalë/rajonale, që janë mbështetur në rrjetin numerik të RTSH-së apo në rrjetet e tjera numerike të licencuara, për allotmentet Berat, Korçë, Fier; Tiranë (qarqet Tiranë-Durrës), Shkodër, Vlorë, Elbasan, Gjirokastrë dhe Dibër, që kanë plotësuar kërkesat e parashikuara ligjore.

Ecuria e kompensimit financiar (në fondin prej 1,000,000 euro), për periudhën korrik 2019 - 31 dhjetor 2021, është realizuar në masën totale 579,984 euro, si më poshtë:

11.3 Kontrata AMA – RTSH

Gjatë vitit 2021, AMA ka realizuar dy shqyrtime mbi performancën e RTSH-së (çdo 6 muaj), duke përcjellë, për këtë institucion, një informacion mbi dy aspekte kryesore: buketa programore dhe mbulimi me sinjal transmetimi në të gjithë territorin e vendit.

Ky informacion bazohet në kërkesat e ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht, nenet 18 dhe 19, ku pasqyrohen objektivat dhe funksionet e AMA-s; neni 33, mbi detyrimet e OSHMA-ve; kreu 12, që rregullon veprimtarinë e RTSH-së, ku përfshihen nenet 90–126 etj.; si dhe i referohet përmbajtjes së Kontratës së Shërbimit të Transmetimit Publik, miratuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, me vendimin nr. 18, datë 02.03.2017. Duke e dërguar çdo gjashtë muaj këtë vlerësim të performancës së RTSH-së, për buketën programore dhe nivelin e mbulimit me sinjal transmetimi në territorin e vendit, AMA e ka vlerësuar dhe e vlerëson këtë angazhim si bashkëpunim dhe mbështetje për Transmetuesin Publik, rolin dhe misionin e tij për informimin, edukimin dhe argëtimin e ndjekësve, si pjesë e përgjegjësisë dhe detyrimit që ata të marrin produktin dhe shërbimin audioviziv me cilësi dhe shumëllojshmëri.

Në vlerësimin e buketës programore AMA ka dërguar në RTSH disa vlerësime që ka evidentuar nga shqyrtimi i fundit.

- AMA vlerëson shumë pozitivisht faktin e reflektimit nga kanali RTSH AGRO të vërejtjes, që është adresuar në dy informacionet periodike të fundit, për transmetimin e një pjese të dokumentarëve pa përkthim në shqip (me titra ose me zë). Kemi evidentuar se tashmë ky problem është tejkaluar, duke ndikuar pozitivisht te ndjekësit e përmbajtjeve audiovizive të këtij kanali në platformën e RTSH-së.
- Te kanali tematik RTSH FËMIJË mendojmë se ka ende nevojë për përmirësim të strukturës programore, duke marrë në konsideratë dhe vlerësimet që ka bërë në këtë drejtim “Këshilli për shikuesit dhe dëgjuesit”, për ofrim të programeve kreative, argëtuese e ndërvepruese.
- Për RTSH KUVENDI, si një hapësirë ku ndjekësit kanë akses të shikojnë të plota transmetimet e seancave parlamentare ose punimet e komisioneve të përhershme, AMA përsërit sugjerimin se duhet të përfshihen dhe përmbajtje informuese dhe shpjeguese të realizuara përmes bisedave, intervistave, apo analizave profesionale me ekspertë të fushës, mbi projektligje që janë në proces diskutimi dhe që janë me rëndësi për qytetarin dhe komunitetin. Kjo qasje do të ketë më shumë ndikim në nxitjen dhe gjallërimin e konsultimit publik për aktet ligjore, para se ato të diskutohen dhe votohen në seancë plenare nga deputetët. Kujtojmë dhe një rekomandim të Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, (mbledhja e datës 26.06.2020), që RTSH KUVENDI “të ketë më shumë hapësirë, duke qenë më shumë aktiv dhe t’u vijë në ndihmë deputetëve dhe Kuvendit, ku të pasqyrojë jo vetëm seancat por dhe dokumentarë, intervista, reportazhe, duke sjellë këtu dhe një paralelizëm me vendet fqinjë”.
- RTSH duhet të sigurojë, në mënyrë të pandërprerë, transmetimin me gjuhën e shenjave, në dy kanale gjeneraliste të buketës programore, të paktën të një edicioni informativ brenda 24 orëve, në zbatim të kërkesës së Kontratës së Shërbimit, neni 7.
- Në buketën programore të RTSH-së duhet të vijojnë përpjekjet për të përmbushur plotësisht kërkesat e ligjit nr. 76/2014, për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9636, datë 6.11.2006, “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar. Në nenin 1 të këtij ligji thuhet se RTSH “transmeton çdo muaj programe edukative për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit, në përputhje me ligjin për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë. Këto programe edukative kanë një kohëzgjatje në total prej 90 minutash dhe transmetohen nga ora 08.00 deri në orën 22.00. Një prej këtyre programeve, me kohëzgjatje prej 30 minutash, transmetohet detyrimisht nga ora 17.00 deri në orën 22.00”.
- RTSH MUZIKË aktualisht transmeton evente artistike për të gjitha grupmoshat dhe në zhanre të ndryshme muzikore. Ky kanal tematik do të ishte edhe më tërheqës nëse do të pasurohej me rubrika, të cilat sipas përshkrimeve në nenin 6 të Kontratës, “i shërbejnë traditave kombëtare, zhvillimit të tyre, ruajtjes dhe përhapjes dhe transmetimit të vlerave artistike, të folklorit etj.”.

Sa i takon respektimit të Kontratës së Shërbimit, lidhur me mbulimin me sinjal numerik të operatorit publik, lutem referojuni pikës 9.4, të këtij raporti.

11.4 Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave

Planifikimi dhe administrimi i spektrit të frekuencave audio/audiovizive realizohet në zbatim të dispozitave të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore e rregullatore kombëtare dhe ndërkombëtare.

Menaxhimi në mënyrë sa më efektive i shfrytëzimit të spektrit audio/audioviziv krijon mundësi për licencimin e operatorëve të rinj në treg, siguron shmangien e interferencave të dëmshme brenda dhe jashtë vendit, si dhe garanton cilësi të lartë shërbimi te përdoruesit fundorë.

11.4.1 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audiovizive

Bazuar në aktet ligjore e nënligjore kombëtare dhe ndërkombëtare, brezi frekuencor, i përcaktuar për transmetime tokësore numerike DTT, është brezi UHF dhe VHF. Bazuar në Planin Kombëtar Numerik (PKN), banda UHF, aktualisht, është në përdorim nga operatorët audiovizivë, që mundësojnë transmetimet numerike në të gjithë territorin e vendit.

Operatori publik shqiptar RTSH disponon frekuenca për dy rrjete numerike si dhe 5 operatorët privatë kombëtarë numerikë kanë në dispozicion frekuenca për 1 rrjet numerik secili prej tyre. Ndërkohë është licencuar edhe një rrjet lokal, i cili mbulon me shërbim allotmentin Elbasan. Gjithashtu, në PKN parashikohen edhe disa frekuenca të lira për licencimin e operatorëve lokalë/rajonalë. Plani Frekuencor Numerik, paraqitet si më poshtë:

Plani Frekuencor Numerik për 2 rrjetet kombëtare publike të RTSH-së (i miratuar nga AMA me V. nr. 27, datë 01.02.2013)

Rrjetet Shqipëria	AL-001D	AL-002D	AL-003D	AL-004D	AL-005D	AL-006D	AL-007D	AL-008D	AL-009D	AL-010D	AL-011D
	Shkodër	Kukës	Dibër	Lezhë	Tiranë	Elbasan	Fier	Berat	Korçë	Gjirokastrë	Vlorë
RTSH (MUX-1)	28	26	38	43	34	23	27	25	43	26	23
RTSH (MUX-2)	41	32	24	23	21	33	31	30	45	37	39

Plani Frekuencor Numerik për 5 rrjetet kombëtare private në brezin UHF në RSH

Rrjetet Kombëtare Private	AL-001D	AL-002D	AL-003D	AL-004D	AL-005D	AL-006D	AL-007D	AL-008D	AL-009D	AL-010D	AL-011D
	Shkodër	Kukës	Dibër	Lezhë	Tiranë	Elbasan	Fier	Berat	Korçë	Gjirokastrë	Vlorë
KLAN (MUX-3)	34	50	55	33	41	42	35	32	51	44	46
DIGITALB (MUX-4)	59	40	30	46	53	48	28	36	55	29	57
TOP CHANNEL (MUX-5)	45	42	25	29	59	49	22	54	57	50	43
MEDIA VIZION (MUX-6)	22	36	54	-----	57	46	29	24	21	48	53
ADTN (MUX-7)	51	52	60	-----	39	40	45	47	27	35	51

Shoqëria “Era Digital” sh.p.k., me vendim të AMA-s nr. 186, datë 19.12.2019, është pajisur me licencë lokale transmetimi audioviziv numerik për qarkun Elbasan. Në përdorim i është përcaktuar kanali frekuencor Ch37.

Kanalet frekuencore të lira në brezin VHF dhe UHF

	AL-001D	AL-002D	AL-003D	AL-004D	AL-005D	AL-006D	AL-007D	AL-008D	AL-009D	AL-010D	AL-011D	AL-012D Sub.
	Shkodër	Kukës	Dibër	Lezhë	Tiranë	Elbasan	Fier	Berat	Korçë	Gjirokastrë	Vlorë	Tiranë
Kanalet e lira në VHF	9	9	8	9	10	7	10	5	6	8	8	6
		56				56		52	28	38		26
						58			59	56		44
Kanalet e lira në UHF										58		50
										60		60

Referuar tabelës më sipër, janë 6 blloqe frekuencore të lira në brezin III VHF për shërbimin audioviziv tokësor digjital (DTT) të cilët mundësojnë një rrjet numerik kombëtar. Ndërkohë për shërbimin audio tokësor digjital (T-DAB) janë 6 kanale të lira, konkretisht Ch11A, Ch11B, Ch11D, Ch12A, Ch12B dhe Ch12C, të cilët mundësojnë dy rrjete numerike kombëtare.

Sa i takon brezit UHF, numri i kanaleve të lira reduktohet, duke pasur parasysh lirimin e brezit 694-790 MHz i njohur si brezi DD2. Konkretisht, mbeten: 1 frekuencë në qarkun e Korçës (Ch28), 1 frekuencë në qarkun e Gjirokastrës (Ch38) dhe 2 frekuencë në suballotmentin e Tiranës (Ch 26 dhe Ch44). Bazuar në Planin Frekuencor Numerik, rezulton se rreth 30.9 % e kanaleve të frekuencave, të përcaktuara nga AMA, për 5 rrjetet UHF private kombëtare, i përkasin brezit DD2.

Ndërkohë, në kuadër të procesit të lirimit të brezit 700 MHz (DD2), me vendim të AMA-s, nr. 96, datë 26.11.2021, është miratuar Plani i ri Numerik Frekuencor për transmetimet numerike tokësore (ku nuk përfshihet brezi DD2), i cili parashikon 7 rrjete numerike kombëtare si dhe disa rrjete lokale/rajonale si më poshtë:

Rrjetet	AL001D	AL002D	AL003D	AL004D	AL005D	AL006D	AL007D	AL008D	AL009D	AL010D	AL011D	Numri i kanaleve në total
MUX 1 (RTSH)	33	33	42	33	33	42	31	36	27	37	31	6
MUX 2 (RTSH)	34	34	40	34	34	40	39	41	28	38	39	6
MUX 3 (Klan)	28	28	30	28	28	30	29	30	45	29	23	5
MUX 4 (Digitalb)	21	36	38	21	21	48	21	48	48	48	28	5
MUX 5 (Top Channel)	22	22	24	22	22	24	27	47	24	26	27	5
MUX 6 (Media Vizion)	45	45	32	45	45	46	43	43	43	44	43	5
MUX 7 (ADTN)	23	23	25	23	23	25	35	32	21	35	35	5
Lokale	29	26	27	29	-	37	-	34	-	42	-	

11.4.2 Koordinimi i frekuencave të brezit audioviziv

Gjatë vitit 2021, AMA ka vijuar procesin e koordinimit me vendet nënshkruese të Marrëveshjes GE06 mbi riorganizimin e frekuencave të planeve frekuencore përkatëse, për evidentimin e hapësirave të optimizimit dhe shtimit të kapaciteteve transmetuese.

Bazuar në kërkesat e ardhura për koordinim nga vendet fqinjë, AMA ka kryer studimet teknike dhe ka verifikuar përputhshmërinë e propozimeve të paraqitura nga vendet e rajonit me përcaktimet në Planin GE06.

Administratat e Kroacisë, Malit të Zi dhe Italisë kanë kërkuar miratimin e AMA-s lidhur me caktime frekuencore në brezin UHF, sipas të cilave Shqipëria është konsideruar e prekur nga ndryshimet e këtij Plani.

Gjithashtu, gjatë këtij viti, janë kryer dhe procedurat e koordinimit në përputhje me:

- Aktet finale të Konferencës Rajonale GE-75 “Për transmetimet audio në brezat frekuencorë LF/MF (Rajoni 1 dhe 3)”, në zbatim të notifikimeve të ardhura nga administrata e Italisë.
- Aktet finale të Konferencës Rajonale GE-84 “Për planifikimin e transmetimeve audio në bandën VHF (Rajoni 1 dhe disa pjesë të Rajonit 3)”, bazuar në notifikimet e ardhura nga administratat e Malit të Zi, Bosnje-Hercegovinës dhe Bullgarisë.

Në kuadër të procesit të koordinimit të brezit III VHF për transmetimet audio/audiovizive digjitale (në teknologjinë DVB-T2 dhe T-DAB) me vendet që lagen nga ujërat e deteve Adriatik dhe Jon (Itali, Kroaci, Slloveni, Mal i Zi, Bosnje-Hercegovinë, Greqi dhe Shqipëri), iniciuar nga administrata e Italisë, edhe gjatë vitit 2021 janë organizuar disa takime, me qëllim rialokimin dhe përdorimin e këtij brezi në mënyrë efikase, proporcionale dhe pa interferenca të dëmshme.

Ky proces, i nisur në tetor 2019, ka vijuar me takimet e radhës në datat 17-19 shkurt 2020 (organizuar në Romë), ndërkohë që takimet e fundit, për shkak të pandemisë COVID-19, janë kryer online (në 2-3 korrik 2020, 10 nëntor 2020 dhe 7 dhjetor 2020, 22 shkurt 2021, 19 prill 2021, 14 maj 2021 dhe 17 dhjetor 2021).

Pas shumë diskutimesh dhe propozimesh midis administratave pjesëmarrëse, është dakordësuar, në parim, draft plani i ri frekuencor i rialokimit të brezit të III VHF, procedurë e cila është ende në koordinim me vendet që lagen nga ujërat e deteve Adriatik dhe Jon, si dhe vendet kufitare të secilës administratë të këtij grupi.

Bazuar në Planin GE-06, Shqipëria mund të ndërtojë një rrjet kombëtar që mundëson transmetime audiovizive tokësore digjitale (DTT) dhe dy rrjete kombëtare që mundësojnë transmetime audio tokësore digjitale (T-DAB). Ndërkohë draft plani i ri frekuencor i rialokimit të brezit të III VHF nga grupi Adriatik dhe Jon, në krahasim me Planin GE-06, mundëson, për administratën shqiptare, përveç sa më sipër, rrjetin e tretë kombëtar për transmetime audio digjitale T-DAB.

Referuar procedurës së koordinimit me vendet fqinje, që nuk janë pjesë e grupit Adriatik dhe Jon, Shqipëria ka koordinuar me administratat e Serbisë, Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës, për të marrë dhe dakordësinë e tyre.

Në këtë kuadër, Shqipëria ka marrë dakordësinë nga administrata serbe, për ndryshimet e propozuara të Planit GE06, për përdorimin e kanaleve frekuencore në shërbimet DTT dhe T-DAB. Ndërkohë nga pala maqedonase ka marrë dakordësi për kanalet frekuencore të shërbimit T-DAB. Procesi i koordinimit, me palën maqedonase, vijon. AMA, ka shprehur gatishmërinë e saj për analiza më të detajuara teknike, duke shkëmbyer të dhënat teknike me palën maqedonase, me qëllim finalizimin e procedurës së koordinimit të kanaleve frekuencore edhe në shërbimin DTT.

Procedura e koordinimit të brezit III VHF do të vijojë edhe gjatë vitit 2022, me qëllim dakordësimin e përdorimeve të kanaleve frekuencore nga secila administratë palë e diskutimeve, si dhe finalizimin e propozimeve me firmosjen e një marrëveshjeje shumëpalëshe midis vendeve pjesëmarrëse.

Në vijim të miratimit të Planit Numerik Frekuencor (pa përfshirë brezin 700 MHz), AMA ka iniciuar procedurën e koordinimit të brezit UHF me vendet fqinje, duke dërguar me shkresë zyrtare kërkesën për koordinim ndërkufitar, me qëllim marrjen e dakordësisë nga administratat përkatëse, për ndryshimet e propozuara të Planit GE-06.

Në këtë kuadër, AMA, gjatë muajit tetor 2021, ka marrë pjesë në takime bilaterale me Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut, për t'i informuar mbi ndryshimet e ndodhura në Planin e ri Numerik Frekuencor të Shqipërisë, si dhe për t'i kërkuar angazhimin e tyre maksimal në përshejtimin e procedurave të koordinimit, duke qenë se jemi në limite të afatit të përcaktuar për lirimin e brezit 700 MHz (30 qershor 2022) në dokumentin e politikës spektrale.

Gjatë muajit shkurt dhe mars 2022, AMA është angazhuar në disa takime bilaterale me vendet e rajonit si Mal i Zi, Maqedoni e Veriut, Greqi, Kroaci, Itali për të arritur dakordësinë e tyre mbi Planin Frekuencor Shqiptar. Aktualisht, AMA ka marrë dakordësinë e administratave të Malit të Zi, Bosnje Hercegovinës, Maqedonisë së Veriut, Greqisë dhe Italisë. Jemi duke koordinuar me Serbinë dhe Kroacinë, për të finalizuar në këtë mënyrë procesin e koordinimit me të gjithë vendet e rajonit.

Finalizimi i procesit të koordinimit do t'i hapë rrugë lirimit të brezit 700MHz nga transmetimet audiovizive dhe dhënien në përdorim të këtij brezi për shërbimet me brez të gjerë (5G), regjistrimin e kanaleve frekuencore në ITU, implementimin e ndryshimeve përkatëse në rrjetet numerike kombëtare, si dhe nënshkrimin, nga pala shqiptare, e marrëveshjeve shumëpalëshe për përdorimin e brezit UHF, si SEDDIF dhe Adriatik e Jon.

11.4.3 Planifikimi i frekuencave për shërbimet audio

Për planifikimin dhe administrimin e spektrit audio FM 87.5-108 MHz, AMA, në vijimësi, ka vlerësuar periodikisht kapacitetet e lira të frekuencave audio, si dhe ka përditësuar Planin e Përdorimit të Frekuencave për këto shërbime. Disponueshmëria e frekuencave të lira, të brezit audio FM, mbetet një tjetër sfidë për rregullatorin, duke qenë se në qarqet ku ka më shumë kërkesë për këtë shërbim si Tiranë, Durrës, Fier dhe Vlorë, identifikohen mungesa në burime të fundme, ndërkohë disponohen resurse të nevojshme për qarqet e tjera të vendit.

AMA, gjatë vitit 2021, ka kryer studimet teknike me qëllim licencimin e subjekteve të interesuara për të ofruar transmetime audio në qarqe të ndryshme të vendit.

Gjatë këtij viti janë licencuar dy subjekte radio për ofrimin e shërbimit audio analoge në Bashkitë Shkodër dhe Vau i Dejës, si dhe në qarqet Tiranë dhe Durrës, konkretisht:

- Vendimi nr. 3, datë 18.01.2021, për “Dhënien e licencës për transmetime audio analoge, shoqërisë “I.B.C- TELECOM” sh.p.k., për subjektin audio “Radio I.B.C” për të mbuluar me sinjal audio “Bashkitë Shkodër dhe Vau i Dejës”.
- Vendimi nr. 21, datë 16.02.2021, për “Dhënien e licencës së transmetimit audio analoge rajonale, shoqërisë “ABEG” sh.p.k., për subjektin audio “Radio ST”, për të mbuluar me sinjal audio “Qarqet Tiranë dhe Durrës”.

Gjithashtu, janë kryer studimet teknike për çeljen e garave për dhënien e licencave të transmetimit audio analoge në nivel lokal/rajonale.

Në funksion të detyrave të saj, AMA ka kryer, gjithashtu, studime mbi kërkesat e paraqitura nga subjektet audio për ndryshim të karakteristikave teknike të transmetimit. Studimet konsistojnë në kryerjen e llogaritjeve teknike mbi mbulimin e zonës së shërbimit me sinjal dhe shmangien e interferencave të ndryshme brenda dhe jashtë vendit. Në kuadër të përmirësimit të mbulimit me sinjal të zonës së shërbimit, AMA ka kryer dy vendimmarrje, konkretisht:

- me Vendimin nr. 77, datë 28.06.2021, ka miratuar “Dhënien e të drejtës së përdorimit të frekuencave 103.9 MHz dhe 101.7 MHz, Radiotelevizionit Shqiptar për pikat e transmetimit Shashicë (për Radio Tirana 1) dhe Pepellash (për Radio Korça), si dhe

- me vendimin nr. 80, datë 27.07.2021, ka miratuar “Pranimin e kërkesës së shoqatës “Radio Maria” licencuar për radion komunitare “Radio Maria”, për ndryshimin e kushteve teknike të licencës”, me qëllim përmirësimin e mbulimit me sinjal cilësor të zonës së shërbimit.

Ndërkohë, me Vendimin nr. 10, datë 02.02.2021, AMA ka miratuar zgjerimin e zonës së licencimit të shoqërisë “Media New Vizion” licencuar për subjektin “Radio 1”, për të mbuluar me sinjal audio “Bashkitë Elbasan, Cërrik dhe Belsh”.

11.5 Adresimi i interferencave të shkaktuara nga operatorët audio/audiovizive

Në kuadër të përmirësimit në identifikimin e interferencave, që vijnë nga vendet fqinje dhe atyre të shkaktuara nga pikat transmetuese në territorin e Shqipërisë, si dhe marrjen e masave për shmangien e tyre, edhe gjatë vitit 2021, AMA ka pasur në fokus të veçantë monitorimin e spektrit audio FM, në të gjithë territorin e vendit. Monitorimi synon identifikimin dhe zgjidhjen, në kohë të shpejtë, të interferencave që shkatohen nga sinjalet e emetuara nga transmetuesit e vendeve fqinje.

Në këtë kuadër, AMA administron sistemin e qendëruar të monitorimit të spektrit audio FM, në 12 stacione transmetimi. Ky sistem, monitoron on-line spektrin audio FM, përkatësisht në qytetet Kukës, Shkodër, Lezhë, Durrës, Fier, Vlorë, Berat, Gjirokastrë, Korçë, Pogradec, Librazhd dhe Sarandë. Krahas identifikimit të menjëhershëm të interferencave, sistemi bën të mundur:

- a) Identifikimin e menjëhershëm të rasteve kur operatorët në treg ndryshojnë frekuencat;
- b) Identifikimin e menjëhershëm të përdorimit në mënyrë ilegale të spektrit audio;
- c) Kontrollin e gjendjes reale të transmetimit të subjekteve audio të licencuar (janë në transmetim apo jo);
- d) Kontrollin e parametrave teknikë të transmetimit të subjekteve audio. Në qytetet e tjera, monitorimi i spektrit audio është kryer në mënyrë periodike nëpërmjet Qendrës së Lëvizshme të Monitorimit të Frekuencave (QLMF).

Interferencat e shkaktuara brenda vendit

Gjatë vitit 2021, AMA nuk ka administruar asnjë ankesë lidhur me interferencat e shkaktuara brenda vendit

Interferencat e shkaktuara në vendet fqinje

Për sa u përket interferencave të shkaktuara në vendet fqinje, gjatë vitit 2021, AMA ka administruar disa ankesa, të ardhura nga vendet fqinje, lidhur me problematikën si më poshtë:

1. Gjatë vitit 2020, AMA ka administruar ankesën e administratës së Malit të Zi, mbi shkaktimin e interferencës të dëmshme drejt subjektit “Radio Elita” nga subjekti ynë “Radio One”. Kjo problematikë është mbartur edhe gjatë vitit 2021, ku AMA, me vendim nr.17, datë 05.02.2021, miratoi pranimin e kërkesës së subjektit “Dynamicsound” sh.p.k., për ndryshimin e kushteve teknike

(ndryshimin e frekuencës në pikën e transmetimit Fushë Dajt nga 94 MHz në frekuencën 95.2 MHz), si dhe saktësimin e zonës së licencimit të subjektit në “Qarqet Tiranë, Durrës, Fier dhe Vlorë”, duke i dhënë zgjidhje në këtë mënyrë kësaj problematike. Përdorimi i frekuencës 95.2 MHz nga subjekti “Radio One” në pikën e transmetimit Fushë Dajt është koordinuar dhe ka marrë miratimin nga pala malazeze.

2. Ndërkohë, gjatë periudhës shtator/tetor 2021, AMA, ka administruar ankesën e rregullatorit maqedonas (AEC- Agjencia për Komunikimet Elektronike), ardhur në formë elektronike, me anë të së cilës ka shprehur shqetësimin për identifikimin e interferencave të dëmshme në territorin e Strugës, në frekuencën 90.4 MHz, në pikën e transmetimit Vishni të subjektit audio FM “Radio Play”, nga subjekti Radio Klan. Kjo problematikë është zgjidhur në një afat shumë të shkurtër kohor, duke marrë masat e nevojshme për eliminimin e interferencës së dëmshme.
3. Një tjetër ankesë, mbi shkaktimin e interferencave të dëmshme, është ankesa e ardhur po nga administrata e Maqedonisë së Veriut mbi interferencën e shkaktuar në brezin aeronautik (108-137 MHz) nga operatori ynë “Radio Logos”. Në lidhje me këtë problematikë, u kryen konstatimet e nevojshme, si dhe marrja e masave për rregullimin e parametrave teknikë të transmetimit dhe vendosjen e tyre brenda normave të lejuara, duke eliminuar interferencën e dëmshme shkaktuar nga ky subjekt.

Referuar interferencave në transmetimet audiovizive drejt vendit tonë apo vendeve fqinje, gjatë vitit 2021, AMA ka administruar ankesën e rregullatorit kroat, HAKOM, mbi interferencat e shkaktuara në rajonin e Dubrovnikut nga operatori audioviziv publik (RTSH) në kanalin Ch 21.

Rregullatori kroat ka informuar se kanalet Ch 21 dhe Ch 34, janë vendosur në punë në rajonin e Dubrovnikut në vitin 2020, kur Kroacia filloi procesin e migrimit të transmetimeve audiovizive nga teknologjia DVB-T në DVB-T2, me qëllim lirim të brezit 700 MHz dhe përdorimin e tij për shërbimin 5G.

Gjatë muajit prill 2021, Drejtoria e Planifikimit të Frekuencave dhe TIK (DPFTIK), ka komunikuar me email me përfaqësues të rregullatorit kroat, në lidhje me ndërhyrjet e shkaktuara nga operatorët tanë audiovizivë kombëtarë, në kanalet Ch 21, Ch 34, Ch 39, Ch 41 dhe Ch 53, në rajonin e Dubrovnikut. Në këto komunikime është bërë me dije se kanalet frekuencore Ch 21 (për allotment AL005D) dhe Ch 34 (për allotment AL001D dhe AL005D), janë në përdorim nga operatori ynë publik prej më shumë se 4 vitesh në pikën e transmetimit Fushë Dajt. Ndërkohë kanalet Ch 39, Ch 41 dhe Ch 53 janë në përdorim nga operatorët tanë privatë kombëtarë, në përputhje të plotë me përcaktimet e Planin GE06.

Gjithashtu, ndër të tjera rregullatorit kroat i është bërë me dije se zëvendësimi i kanalit Ch21 me një kanal tjetër frekuencor në këtë moment është i pamundur. Këtë mundësi mund ta marrim në konsideratë vetëm në procesin e riplanifikimit, megjithëse është shumë e vështirë, duke pasur parasysh numrin e lartë të rrjeteve kombëtare në vendin tonë (7 rrjete gjithsej), si dhe marrëveshjet e koordinimit të nënshkruara nga vendet fqinje.

Për sa më sipër, AMA, i ka propozuar administratës kroate të marrë në konsideratë situatën në të cilën ndodhemi, si dhe ka shprehur gatishmërinë për koordinim të mëtejshëm me ekspertët kroatë, për të gjetur sa më shpejt një zgjidhje teknike për të shmangur ndërhyrjet e dëmshme.

12. AUTORITETI NË PËRMBUSHJE TË TRANSPARENCËS DHE RITJES SË IMAZHIT INSTITUCIONAL

12.1 Organizimi i brendshëm i institucionit

Edhe gjatë këtij viti pandemie, Autoriteti vijoi funksionimin, në përputhje me kushtet e reja të krijuara për shkak të pandemisë në vitin 2020, duke zbatuar protokollet e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Instituti i Shëndetit Publik, si dhe aktet e brendshme të miratuara nga AMA. Autoriteti i Mediave Audiovizive, ka ushtruar aktivitetin e tij bazuar në detyrat funksionale, duke vijuar veprimtarinë e vet për përmbushjen e objektivave dhe kërkesave për mbikëqyrjen e veprimtarisë audiovizive.

Në përmbushje të një prej objektivave të Planit Strategjik të Veprimit 2021-2023, në kuadër të komunikimit dhe zhvillimit sektorial, për të arritur një qasje më frytdhënëse me publikun, OSHMA-të dhe aktorët e tjerë, në vitin 2021 është miratuar Strategjia e Komunikimit për vitet 2021-2022. Kjo strategji, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, është më specifike, duke sjellë disa ndryshime në mënyrën e organizimit dhe planin e komunikimit të institucionit. Qëllimi i kësaj strategjie është informimi dhe promovimi, me grupet e interesit dhe publikun e gjerë, i objektivave, nismave; impakti dhe arritjet në fushën e medias audio dhe audiovizive.

Nëpërmjet kësaj strategjie AMA ka krijuar një plan komunikimi, për periudhën maj 2021 deri në dhjetor 2022, në përmbajtje të të cilit përfshihet lloji dhe tipologjia e aktiviteteve, periudha, mesazhi, grupet e interesit, kanalet e komunikimit që do të përdoren, buxhetet, burimet njerëzore dhe detyrat për t'u realizuar.

Autoriteti i Mediave Audiovizive, si institucion i përfshirë në programin e praktikave kombëtare të punës, edhe gjatë vitit 2021, është bërë pjesë e Thirrjes VI të Programit Kombëtar të Praktikave të Punës. Bazuar në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi, AMA përfshiu në aktivitetin e saj praktikën mësimore të disa studentëve, të cilët përfunduan me sukses praktikën pranë njësive organizative të Autoritetit duke përfutur një përvojë kualifikuese për zhvillimin e mëtejshëm të aftësive vetjake profesionale dhe komunikuese.

Në vijim të detyrimeve, që rrjedhin prej legjislacionit të ILDKPKI, me vendimin nr. 43 datë 18.03.2021, AMA miratoi rregulloren “Për parandalimin e konfliktit të interesave dhe për deklarimin e pasurive në ushtrimin e funksioneve publike nga administrata e Autoritetit të Mediave Audiovizive”. Ky akt është përcjellë pranë ILDKPKI dhe ka si qëllim garantimin e një vendimmarrjeje të paanshme, transparente, në interesin më të mirë të mundshëm të publikut e të besimit të tij, nga zyrtarët e Autoritetit të Mediave Audiovizive, nëpërmjet parandalimit të konfliktit ndërmjet interesave publikë dhe atyre privatë, në ushtrimin e funksioneve në Autoritetin e Mediave Audiovizive.

Gjatë vitit 2021 mbledhjet e anëtarëve të AMA-s kanë vijuar normalisht dhe, në raste të veçanta, janë zhvilluar nëpërmjet platformave online. Gjithsej, gjatë këtij viti raportues, janë zhvilluar 25 mbledhje. Prej muajit mars 2021, pas dorëheqjes së njërit prej anëtarëve të AMA-s, mbledhjet e Autoritetit gjatë vitit 2021 janë zhvilluar me 4 (katër) anëtarë.

12.2 Programi i transparencës

Autoriteti i Mediave Audiovizive, si një institucion i pavarur publik, krahas veprimtarisë së tij, të përcaktuar në ligjin nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, sigurohet që të jetë transparent ndaj publikut, duke zbatuar dispozitat që rrjedhin nga ligji nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në zbatim të Urdhrit nr. 187, datë 18.12.2020, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale “Për miratimin e Programit të Transparencës të rishikuar”, Autoriteti, në datën 29 mars 2021, miratoi programin e ri të transparencës, i cili është publikuar në faqen zyrtare të institucionit, sipas udhëzimeve nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit.

Programi i transparencës, i rishikuar, është i ndarë në disa nënkategori për publikimin e informacionit nga autoriteti publik, ku ndër më kryesoret janë:

- Rreth Autoritetit,
- Kuadri ligjor rregullator,
- E drejta për t’u informuar dhe për t’u ankuar,
- Mekanizmat kontrollues dhe monitorues që veprojnë mbi AMA-n,
- Informacion mbi buxhetin dhe të dhënat financiare të AMA-s,
- Informacion për procedurat e prokurimit/procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat,
- Shërbimet që ofrohen nga AMA,
- Procedurat/mekanizmat për të dhënë mendime lidhur me procesin e hartimit të akteve ligjore/nënligjore, politikave publike apo në lidhje me ushtrimin e funksioneve të AMA
- Sistemi i mbajtjes së dokumentacionit, llojet dhe format e dokumenteve,
- Regjistri i kërkesave dhe përgjigjeve,
- Ndihma shoqërore/subvencione të dhëna nga AMA,
- Informacione/dokumente, që kërkohen më shpesh dhe ato që gjykohen të dobishme për publikim nga AMA.

Gjatë vitit 2021, pranë Autoritetit të Mediave Audiovizive, kanë mbërritur rreth 103 kërkesa për informacion, të cilat kanë marrë përgjigje brenda afatit të parashikuar në ligj (10 ditë pune), duke shënuar kështu një rekord pozitiv për Autoritetin.

Çdo tre muaj, AMA përditëson dhe publikon “Regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve”, i cili përmban kërkesat për informacion, që kanë mbërritur në institucion dhe përgjigjet që AMA u ka kthyer kërkuarësve.

12.3 Aktivitete të Autoritetit

Pavarësisht situatës pandemike, AMA ka zhvilluar një sërë aktiviteteve dhe takimesh me homologë/ grupe interesi apo bashkëpunëtorë.

- **Konferencë ndërkombëtare “Mbrojtja e fëmijëve në mediat audiovizive”**

Më 13 tetor 2021, në Tiranë, u mbajt Konferenca Ndërkombëtare me temë “Mbrotjtja e fëmijëve në mediat audiovizive”, organizuar nga Autoriteti i Mediave Audiovizive.

Kryetarja e Autoritetit, Armela Krasniqi, në fjalën e saj, garantoi se AMA do të vijojë monitorimin e rregullt dhe të rreptë për zbatimin e dispozitave që rrjedhin nga “Kodi i Transmetimit” dhe forcimin e penaliteteve për OSHMA-të që shkelin dispozitat e këtij kodi për mbrojtjen e fëmijëve dhe bëri të ditur se, në bazë të strategjisë së AMA-s për vitin 2021-2023, do të rishikohet Kodi i Transmetimit.

Përfaqësuesja e OSBE-së për Lirinë e Medias, Teresa Ribeiro deklaroi se “e drejta për të shprehur lirshëm opinionet, sidomos ato të fëmijëve thekson edhe njëherë rëndësinë se sa e rëndësishme është të mbrojmë të drejtat e njeriut. Duke përgëzuar AMA-n për organizimin e konferencës Ribeiro tha se “sapo kam përfunduar konferencën mediatike për Evropën Juglindore, e cila u mirëprit këtë vit në Tiranë. Kjo konferencë për gazetarinë, në këtë kohë krizash, shërben për të shpjeguar se sa e rëndësishme është gazetaria për publikun dhe, si një shtyllë kryesore e shoqërisë sonë demokratike, në këtë konferencë u dhanë mundësi shumë të rëndësishme për të folur për lirinë e medias dhe lirinë e shprehjes në rajon”.

Konferenca Ndërkombëtare “Mbrotjtja e fëmijëve në mediat audiovizive ishte konceptuar dhe organizuar në tre panele diskutimi, në të cilat referuan ekspertë nga Britania e Madhe, Belgjika, Gjermania, si dhe profesorë e ekspertë të fushës nga vendi dhe rajoni.

Paneli i parë diskutoi mbi “Procesin rregullues dhe mbrojtjen e fëmijëve”.

Drejtori i Përgjithshëm i PA Media Group në Mbretërinë e Bashkuar, Clive Marshall, Drejtori Ekzekutiv i KSF në Gjermani, Stefan Linz dhe themeluesi dhe drejtori i Wagner-Hatfield (Belgium) Jean-François Furnémont, ndanë eksperiencat e vendeve të tyre në këtë drejtim. Diskutimi u pasurua nga znj. Elma Tershana e cila prezantoi studimet e gjetjet e observatorit për mbrojtjen e fëmijëve.

Paneli i dytë iu kushtua nevojës së madhe që ka marrë, në ditët e sotme, “Edukimi mediatik”.

Panelistët Remzi Lani, nga Instituti Shqiptar i Medias, profesorët Iris Luarasi dhe Elvin Luku, eksperti Emiljano Kaziaj, ekspert i Këshillit Supresim RTUK Yusuf Demirtas e vendosën theksin te rëndësia e edukimit mediatik për fëmijët, si një sfidë për shoqëritë demokratike.

Paneli i tretë diskutoi mbi reklamat dhe promocionin për fëmijë. Përfaqësuesi i UNICEF z. Roberto De Bernardi, profesori Alban Tartari, ekspertja nga Mali i Zi, Jadranka Vojvodic, përfaqësuesja nga Agjencia për Mbrojtjen e Fëmijëve Anila Bregu, diskutuan mbi ndikimin e reklamave dhe promocionit për dhe te fëmijët. Sipas tyre, duhet një ndërveprim i shtuar mes të gjithë aktorëve, që operojnë dhe kanë rol në këtë fushë.

Kjo konference është një vlerë e shtuar dhe një moment i mirë reflektimi për të gjithë aktorët e përfshirë, mediat, shoqërinë dhe komunitetin, mbi rolin e tyre në edukimin e të miturve. AMA synon që takime të kësaj natyre dhe të këtij niveli t'i kthejë në traditë të punës dhe veprimtarisë së saj, me besimin se kujdesi për fëmijët është vlera më e madhe që mund të japim në shoqëri.

➤ Takim me Qendrën SUADA mbi të drejtën e autorit

Më datë 14 janar 2021, AMA organizoi një tryezë diskutimi me përfaqësues të Qendrës SUADA mbi të drejtën e autorit. Të pranishmit në këtë tryezë e vlerësuan si të dobishme organizimin e saj, si një përpjekje konkrete për të krijuar një hapësirë diskutimi dhe ekspertize, pasi vetëm përmes komunikimit të hapur dhe të drejtpërdrejtë çështjet vlerësohen me realizëm dhe palët e interesuara do të mund të kapërcejnë mangësitë e pengesat, përmes bashkëveprimit dhe koordinimit më të mirë.

➤ **Takim me përfaqësuesit e mediave mbi lirimin e brezit 700 MHz (DD2)**

Në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive, më 20 janar 2021, Drejtoria e Frekuencave dhe TIK mirëpriti përfaqësues të mediave në vendin tonë, për të diskutuar nga afër lirimin e brezit të frekuencave 700 MHz. Gjatë këtij takimi, të pranishmit diskutuan për sfidat dhe hapat që priten të ndërmerren në të ardhmen, për lirimin e brezit 700 MHz (DD2).

➤ **Stafi AMA-s i bashkohet nismës ‘Dhuro gjak’**

Nisma e Kryqit të Kuq Shqiptar “Dhuro gjak dhe bëje botën një vend më të shëndetshëm”, me qëllim pasurimin e bankës së gjakut për sigurimin e gjakut të mjaftueshëm për fëmijët talasemikë, për të katërtin vit radhazi u mbështet nga stafi i Autoritetit të Mediave Audiovizive.

➤ **Shkëmbimi i eksperiencave në mbulimin e fushatave zgjedhore mes AMA-s dhe KPM-së - një hapësirë e re bashkëpunimi mes dy rregullatorëve**

Një delegacion nga Komisioni i Pavarur i Medias së Kosovës (KPM) ishte për vizitë zyrtare në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Procesi i monitorimit të mënyrës sesi subjektet audio dhe audiovizive mbulojnë fushatën elektorale ishte tema kryesore e bisedimeve mes përfaqësuesve të delegacioneve nga dy rregullatorët audiovizivë.

➤ **Delegacion i AMA-s, vizitë zyrtare në Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM)**

Delegacioni i Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA), i kryesuar nga Kryetarja e AMA-s, znj. Armela Krasniqi, kreu një vizitë zyrtare në Komisionin e Pavarur të Mediave (KPM) në Kosovë. Në këtë takim, delegacioni i AMA-s u prit nga Kryetari i KPM-së, Z. Xhevat Latifi dhe anëtarë të tjerë të KPM-së.

Temat kryesore të diskutimit ishin zhvillimet aktuale për të dy rregullatorët, vijimi i bashkëpunimit institucional dhe mundësitë e zgjerimit të këtij bashkëpunimi dhe, në të ardhmen, amendimi i disa akteve nënligjore të KPM-së për rregullimin e mediave në Kosovë.

➤ **Studentët e gazetarisë në Universitetin “Bedër”, prezantohen me AMA-n**

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Armela Krasniqi, mirëpriti në mjediset e institucionit disa studentë të Gazetarisë dhe Komunikimit, pjesë e Universitetit “Bedër”.

Në këtë tryezë diskutimi, Krasniqi prezantoi studentët me punën dhe sfidat e përditshme të AMA-s, si dhe ndau eksperiencën e saj në fushën e gazetarisë. Në përfundim të takimit, studentët e gazetarisë vizituan disa nga departamentet dhe u takuan nga afër me stafin e AMA-s. Disa nga botimet e Autoritetit iu shtuan bibliotekës së studentëve pjesëmarrës në takim dhe u la e hapur mundësia për praktikë pune në të ardhmen.

➤ **AMA, tryezë rajonale për implementimin e Direktivës 2018/1808 të BE-së**

Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Komisioni i Pavarur i Mediave - KPM - zhvilluan një takim pune në Tiranë. Implementimi i Direktivës 2018/1808 është një nga detyrimet, që rrjedh nga angazhimet e ndryshme ndërkombëtare të dy vendeve dhe, si i tillë, kërkon vendimmarrje dhe angazhim tërësor të të dy institucioneve. AMA dhe KPM shkëmbyen informacion për punën e deritanishme në këtë drejtim, duke u fokusuar te mënyrat me të cilat secili vend do ta vërë në zbatim.

➤ **Gjuha e urrejtjes në media, AMA-KMD-UET – forum diskutimi**

Departamenti i Komunikimit në UET, në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Autoritetin e Mediave Audiovizive, organizoi një forum mbi menaxhimin e gjuhës së urrejtjes në media, në formën e denigrimit apo stigmatizmit.

Në kuadër të këtij fenomeni, AMA dhe KMD kanë ndërmarrë një fushatë sensibilizuese për të sfiduar urrejtjen dhe diskriminimin në media, me qëllim ndërgjegjësimin e sa më shumë aktorëve apo elementëve të shoqërisë shqiptare.

Përfaqësuesit e AMA-s, gjatë vitit 2021, kanë marrë pjesë në më shumë se 37 konferenca, takime, tryeza diskutimi, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, me homologët dhe bashkëpunëtorët, për tema që lidhen me veprimtarinë e Autoritetit.

Në gusht, Kryetarja Armela Krasniqi, priti në takim, në AMA, ambasadorin e OSCE në Shqipëri Vincenzo Del Monaco. Gjatë këtij takimi të dy përfaqësuesit diskutuan mbi sfidat me të cilat përballet sot media dhe nevojën për të forcuar bashkëpunimin në këtë drejtim. Po në muajin gusht, znj. Krasniqi zhvilloi një takim virtual me homologët e AMA-s në Finlandë, Traficom. Në takimin virtual midis përfaqësuesve, temat kryesore të diskutimit ishin: zbatimi i Direktivës 2018/1808; edukimi mediatik; mbrojtja e fëmijëve në mediat audio/audiovizive; matja e audiences etj.

Në muajin shtator, Kryetarja e AMA-s, së bashku me përfaqësues të AMA-s, kanë marrë pjesë në një sërë takimesh ndërkombëtare, më konkretisht në Konferencën Ndërkombëtare me temë “Përdorimi i mjeteve moderne për matjen e audiencës”, organizuar nga Shërbimi i Mediave Publike në Ballkanin Perëndimor, në Beograd, Serbi; në takimin e 29-të të Asamblesë së Përgjithshme të Aleancës së Agjencive të Lajmeve të Ballkanit Perëndimor dhe Evropës Juglindore (ABNA), në Prishtinë, Kosovë.

Autoriteti ka forcuar prezencën në takime rajonale dhe ndërkombëtare, në të cilat diskutohet për sfidat dhe zhvillimet e fundit në fushën e mediave. Në këtë drejtim, në muajin shtator të vitit raportues, znj. Krasniqi mori pjesë në Konferencën Rajonale për autoritetet rregullatore të medias: "Roli i autoriteteve rregullatore kombëtare të medias në paradigmat e reja - AVMSD e rishikuar" organizuar nga Këshilli i Evropës, në Mal të Zi. Konferenca është një vijimësi e bashkëpunimit të Projektit "Liria e Shprehjes dhe Liria e Medias në Evropën Juglindore (JUFREX 2)", i cili ofron një platformë për shkëmbimin e përvojave, mendimeve dhe njohurive mbi tema të rëndësishme për punën e autoriteteve rregullatore. Këto takime mundësojnë diskutime të zgjeruara për zgjedhjet, pluralizmin mediatik, gjuhën e urrejtjes, shërbimet digjitale, zhvillimet e reja të

luftës kundër dezinformimit dhe punën e vazhdueshme të Këshillit të Evropës dhe Bashkimit Evropian në këtë fushë.

Në tetor, Kryetarja e AMA-s mori pjesë në Konferencën e 75-Vjetorit të Agjencisë Austriake të Shtypit (APA) organizuar nga “Aleanca Evropiane e Agjencive të Lajmeve” (EANA) dhe Asambleja e Përgjithshme, në Vjenë, Austri.

Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, Armela Krasniqi, në muajin korrik ka zhvilluar një takim prezantues me Përfaqësuesen e Lartë për Lirinë e Medias në OSBE. Gjatë këtij takimi, znj. Krasniqi foli për vizionin që do të udhëheqë veprimtarinë e saj në krye të AMA-s. Duke u ndalur te shtyllat kryesore, ajo vlerësoi mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve, mbrojtjen e gazetarëve, të drejtat e autorit, transpozimin e direktivës AVMS 2018/1808 të BE-së dhe çështje të tjera në hapësirën mediatike, të cilat kërkojnë vëmendje.

Në dhjetor, Kryetarja e Autoritetit të Mediave Audiovizive, znj. Armela Krasniqi zhvilloi një vizitë zyrtare në Zyrën Qendrore të Menaxhimit të Autoriteteve Shtetërore të Medias, në Republikën Federale të Gjermanisë. Në këtë takim, znj. Krasniqi u prit nga Dr. Wolfgang Kreissig, Kryetar i Drejtorëve të Autoriteteve Shtetërore të Medias (DLM) në përbërje të të cilit janë 14 autoritete rregullatore gjermane, të ndara sipas landeve, dhe z. Peter Matzneller, drejtues i Marrëdhënieve me Jashtë dhe njëherësh nënkryetar i bordit të EPRA. Zyrtarët diskutuan mbi sfidat e përbashkëta me të cilat përballen autoritetet rregullatore në ditët e sotme, si dhe nevojën e forcimit të bashkëpunimit përmes shkëmbimit të informacionit dhe, mbi të gjitha, ndjekjes së praktikave më të mira në këtë drejtim.

12.4 AMA në bashkëpunim me partnerët

Projekti “Kodi i Transmetimit dhe të rinjtë, sa dhe si e njohin atë”

Qëllimi i projektit fokusohet në mbledhjen e informacionit rreth njohjes nga të rinjtë e moshës 15-29 vjeç për televizionin, vlerësimet e tyre për rolin e këtij mediumi masiv në edukimin, si dhe ndërgjegjësimin e argëtimitin e rinisë.

Anketa e zhvilluar, në kuadër të këtij projekti, është e fokusuar tërësisht në Kodin e Transmetimit, bazuar në çdo seksion. Kodi në vetvete është hartuar në zbatim të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe mbi bazën e referencës së një korpusi të gjerë ligjor shqiptar dhe të konventave ndërkombëtare.

Plotësimi i 300 anketave në terren, te grupmosha e të rinjve 15-29 vjeç, në pesë qarqe të vendit, përkatësisht: Elbasan 60 anketa, Lezhë 60 anketa, Kukës 60 anketa, Vlorë 60 anketa dhe Tiranë 60 anketa ka vijuar me hedhjen dhe përpunimin e të dhënave nga ekipi i projektit, me qëllim që jo vetëm të matin njohuritë e të rinjve për Kodin e Transmetimit por edhe të nxirren rekomandime për problemet që konstatohen, në transmetimet audiovizive, në lidhje me Kodin.

Ky pyetësor përveç matjes së njohurive ka ndikuar direkt në informimin e të rinjve rreth parimeve të Kodit, pasi vetë pyetjet janë ndërtuar bazuar mbi parimet dhe shtyllat themelore të Kodit të Transmetimit.

Anketa paraqet një spektër të gjerë të dhënash sasiore dhe cilësore mbi respektimin dhe, veçanërisht, mbi cenimin që programet televizive shfaqin ndaj normave dhe parimeve të Kodit. Në këtë frymë, ky studim synon të përcjellë në publik dhe për mediat, jo vetëm një botim me tregues, por gjithashtu ai ndërton një panoramë me informacion të integruar mbi problematikat dhe cilësitë e programacionit televiziv, (përfshirë dhe edicionet informative) me tematika argëtimi, socialkulturore, që i drejtohet publikut të fëmijëve dhe të rinjve. Rëndësia thelbësore e këtij studimi qëndron në qasjen kritike ndaj përmbajtjeve të mediave në pikëpamjen e moszbatimit të parimeve të etikës, tezë e cila konfirmohet nga përgjigjet e target grupit. Përmes përgjigjeve të anketës merret një panoramë të dhënash mbi kërkesat e audiencës rinore, hapësirë e cila i ka munguar, deri diku, studimeve dhe artikujve në fushën e komunikimit dhe mediave. Studimi sjell dhe një paketë rekomandimesh për Autoritetin, mediat, shoqërinë civile etj.

Projekti “Edukimi për median dhe informacionin nga secili dhe për secilin”

Instituti Shqiptar i Medias, ISHM, përmes projektit të mbështetur nga AMA, ka pasur si objektiv kryesor që për zhvillimet gjatë Covid-19 të monitorojë dhe analizojë problematikat me lajmet e pavërteta, ose me përhapjen e dezinformacioneve, keqinformacioneve dhe çinformimit, si aspekte të asaj që njihet si çrregullimi informativ (ose kaosi informativ).

Fokusin, në këto fenomene, ISHM e ka parë të lidhur me një instrument po aq të përfolur sot në gazetari e komunikim, që është Edukimi mbi Median dhe Informacionin, EMI, (ose Media and Information Literacy – MIL). ISHM e ka parë angazhimin me këtë projekt si një përfshirje afatgjatë në dy problematika, që nuk janë vetëm të medias shqiptare, por të medias në rang global - si sfida të shoqërisë për të rritur nivelin e edukimit të publikut në kuptimin dhe “leximin” sa më të drejtë të përmbajtjeve, që publikohen ose transmetohen nga njësitet mediatike tradicionale, ose nga sistemi i rrjeteve sociale.

Duke vlerësuar hapat që ka hedhur ISHM në realizim të këtij projekti, identifikohen dhe tri produktet kryesore: kryerjen e një studimi kërkimor; realizimin e një publikimi, si dhe organizimin e një tryeze me përfaqësues të komunitetit të gazetarëve, ekspertëve, të shoqërisë civile etj.

Te pjesa e studimit vërehet një miks mes monitorimit të performancës, problematikat dhe sfidat, si dhe një analizë profesionale.

Projekti “Identifikimi i problemeve që lidhen me dezinformimin - lajmet e rreme në mediat audiovizive, mbrojtja e audiencave prej dezinformimit dhe lajmet e rreme.”

Projekti ka realizuar një *desk research*, i cili e ndihmoi në përcaktimin e metodologjisë së monitorimit dhe sondazhit. Qëllimi i projektit është identifikimi i rasteve të dezinformimit -lajmet e rreme në mediat audiovizive dhe propozimi i masave për të siguruar mbrojtjen e audiencave prej një fenomeni të tillë, përmes kuptimit të dezinformimit e lajmeve të rreme dhe edukimit të mëtejshëm për median.

Gjatë *desk research* u shqyrtuan përvoja, synime dhe metoda, që do të ndihmojnë në qasjen ndaj dezinformimit, keqinformimit në mediat audiovizive. Në rrafshin empirik, organizata “Klubi Aleph” kreu një sondazh me 180 persona, online, përmes një pyetësi me të paktën 26 pyetje të mbyllura, me qëllim marrjen e përgjigjeve të sigura. Ndërsa përmes monitorimit të mediave të përzgjedhura u bë e mundur të matet shkalla e dezinformimit në edicionet informative të këtyre mediave, duke arritur edhe një matje të përafëruar për tregun audioviziv në përgjithësi.

Një nga aktivitetet kryesore ishte monitorimi i mediave audiovizive për identifikimin e masës së dezinformimit, keqinformimit – lajme të rreme në transmetimet audiovizive. U zgjodhën përkatësisht 4 kanale televizive, dy prej të cilave informative dhe dy gjeneraliste, të cilat u monitoruan për 15 ditë, të ndara përgjatë një muaji në transmetimet e edicioneve të lajmeve në prime time (respektivisht ora 19:30; 20:00; 19:00 dhe 15:00).

Aktivitet tjetër kryesor ishte edhe sondazhi. Sondazhi u realizua gjatë periudhës 5 maj 2021 – 23 maj 2021. 57% e të pyeturve janë femra ndërsa 43 % janë meshkuj, ndërsaq mosha mesatare është 21.8 vjeç. 63% e të pyeturve janë studentë të *bachelor*-it. Studentët i përkasin kryesisht fakultetit Ekonomik, Histori-Filologji, Drejtësi, Shkencat e Natyrës, Shkenca Sociale, Artet e Bukura, Arkitekturë dhe Urbanistikë, Mekanikë etj.

Përmes anketimit janë përfituar të dhëna në lidhje me impaktin e transmetimeve me dezinformime të shkallëve të ndryshme te publiku dhe, ndërkohë, kemi matur edhe shkallën e edukimit mediatic në raport me lajmet e rreme të grupit të synuar në këtë projekt, si dhe ndikimin e reklamave në vendimmarrjen apo këndvështrimin e të anketuarve. Sondazhi u krye me 180 persona, online, përmes e-mailit, sipas rastit, duke respektuar masat e distancimit për shkak të Covid 19.

Në publikimin përfundimtar u përfshinë *desk research*, gjetjet e monitorimit, gjetjet e sondazhit, përfundimet dhe rekomandimet e projektit, të cilat u përmbledhën në një publikim të pajisur me ISBN.

“Monitorimi i zgjedhjeve dhe prioritetet për t’u adresuar në të ardhmen. Një analizë krahasuese në tre vendet e rajonit: Shqipëri, Kosovë, Maqedoni”

Sipas kësaj analize, në të tre vendet, ku është zhvilluar studimi, televizioni është burimi kryesor i informacionit, por rëndësia e portaleve është rritur ndjeshëm gjatë viteve të fundit. Në Shqipëri nuk ka kuadër ligjor rregullator për portalet, por vetëm për televizionin e radion. Në Maqedoninë e Veriut, Kodi Zgjedhor parashikon rregulla të njëjta për televizionet, gazetarët dhe portalet. Në Kosovë, hapësira e mediave tradicionale është kryesisht e rregulluar nga ligjet dhe e mbikëqyrur nga institucionet përkatëse, ndërsa mediat online mbeten të parregulluara.

Në disa elemente, si transmetimi i reklamave apo marrëdhënia e gazetarëve me partitë politike, detyrimet dhe monitorimi i mediave në Maqedoninë e Veriut nis nga momenti i shpalljes së datës së zgjedhjeve. Në Shqipëri dhe në Kosovë ky detyrim nis ditën që fillon fushata zgjedhore.

Në Shqipëri dhe Maqedoninë e Veriut mungon raportimi i thelluar dhe analitik i fushatës zgjedhore. Në Kosovë, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), përveç analizës sasiore bën dhe vlerësim dhe analizë cilësore të prezantimit të fushatës nga media. Gjithsesi, ka ende vend për t’u përmirësuar në mënyrë që të ketë një paraqitje sa më cilësore të të dhënave.

“Rregullimi i teknikave për stabilizimin dhe mirëmbajtjen e nivelit maksimal të volumit dhe zhurmave në televizion”

Projekti “Rregullimi i teknikave për stabilizim dhe mirëmbajtjen e nivelit maksimal të volumit dhe zhurmave në televizion”, është realizuar nga Organizata jofitimprurëse “New Vizion Organization” (NEO).

Fokusi i tij ka qenë analiza dhe përzgjedhja e praktikave më të mira në Bashkimin Evropian dhe më gjerë, për sa i përket rregullimit të teknikave për stabilizimin dhe mirëmbajtjen e nivelit maksimal të volumit dhe zhurmave në televizione dhe radio dhe paraqitja e propozimeve për AMA-n në vijim.

Në fazën e parë organizata ka kryer monitorimin e 25 programeve, duke bërë matje në secilin televizion, në fasha orare të ndryshme si dhe në programacione dinamike të tyre.

Nga ana e organizatës është konsultuar baza ligjore e institucioneve më të rëndësishme ndërkombëtare, që merren me rregullimin e këtij tregu, duke ruajtur dhe të drejtat e publikut për mospërdorim të zhurmave dhe nivelit të lartë audio gjatë reklamave apo hapësirave promociionale, me qëllim tërheqjen e vëmendjes për arsye komerciale.

Në produktin përfundimtar, organizata jofitimprurëse “New Vizion Organization” (NEO), organizata ka përgatitur rekomandimet për AMA-n, në përputhje me rekomandimet e BE-së, ITU-së, EBU-së, sa i përket teknikave të monitorimit dhe rekomandimet për operatorët audiovizive.

12.5 Marrëveshjet e bashkëpunimit

Bashkëpunimi AMA-AKEP

Autoriteti i Mediave Audiovizive dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare nënshkruan, në datën 03.11.2021, Memorandumin e Bashkëpunimit me qëllim garantimin dhe mbështetjen operacionale, teknike dhe ligjore, në fushat me interes të përbashkët për të dyja palët.

Përmes këtij memorandumi, institucionet angazhohen të bashkëpunojnë për realizimin dhe zbatimin e tij, në këto drejtime:

- Lirimin e brezit 700 MHz (DD2), nga AMA, dhe marrjen në administrim të këtij brezi nga AKEP-i.
- Ngritjen e një TASK-FORCE, me përfaqësues të përbashkët nga të dy institucionet me qëllim luftën kundër paligjshmërisë në transmetimet pa të drejta autori përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike.
- Ngritjen e një grupi të përbashkët, i cili do të ndjekë në vijueshmëri problemet e interferencave të shkaktuara nga subjekte, veprimtaria e të cilëve përfshihet në fushën e veprimit të këtyre institucioneve si dhe interferencave, që raportohen nga autoritetet rregullatore të vendeve fqinjë;
- Krijimin e një inventari të unifikuar të frekuencave, bazuar në detyrimet ligjore të përcaktuara për të dy institucionet lidhur me “Miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit” si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të saj.

Marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin Politeknik të Tiranës

Në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe legjislacionit në fuqi të fushave përkatëse, gjatë proceseve të punës së përbashkët të dy institucioneve, në datën 7 prill 2021, u nënshkrua Marrëveshja e Mirëkuptimit “Mbi bashkëpunimin dhe ndërveprimin ndërinstitucional” midis Universitetit Politeknik të Tiranës dhe Autoritetit të Mediave Audiovizive (AMA).

Në zbatim të kësaj marrëveshjeje, më datë 7 qershor 2021, midis palëve është nënshkruar Kontrata e Shërbimit me objekt “Ndjekja/Pjesëmarrja në grupet studimore të ITU-së, që trajtojnë çështjet rregullatore dhe teknike të transmetimeve audio/audiovizive”.

Detyrimet e FTI (UPT) ndër të tjera ishin:

- Të ndjekë dhe të marrë pjesë në grupet studimore të ngritura nga strukturat e ITU-së dhe konkretisht Zyra e Radiokomunikimit, Zyra e Standardizimit dhe Zyra e Zhvillimit, për çështjet audiovizive.
- Të angazhohet në plotësimin e pyetësorëve të përgatitur nga këto grupe pune, në bashkëpunim të ngushtë me AMA-n.
- Të analizojë konkluzionet e dala nga grupet e studimit si dhe të shprehë opinionin në nivel akademik mbi këto konkluzione.

Për sa më sipër, FTI (UPT), në dhjetor 2021, ka depozituar në AMA informacionin final mbi propozimet e grupeve të punës të ITU-së, si dhe konkluzionet e nxjerra prej tyre, sa i takon çështjeve teknike dhe rregullatore të transmetimeve audio/audiovizive.

Ky material do t'i vijë në ndihmë AMA-s, për përgatitjen paraprake mbi çështjet që do të diskutohen dhe miratohen në Konferencën Botërore të Radiokomunikacionit (WRC) që do të zhvillohet në vitin 2023, për të cilat administrata shqiptare, si anëtare me të drejta të plota në ITU, do të ketë vendimmarrje.

12.6 Publikimi i Buletinit Periodik të AMA-s

Gjatë vitit 2021, AMA përgatiti Edicionin 7 të Buletinit Periodik, që jep një pasqyrë të dinamikës në tregun audio/audioviziv, ku përfshihen dhe tregues me natyrë ekonomike dhe financiare, teknike e teknologjike, pronësore, përmbajtësore, të burimeve njerëzore të angazhuara etj., në vitin 2020. Buletini është një produkt i standardizuar dhe i qëndrueshëm, si ndihmë konkrete për analizuar problematika e prirje brenda një viti ose duke bërë krahasime nga një periudhë në një tjetër.

Buletini Periodik është material ndihmës jo vetëm për stafet e OSHMA-ve, ku shikohet performanca e subjektit të tyre në raport me të gjithë tregun, ose segmente të caktuara të tij, por në versionin *hard copy* ose *soft copy* preferohet nga kërkuesit dhe studiuesit e tregut audio/audioviziv, studentët e gazetarisë e të komunikimit, për institucionet vendase dhe të huaja që monitorojnë dhe mbështesin projekte dhe programe në sektorin mediatik etj.

12.7 Menaxhimi i performancës së burimeve njerëzore

Trajnimi i nëpunësve civile është një element shumë i rëndësishëm i legjislacionit në fushën e shërbimit civil dhe nga niveli i zbatimit të tij mund të vlerësohet edhe niveli cilësor i administratës së këtij institucioni në realizimin e misionit të tij. Parë në këtë këndvështrim, edhe gjatë vitit 2021, në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë ka ndjekur dhe koordinuar pjesëmarrjen e të gjithë nëpunësve civilë në trajnimet online të ofruara, me qëllim thellimin e njohurive dhe përmirësimin e performancës.

Përpyekjet janë bërë edhe për pjesëmarrjen dhe trajnimin e stafit të institucionit në takime dhe workshop-e të organizuara në kuadër të projekteve të ndryshme ku AMA është palë. Konkretisht, përmendim projektin “Teknologjia e transmetimeve audio/audiovizive në kohën digjitale”, projekt i cili është mundësuar nga AMA në bashkëpunim me Institutin e Inxhinierëve Broadcasting Shqiptarë. Nëpërmjet këtij projekti u synua plotësimi i njohurive të inxhinierëve dhe teknikëve mbi transmetimet digjitale si televizione (DVB-T2), ashtu edhe radiofonike (DAB/DAB+). Në këtë aktivitet, stafi teknik u prezantua dhe me zhvillimet më të reja në fushën e transmetimeve audiovizive, risitë që ato sjellin, nevojat e zhvillimeve teknologjike dhe ato të burimeve njerëzore, të kërkuara për të ndjekur dhe për të qenë novatore në përqafimin e teknikave dhe standardeve të reja të komunikimeve audio dhe audiovizive.

Angazhimi i stafit të AMA-s për të plotësuar detyrimet që rrjedhin nga procesi i integritimit në Bashkimin Evropian, aktualisht, për sa i përket fushës së politikave audiovizive, ka qenë i vazhdueshëm dhe me përparësi maksimale. Në këtë kuadër, AMA, në vijim të angazhimit të saj në procesin e miratimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian 2022 – 2024 (më herët ka qenë PKIE 2021-2023) në bashkëpunim me institucionet lider të kapitujve dhe institucioneve kontribuuese, është bërë pjesë e trajnimit të personave të ngarkuar në grupet ndërinstitutionale të punës për integrimin evropian, për kapitujt e *acquis* në të cilën Autoriteti i Mediave Audiovizive është i përfshirë.

AMA zhvillohet si një institucion që zotëron dije, mëson nga përvoja dhe mbështet thellimin e njohurive të punonjësve. Në këtë moto, në planin e zhvillimit profesional të nëpunësit, është organizuar, me stafin e institucionit, dhe një trajnim, gjatë vitit 2021, me temë “Angazhimi i AMA-s në procesin e monitorimit të zgjedhjeve si dhe pasqyrimi i fushatës zgjedhore në median audiovizive, sfidat dhe konkluzionet”.

13. TREGUESIT FINANCIARË DHE MENAXHIMI I BURIMEVE

13.1 Menaxhimi i burimeve financiare

Autoriteti i Mediave Audiovizive, si një institucion me vetëfinancim, krijon dhe siguron me burimet e veta financiare përmbushjen e funksioneve të veta. Në këtë prizëm, përmirësimi i treguesve financiarë të veprimtarisë së Autoritetit ka qenë një ndër objektivat e realizuara të AMA-s, në zbatim të strategjisë dhe planit të veprimit 3-vjeçar, 2021-2023.

Bazuar në nenin 24, të ligjit nr. 97/2013, burimet e financimit të AMA-s janë:

- a) të ardhurat nga pagesat për marrjen dhe rinovimin e licencave dhe/ose autorizimeve;
- b) të ardhurat nga pagesat vjetore të licencave dhe/ose autorizimeve;
- c) të ardhurat nga përpunimi administrativ i kërkesave për aplikime;
- ç) të ardhurat nga tarifat për shërbimet e transmetimeve të caktuara në ligjet fiskale, në rolin agjentit tatimor;
- d) financime nga Buxheti i Shtetit;
- dh) burime të tjera të ligjshme.

AMA, me vendimin nr. 153, datë 24.12.2020, ka miratuar projektbuxhetin për vitin 2021 për **“Të ardhura totale”** (Të ardhura korente të pritshme; Të ardhura nga debitorët e vitit të kaluar; Të ardhura të mbartura nga viti i kaluar; dhe **“Shpenzime totale”** (Paga, kontribute dhe shpërblime; Mallra dhe shërbime; Investime korente).

Vendimi nr. 153, datë 24.12.2020 ka pësuar disa ndryshime gjatë vitit 2021, kryesisht për monitorimin e procesit zgjedhor, për zgjedhjet parlamentare të datës 25 prill 2021.

13.2 Realizimi i burimeve të financimit në vitin 2021

Ecuria e arkëtueshmërisë së burimeve të vetëfinancimit për “Të ardhurat korente të periudhës” dhe “Të ardhura nga debitorët e vitit të kaluar”

000 lekë

Nr.	Emërtimi	Parashikimi i të ardhurave për vitin 2021	Detyrimeve financiare të lindura OSHMA-ve të licencuara/autorizuara në vitin 2021 (Faturime gjatë vitit 2021)	Hequr/shpallur të pavlefshme licenca/autorizime/sistemime faturash gjatë vitit 2021	Falur detyrimi për kamatëvone së me vendimin nr. 70, datë 19.05.2021	Totali i të ardhurave të realizuara viti 2021	Realizimi në % (sipas projekt buxhetit)	Realizimi në % (sipas faktit)
		1	2	3	4	5	$6=5/(1-3-4)*100\%$	$7=5/(2-3-4)*100\%$
A	Të ardhurat korente të periudhës (1+2+3+4+5+6+7)	235,380	220,520	2,764		220,009		
1	Të ardhura nga licenca/autorizim + pagesat për rinovimet	210,130	216,718	2,168		202,107	97	94

	a) Realizimi i pagesave nga subjektet televizivë privat vendorë		16,625			14,375		
	b) Realizimi i pagesave nga rrjetet numerike kombëtare tokësore, satelitore dhe lokale		56,593			56,593		
	c) Realizimi i pagesave nga subjektet marrë autorizim nga AMA për OTT, IPTV, Internet TV		55,488			50,785		
	d) Realizimi i pagesave nga subjektet radiofonikë privatë vendorë analog		20,596			18,087		
	e) Realizimi i pagesave nga subjektet marrë autorizim nga AMA (kabllorë)		67,416	2,168		62,267		
2	Të ardhura si agjent tatimor	645	662	7		632	99	96
	- Nga subjektet e licencuar/autorizuar		662	7		619		
	- Nga subjektet hequr licenca/autorizimi					13		
3	Të ardhura nga përpunimi administrativ	1,305	3,140			3,100	238	99
4	Të ardhura nga interesat bankare	100				29	29	
5	Të ardhura të tjera (lëshim DVD, fotokopje materialesh)	60				63	105	
6	Të ardhura të tjera:	23,140		589	1,425	13,606	64	
	-Nga kamatëvonësat	5,290		84	1,425	3,663		
	-Nga gjobat	420				511		
	-Nga debitorët e viteve të kaluara (licenca/autorizime +5% tarifë RTV)	17,279		505		9,432		
7	-Të ardhura nga debitorët hequr licenca/autorizimi	150				472		
B	Të ardhura nga paga të kthyera nga ish-punonjës të AMA-s					408		
	Totali i të ardhurave (A+B)	235,379	220,520	2,764	1,425	220,417	95	

AMA, gjatë vitit kalendarik 2021, shënoi sërish rritje të arkëtueshmërisë të burimeve të veta të financimit, duke arritur kështu edhe këtë vit përmbushjen e objektivave dhe realizimin e parashikimit buxhetor vjetor. Arritja e këtyre rezultateve u mundësua duke ndjekur kryerjen e pagesave të detyrimeve financiare të lindura në vitin 2021, të subjekteve të licencuara/autorizuara, përmes rrugës shkresore, postës elektronike dhe komunikimit telefonik. AMA, gjatë vitit raportues, ka investuar organet gjyqësore për vjeljen e detyrimeve financiare të lindura ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit nga subjektet të cilave iu janë hequr ose bërë konstatim pavlefshmërie të licencave/autorizimeve, gjatë viteve 2016-2021.

AMA, në kushtet e krijuara prej vështirësive nga efektet e pandemisë COVID-19, si dhe duke reflektuar përmes dimensionit social në lehtësimin e detyrimeve financiare të OSHMA-ve, kryesisht ndaj subjekteve të transmetimit audio, miratoi vendimin nr. 70, datë 19.05.2021, “Për miratimin e lehtësimit financiar për subjektet audio dhe audiovizivë”.

Vendimi i sipërcituar pati disa efekte financiare për vitin 2021, konkretisht u dhanë ndihma financiare si më poshtë:

- Për 3 (tre) nga subjektet e licencuara nga AMA si audio të komunitetit u akordua një ndihmë e menjëhershme në masën 600,000 lekë (200,000 lekë/subjekt).
- Për subjektet e licencuara/autorizuara nga AMA të cilat ishin me detyrime financiare për kamatëvonesat e lindura deri në fund të vitit 2020 dhe që rezultonin të pashlyera deri në datën e miratimit të vendimit (19.05.2021), u vendos falja e tyre. Masa totale e kamatëvonesave të falura ishte 1,425,148 lekë.

Ndërkohë referuar një prej dispozitave të vendimit të AMA-s, nr. 70, datë 19.05.2021, për kategoritë e subjekteve audio u vendos, vetëm për vitin 2022, përfitimi i reduktimit të pagesës vjetore për licencë, sipas disa modaliteve të caktuara, si dhe u caktua si kusht për përfitimin e këtij reduktimi, shlyerja e plotë e detyrimeve të papaguara nga kjo kategori brenda datës 30 qershor 2021. Nga kjo dispozitë, subjektet përfituese për vitin 2022, janë si më poshtë:


- 8 subjekte të licencuara për transmetime audio analoge me zonë ofrimi shërbimi deri 1 (një) bashki, përfituan faljen e pagesës vjetore për licencë të vitit 2022.
- 34 subjekte të licencuara për transmetime audio analoge me zonë ofrimi shërbimi mbi 1 (një) bashki deri në 4 (katër) qarqe, përfituan faljen në masën 50% të pagesës vjetore për licencë të vitit 2022.
- 3 subjekte të licencuara për transmetime audio analoge kombëtare, përfituan faljen në masën 500,000 lekë, nga pagesa vjetore për licencë të vitit 2022.

Burimi kryesor i vetëfinancimit të AMA-s janë “Të ardhura nga detyrimet për pagesën vjetore për licencë/autorizim”. AMA, gjatë vitit 2021, ka vazhduar me trendin rritës të arkëtueshmërisë së burimeve të saj të financimit, ku zëri “Të ardhura nga detyrimet për pagesën vjetore për licencë/autorizim”, për periudhën 2017-2021 paraqitet si më poshtë:

000 lekë

Vitet	Të ardhura vjetore të pritshme	Të ardhura vjetore të realizuara	Realizimi në %
-------	--------------------------------	----------------------------------	----------------

2017	166,773	156,661	94%
2018	190,052	177,352	93%
2019	188,192	183,229	95%
2020	201,973	190,573	94%
2021	216,717	202,107	94%



Nënzëri **“Të ardhura nga gjobat”**, bazuar në pikën 13, të nenit 133, të ligjit nr. 97/2013, ku përcaktohet se: *“..Gjoha është titull ekzekutiv që ekzekutohet nga shërbimi përmbartimor dhe derdhet 80 për qind në Buxhetin e Shtetit dhe 20 për qind në buxhetin e AMA-s”*, parashikon të ardhura për AMA-n, për vitin 2021, në masën 420,000 lekë (2,100,000 lekë x 20% = 420,000 lekë).

Në fund të vitit 2021, si rezultat i pagesave nga vetë subjektet apo si rezultat i kontratave të lidhura me përmbartues privatë gjyqësorë, AMA arkëtoi 2,553,100 lekë, prej të cilave 510,620 lekë i përkasin të ardhurave të institucionit.

Ecuria e ekzekutimit të titujve ekzekutivë, për sanksione me gjobë, gjatë viteve 2017-2021, për arkëtimet e kryera dhe të ardhurat, të cilat i takojnë institucionit, paraqitet si më poshtë:

000 lekë

Titujt ekzekutivë me sanksion gjobë/vitet	2017	2018	2019	2020	2021
Arkëtimet në total (100%)	11,326	12,977	8,832	2,008	2,553
Të ardhura për AMA-n (20%)	2,265	2,595	1,766	402	511

Gjatë vitit 2021, pati rritje të arkëtueshmërisë së pagesave për sanksionet me gjobë në krahasim me parashikimin e bërë në masën 420,000 lekë.

13.3 Detyrimet financiare të OSHMA-ve

a) OSHMA të licencuara/autorizuara gjatë vitit 2021

Pasqyra përmbledhëse e OSHMA-ve të licencuara/autorizuara, që rezultojnë me detyrime financiare ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit, deri në fund të vitit 2021, paraqitet si më poshtë:

000 lekë

Kategorizimi i subjekteve	Licencë/autorizim	Tarifa për shërbimet e transmetimeve radiotelevizive RTV	Kamatëvonesa	Totali
Televizione analoge	2,441	7	915	3,363
Rrjetet numerike kombëtare tokësore, satelitore dhe lokale	-	-	469	469
Ofrues programi/ripërsëritës programi mbështetur në internet (IPTV/OTT)	4,702	-	2,144	6,846
Radio analoge	2,228	833	898	3,959
Ripërsëritës programi mbështetur në rrjet kabllor	3,977	-	1,450	5,427
Shuma totale	13,348	840	5,876	20,064

b) OSHMA me licenca/autorizime të hequra/konstatim pavlefshmërie, në vitet 2015-2021

AMA, gjatë vitit 2021, ka marrë vendime për heqje/konstatim pavlefshmërie të licencave/autorizimeve. 4 (katër) OSHMA rezultonin me detyrimeve financiare, në masën totale 719,368 lekë. Kjo shumë përbëhet prej:

- 2 (dy) subjekte të autorizuara për përsëritjen e shërbimit të programit të të tretëve mbështetur në rrjet kabllor, në masën 74,790 lekë;
- 1 (një) subjekt i autorizuar për ofrim shërbim programi në rrjet OTT, në masën 415,095 lekë;
- 1 (një) subjekt i licencuar për televizion privat vendor, në masën 229,483 lekë.

Në vitin 2021, me vendim të AMA-s është shuar masa e detyrimit për një subjekt, në vlerën 18,520,000 lekë, autorizimi i të cilit, për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv të të tretëve mbështetur në internet (IPTV) është bërë i pavlefshëm.

Ndërkohë, gjatë vitit 2021, nga ana e subjekteve debitorë (hequr licenca/autorizimi) janë shlyer vullnetarisht dhe nëpërmjet shërbimit privat përmbarimor, detyrimet ndaj AMA-s dhe Buxhetit të Shtetit në masën totale 727,022 lekë.

Për sa më sipër, masa e detyrimeve financiare të subjekteve hequr licenca/autorizimi apo bërë konstatim pavlefshmërie e tyre, u reduktua nga 113,554,678 lekë në 95,027,024 lekë, si më poshtë:

000 lekë

Kategorizimi i subjekteve/vitet	Televizione analoge		Ripërsëritës programi		Ofrues programi		Radio analoge	
	Nr. subjekteve	Masa detyrimit financiar	Nr. subjekteve	Masa detyrimit financiar	Nr. subjekteve	Masa detyrimit financiar	Nr. subjekteve	Masa detyrimit financiar
2015	-	-	5	10,405	-	-	-	-
2016	4	5,388	13	40,557	2	25,042	3	1,923
2017	3	415	7	2,754	1	162	3	1,105
2018	6	3,179	7	670	-	-	1	106
2019	2	100	2	2,122	-	-	1	0.3
2020	1	415	1	87	-	-	1	114
2021	1	17	1	51	1	415	-	-
Totali	95,027							

13.4 Përdorimi i burimeve financiare në vitin 2021

Gjatë vitit raportues, AMA ka menaxhuar burimet financiare bazuar në projektbuxhetin për vitin 2021, të ndryshuar, si dhe në Regjistrin e Parashikimeve të Prokurimeve Publike, të ndryshuar.

Në kuadër të kryerjes së monitorimit të procesit zgjedhor, për zgjedhjet parlamentare të datës 25 prill 2021, si dhe kërkesave të drejtorive/njësi, AMA ka bërë disa ndryshimet e nevojshme në projektbuxhetin e vet.

13.4.1 Shpenzimet dhe investimet në vitin 2021

000 lekë

Nr.	Shpenzime/Investime	Plani	Shtesa/pakësime gjatë vitit 2021	Fakti	% e realizimit
		1	2	3	3/(1+2)*100
I	Shpenzime korente (a+b)	210,868	19,199	136,945	60
	a) Paga, kontribute për sig. shoq. dhe shend., shpërblime	85,543	7,178	86,984	94

	<i>b) Shpenzime për mallra dhe shërbime</i>	125,325	12,021	49,961	36
II	Shpenzime për investime (a+b)	38,329	1,232	22,568	57
	a) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	31,810	946	16,661	51
	- Studime dhe kërkime (2021)	15,000	-	8,066	
	- Studime, kërkime, anketime (të filluara në vitin 2020, për t'u përfunduar në vitin 2021)	4,800	-	4,119	
	-Programe/aplikacione	12,010	946	4,476	
	b) Aktive të qëndrueshme të trupëzuara	6,519	286	5,907	87
	- Blerje pajisje elektronike (2021)	960	-	702	
	- Mjete dhe pajisje të tjera zyre/teknike (2021)	1,959	598	2,080	
	- Mjete dhe pajisje të tjera zyre/teknike (të filluara në vitin 2020, për t'u përfunduar në vitin 2021)	3,600	(312)	3,125	

1. Me fondet e veta AMA realizoi:

Shpenzimet për paga e shpërblime, kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore (për punonjësit sipas strukturës organizative të AMA-s dhe jashtë strukturës/call center), si dhe shpenzimet e nevojshme për mallra dhe shërbime të kërkuara nga drejtoritë/njësitë e saj.

AMA mbuloi, me fondet e veta, shpenzimet për pagesa për monitoruesit e jashtëm, për zgjedhjet parlamentare të datës 25 prill 2021.

Me projektbuxhetin për vitin 2021, të miratuar me vendimin nr. 153, datë 24.12.2020, u parashikua detyrimi i mbetur nga AMA ndaj shoqërisë “Media +” sh.a., në masën 11,191,369 lekë.

AMA, në vijim të korrespondencave shkresore me Përmbarduesin Privat Gjyqësor dhe shoqërinë “Media +” sh.a.:

- kreu pagesë për llogari të shoqërisë “Media +” sh.a. në masën 7,824,471 lekë;
- uli detyrimet financiare të shoqërisë “Media +” sh.a. ndaj AMA-s në masën 766,898 lekë;
- në zbatim të Urdhër Sekuestros me nr. 6/10 prot., datë 24.06.2021 u sekuestruan 2,600,000 lekë në një nga llogaritë bankare të AMA-s.

AMA, në vijim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit me Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), miratimit në projektbuxhet për vitin 2021, mbështeti financiarisht KMD për projektin: Sfidë urrejtjen - "Menaxhimi i rasteve të përdorimit të gjuhës së urrejtjes me sfond fetar në formën e denigrimit, stereotipizimit dhe stigmatizimit", në masën 1,496,500 lekë.

Zhvillime në të njëjtin profil pati dhe nga Ministria e Kulturës, e cila, në vijim të mbështetjes financiare të dhënë nga AMA, në tetor 2020, për dy projekte, në masën totale 7,200,000 lekë (3,600,000 lekë/projekt), përfundoi, në vitin 2021, projektin “Edukimi përmes Kulturës” në masën 3,550,000 lekë, duke kthyer në llogari të AMA-s shumë e pashpenzuar prej 50,000 lekë. Në lidhje me projektin “Digjitalizimi i filmit” është bërë amendim kontrate midis Ministrisë së Kulturës dhe AMA-s për realizimin e tij në vitin 2022.

AMA, edhe në vitin 2021, vijoi me mbështetjen financiare për veprimtari sociale e publike (ekologjike), duke dhuruar pemë për Bashkinë Tiranë në masën 620,400 lekë.

13.4.2 Ecuria e investimeve:

Në zërin “*Aktive të qëndrueshme të patrupëzuara*”, u realizuan:

- Zëri “Studime, kërkime dhe anketime”, ndarë si më poshtë:

Projekte të nisura në vitin 2020, për t’u finalizuar në vitin 2021, u realizuan në masën 2,747,220 lekë për financime të projekteve me tema: “Teknologjia dhe infrastruktura e transmetimeve audio/udiovizive në kohën digjitale”; “Konvergjencia e Medias dhe fenomeni i post të vërtetës”; “Vlerësimi i audiencave ndaj respektimit të Kodit të Transmetimit në transmetimet audiovizive nga OSHMA-të”. Gjithashtu në vitin 2021, u finalizua projekti “Radiot fetare në Shqipëri - Situata, Probleme, Sfidë”, në masën 572,000 lekë.

Projekte në vitin 2021 u realizuan në masën 8,065,475 lekë, për financime të projekteve me tema: “Përkthime nga literatura e huaj në shqip”; “Gazetaria tradicionale përballë audiencave të reja. Si po ndryshon gazetaria tradicionale shqiptare?”; “Ndjekja/pjesëmarrja në grupet studimore të ITU-së, që trajtojnë çështjet rregullatore, teknike të transmetimeve audio/udiovizive”; “Rregullimi i teknikave për stabilizim dhe mirëmbajtjen e nivelit maksimal të vullmit dhe zhurmave në televizion”; “Mbrotja e audiencave nga lajmet e rreme dhe identifikimi i problemeve që lidhen me edukimin për median”; “Kodi i Transmetimit dhe të rinjtë, sa dhe si e njohin atë – Anketim mbi performancën e Kodit të Transmetimit në transmetimet audiovizive”; “Edukimi për median dhe informacioni nga secili dhe për secilin”; “Monitorimi i zgjedhjeve dhe prioritetet për t’u adresuar në të ardhmen” (faza e parë).

- Zëri “*Programe/aplikacione*”, u realizua në masën 4,476,000 lekë për: “Program (soft) për regjistrimin e subjekteve audio (radio) nëpërmjet sistemit të qëndrësuar FM në 12 stacione”, “Program kompjuterik për shërbimin Helpdesk”, si dhe “Blerje softi për përpunimin e të dhënave për Komisionin Qendror të Zgjedhjeve” (zë i shtuar në shkurt 2021 në projektbuxhetin e vitit).

Në zërin “*Aktive të qëndrueshme të trupëzuara*” u realizuan:

- “Blerje pajisje elektronike/kompjuterike”, në masën 702,000 lekë.
- “Mjete dhe pajisje të tjera zyrtare/teknike”:

Nisur në vitin 2020, për t’u finalizuar në vitin 2021, realizuar në masën 3,124,680 lekë për blerje “Server/SAN (Storage Area Network)”;

Të nisura dhe realizuara në vitin 2021 në masën 2,080,348 lekë për: HDD të jashtme; Televizor DVB-T2 65”, Kaseta LTO; DVR; Dekodera; Kufje profesionale; Kronometra; Vegla pune; Riparim UPS M4T Evolution; Mobilje zyre; Lule me vazo për ambientet e brendshme; Termometër, aparat tension dhe oksimetër; Pajisje sinjalistike; Perde; Piktura; Dekorim xhami.

13.5 Pasqyrat Financiare

Pasqyra të ardhura dhe shpenzime në datë 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2021

lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2020
A	Të ardhurat korente të periudhës	229,227,329	216,208,795
1	Të ardhura nga licenca/autorizim	215,452,298	202,589,141
2	Të ardhura si agjent tatimor	663,970	750,256
4	Të ardhura nga përpunimi administrativ	3,040,000	3,610,000
5	Të ardhura nga interesat bankare	28,769	38,803
6	Të ardhura të tjera nga gjobat, kamatëvonesa për licenca/autorizime/gjoba	10,042,292	9,220,595
B	Shpenzime operative	109,557,691	107,261,936
1	Materiale zyre kancelari	2,248,315	2,777,518
2	Paga, shpërblime dhe të tjera shpenzime personeli	93,714,755	87,837,125
3	Shpenzime mirëmbajtje të godinës	759,216	1,409,428
4	Shpenzime për shërbime furnizuese	11,171,670	8,643,783
5	Shpenzime transporti dhe mirëmbajtje të makinave	1,645,135	2,397,292
6	Taksa vendore	15,000	15,000
7	Shpenzime gjyq, legale	3,600	4,181,790
C	Shpenzime të veprimtarisë funksionale të AMA-s	11,068,887	44,427,521
1	Konsulenca, trajnime, studime tregu	2,003,552	994,280
2	Shpenzime përfaqësimi	9,065,335	2,293,641
3	Shpenzime për digjitalizimin	-	41,139,600
D	Humbje të vitit	20,020,163	1,153,962
1	Shfuqizim gjobash	29,000	424,720
2	Heqje licence/autorizimi, sisteme	19,991,163	729,242

E	Amortizime dhe zhvlerësime të aktiveve të trupëzuara	1,039,821	-61,277
Rezultati ekonomik (A-B-C-D-E)		87,540,767	63,426,653

Pasqyra e aktiveve dhe pasiveve për vitet 2020-2021

lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2021	Viti 2020
A.	Aktivet afatshkurtra (I - V)	634,004,088	617,804,863
I.	Gjendje inventari i imët	4,126,082	5,165,902
II.	Kërkesa për arkëtim ndaj të tretëve (1 - 4)	437,710,724	440,095,135
1	-Klientë për licencë (Klientë të arkëtueshëm) (Klientë hequr licenca)	<u>105,063,600</u> 15,678,871 89,384,729	<u>121,708,368</u> 13,912,683 107,795,685
2	-Klientë për tarifën shërbime RTV (Klientë të arkëtueshëm) (Klientë hequr licenca)	<u>7,550,440</u> 1,908,145 5,642,295	<u>7,981,265</u> 2,222,272 5,758,993
3	-Klientë për gjoba	<u>296,793,722</u>	<u>284,466,822</u>
4	-Klientë për kamatë vonesa (Klientë për kamatëvonesa për autorizime/licenca) (Klientë për kamatëvonesa për gjoba)	<u>28,302,962</u> 5,866,587 22,436,375	<u>25,938,680</u> 3,502,305 22,436,375
III.	Të tjera kërkesa ndaj të tretëve	5,297,652	5,709,452
	- Detyrim për kthim shumash nga ish-punonjës -Diferenca nga shteti për tatime dhe taksa -Parapagime ndaj të tretëve, gjoba personale etj.	2,709,156 5,483 2,583,013	3,117,156 6,283 2,586,013
IV.	Mbështetje financiare për projekte të vitit në vazhdim	5,096,500	7,200,000
V.	Arka dhe Banka	181,773,130	159,634,374
B.	Aktivet afatgjata (I - II)	158,450,318	164,700,148
I.	Studime dhe kërkime neto	38,290,211	32,768,791
II.	Aktive të qëndrueshme neto	120,160,107	131,931,357
	- Inventar ekonomik - Instalime teknike, pajisje, vegla pune - Mjete transporti - Shpenzime për ndërtesa administrative	2,936,308 28,634,024 6,172,429 82,417,346	6,877,491 30,784,179 6,858,255 87,411,432
C.	Pasivet (I-IV)	792,454,406	782,505,011
I.	Fondet e veta	232,862,405	198,253,306

II.	Transferta nga MF për Fushatën e Informimit të Publikut për Digjitalizimin	105.000.000	105.000.000
III.	Rezultati ushtrimor i vitit	87,540,767	63,426,653
IV.	Detyrimet afatshkurtra ndaj të tretëve (1 - 6)	367,051,234	415,825,052
1	-Personeli, deficite dhe gjoba	23,007	-
2	-Detyrime mbi klientë për shtetin, për tatime, gjoba dhe kamatëvonesa	309,647,539	300,862,783
3	-Detyrime ndaj furnitorëve	1,059,893	10,312,396
4	-Detyrime ndaj shtetit për tatime dhe kontribute	1,291,168	1,350,599
5	-Kreditorë të viteve të mëparshme (të ndjekura me përmbarues)	55,029,627	103,023,975
6	-Kreditorë për mjete në ruajtje (në formë garancie)	-	275,300
AKTIVE - PASIVE ((A+B)-C))		-	-

ANEKS 1

“ TË DHËNAT E MONITORIMIT TË EDICIONEVE KRYESORE NË OSHMA-të KOMBËTARE¹

Janar 2021

Subjektet	TCH		KLAN		RTSH1		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS		CLUB FM	
	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %
Qeveria	19,83	0,1727	49,02	0,2671	34,25	0,2106	89,85	0,4073	7,4	0,1848	30,52	0,0529	2,23	0,2193
Partia Demokratike	3,58	0,0312	43,48	0,237	30,43	0,1871	27,6	0,1251	4,93	0,1232	70,17	0,1217	1,23	0,1211
Kryeministria	54,92	0,4781	61,08	0,3329	45	0,2767	69,38	0,3145	18,18	0,4542	58,45	0,1014	3,72	0,365
Partia Socialiste	9,92	0,0863	8,97	0,0489	10,95	0,0673	5,17	0,0234	3	0,0749	24,87	0,0431	0,58	0,0573
Presidenca	6,65	0,0579	4,9	0,0267	13,4	0,0824	3,38	0,0153	1,57	0,0391	21,85	0,0379	1,6	0,1571
Partia Lëvizja Socialiste për Integrim	4,25	0,037	0	0	3,67	0,0225	18,88	0,0856	1,67	0,0416	3,87	0,0067	0	0
Parlamenti	1,28	0,0112	1,7	0,0093	8,17	0,0502	4,32	0,0196	0,83	0,0208	0,78	0,0014	0	0
Zv/ Ministra të tjerë	0	0	1,6	0,0087	7,28	0,0448	0	0	0	0	6,68	0,0116	0,33	0,0327
Partia Republikane	2,32	0,0202	7	0,0381	0	0	0	0	0,78	0,0196	6,55	0,0114	0,48	0,0475
Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	0,42	0,0036	0,93	0,0051	2,03	0,0125	0	0	0,72	0,0179	6,63	0,0115	0	0
Partia Demokristiane	0,58	0,0051	0	0	0	0	0	0	0,57	0,0142	5,6	0,0097	0	0
Partia Agrare Ambientaliste	1,05	0,0091	1,53	0,0084	0	0	0	0	0,38	0,0096	5,42	0,0094	0	0
Partia Bindja Demokratike	1,95	0,017	0	0	0	0	0	0	0	0	5,28	0,0092	0	0
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3,4	0,0059	0	0
Partia Lëvizja për Ndryshim	1,93	0,0168	0	0	2,7	0,0166	0	0	0	0	2,78	0,0048	0	0

¹ Në muajin prill 2021 nuk ka pasur të dhëna, pasi është monitoruar mbulimi i fushatës për zgjedhjet e përgjithshme nga OSHMA-të

Shkurt 2021

Subjektet	TCH		KLAN		RTSH1		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS		CLUB FM	
	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %
Qeveria	13,22	14,37%	38,07	16,56%	46,9	20,72%	92,1	37,92%	13	31,91%	47,93	17,43%	1,8	10,43%
Partia Demokratike	2,78	3,03%	71,33	31,04%	54,53	24,10%	46,85	19,29%	3,67	9,00%	78,33	28,48%	3,93	22,80%
Kryeministria	47,12	51,23%	73,38	31,93%	64,55	28,52%	56,5	23,26%	15,43	37,89%	54,7	19,89%	6,25	36,23%
Partia Socialiste	7,82	8,50%	19,62	8,54%	9,85	4,35%	7,32	3,01%	0	0	28,03	10,19%	0,63	3,67%
Partia Lëvizja Socialiste për Integrim	1,2	1,30%	0	0	2,18	0,96%	9,78	4,03%	0,42	1,02%	25,53	9,28%	0,63	3,67%
Presidenca	5,27	5,73%	12,23	5,32%	22,43	9,91%	13,43	5,53%	4,85	11,91%	15,85	5,76%	2,05	11,88%
Parlamenti	7,98	8,68%	6,52	2,84%	12,78	5,65%	8,52	3,51%	0,98	2,41%	4,08	1,48%	0,3	1,74%
Partia Republikane	0	0	1,17	0,51%	1,38	0,61%	2,35	0,97%	0,7	1,72%	10,1	3,67%	0	0
Zv/ Ministra të tjerë	0	0	3,05	1,33%	6,87	3,03%	0	0	0	0	0	0	0,43	2,51%
Partia Bindja Demokratike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	6,05	2,20%	0	0
Partia Fryma e Re Demokratike	4,72	5,13%	0,38	0,17%	0	0	0	0	0,5	1,23%	0	0	0	0
Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2,62	0,95%	0	0
Partia Lëvizja për Ndryshim	1,7	1,85%	1,37	0,59%	2,55	1,13%	1	0,41%	0	0	1,83	0,67%	0,45	2,61%
D Deputet i Pavarur	0,17	0,18%	0	0	1,28	0,57%	0,13	0,05%	0	0	0	0	0	0

Mars 2021

Subjektet	TCH		KLAN		RTSH1		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS		CLUB FM	
	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %
Partia Socialiste	47,4	26,68%	63,85	17,92%	43,43	20,90%	32,5	23,04%	8,98	19,60%	102,55	26,98%	3,98	25,48%
Partia Demokratike	22,47	12,65%	70,12	19,68%	52,25	25,15%	32,72	23,20%	9,03	19,71%	89,58	23,57%	3,27	20,90%
Kryeministria	40,8	22,96%	53,95	15,14%	40,02	19,26%	21,67	15,36%	11,43	24,95%	35,43	9,32%	1,5	9,59%
Qeveria	12,82	7,21%	33,03	9,27%	44,28	21,31%	23,82	16,89%	7,87	17,16%	43,58	11,47%	2,22	14,18%
Presidenca	4,28	2,41%	6,88	1,93%	16,22	7,80%	12,47	8,84%	4,45	9,71%	21,62	5,69%	3,08	19,72%
Partia Lëvizja Socialiste për Integrim	8,93	5,03%	0,75	0,21%	1,3	0,63%	7,55	5,35%	2,32	5,05%	16,67	4,38%	0,35	2,24%
Partia Bindja Demokratike	1,87	1,05%	1,22	0,34%	0	0	0	0	0	0	7,23	1,90%	0	0
Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	7,22	1,90%	0	0
Partia Republikane	6,47	3,64%	1,15	0,32%	0	0	2,78	1,97%	0,67	1,45%	1,27	0,33%	0	0
Parlamenti	4,7	2,65%	4,33	1,22%	5,62	2,70%	4,17	2,95%	1,08	2,36%	3,3	0,87%	0,55	3,52%
Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5,52	1,45%	0	0

Maj 2021

Subjektet	TCH		KLAN		RTSH1		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS		CLUB FM	
	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %
Partia Demokratike	66,38	51,30%	67,68	34,78%	53,92	30,14%	43,65	22,17%	22,9	37,40%	77,43	32,82%	5,12	40,61%
Qeveria	5,37	4,15%	36,6	18,81%	43,33	24,22%	62,22	31,60%	4,75	7,76%	77	32,64%	0	0
Kryeministria	7,33	5,67%	46,43	23,86%	33,77	18,87%	30,1	15,29%	7,47	12,19%	22,8	9,66%	1,88	14,95%
Partia Socialiste	14,82	11,45%	8,13	4,18%	21,13	11,81%	25,93	13,17%	8,33	13,61%	21,07	8,93%	1,22	9,66%
Parlamenti	15,92	12,30%	20	10,28%	12,78	7,14%	18,9	9,60%	7,77	12,68%	17,95	7,61%	2,05	16,27%
Presidenca	6,77	5,23%	5,38	2,77%	10,6	5,92%	12,23	6,21%	6,62	10,81%	12,3	5,21%	2,13	16,93%
Partia Agrare Ambientaliste	3,8	2,94%	1,58	0,81%	0,6	0,34%	0	0	0,6	0,98%	0	0	0	0
Zv/ Ministra të tjerë	0	0	3,67	1,88%	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Deputet i Pavarur	2,95	2,28%	0,05	0,03%	0,53	0,30%	1,83	0,93%	0,38	0,63%	0	0	0	0
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2,53	1,07%	0	0
Partia Bindja Demokratike	2,48	1,92%	0	0	1,25	0,70%	0	0	0,42	0,68%	0	0	0	0
VV Vetëvendosja	0	0	2,1	1,08%	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Partia Lëvizja Socialiste për Integrim	2	1,55%	1,72	0,88%	1	0,56%	0	0	0,9	1,47%	0	0	0,2	1,59%
Partia Republikane	1,58	1,22%	0	0	0	0	0	0	1,1	1,80%	0	0	0	0
Partia Demokristiane	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1,13	0,48%	0	0
Parti të tjera	0	0	0	0	0	0	1,05	0,53%	0	0	0	0	0	0
Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare	0	0	0,57	0,29%	0	0	0	0	0	0	0,47	0,20%	0	0

Qershor 2021

Subjektet	TCH		KLAN		RTSH1		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS		CLUB FM	
	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %
Qeveria	19,75	22,19%	78,57	44,32%	45,1	24,88%	101,77	56,83%	8,47	19,15%	72,45	36,28%	2,52	26,22%
Partia Demokratike	34,68	38,97%	25,47	14,36%	49,78	27,46%	21,35	11,92%	16,27	36,79%	58,52	29,30%	2,27	23,61%
Kryeministria	15,25	17,13%	51,18	28,87%	44,32	24,45%	36,98	20,65%	8,73	19,75%	29,88	14,96%	2,7	28,13%
Parlamenti	2,35	2,64%	1,33	0,75%	14,13	7,80%	5,68	3,17%	2,33	5,28%	2,9	1,45%	0,37	3,82%
Partia Socialiste	10,78	12,12%	9,77	5,51%	13	7,17%	8,53	4,77%	2,7	6,11%	11,12	5,57%	0	0
Deputet i Pavarur	0,42	0,47%	0	0	11,42	6,30%	0	0	0,48	1,09%	9,38	4,70%	0	0
Presidenca	5,77	6,48%	2,22	1,25%	3,52	1,94%	3,25	1,81%	3,95	8,93%	8,9	4,46%	1,48	15,45%
Zv/ Ministra të tjerë	0	0	3,85	2,17%	0	0	0	0	0	0	6,55	3,28%	0	0
Partia Lëvizja Socialiste për Integrim	0	0	0	0	0	0	1,52	0,85%	0,57	1,28%	0	0	0,27	2,78%
Partia Aleanca Demokristiane	0	0	0	0	0	0	0	0	0,72	1,62%	0	0	0	0

Korrik 2021

Subjektet	TCH		KLAN		RTSH1		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS		CLUB FM	
	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %
Qeveria	6,07	7,78%	40,77	32,46%	42,4	32,91%	91,38	57,66%	2,45	8,82%	43,27	27,08%	0,77	18,18%
Partia Demokratike	34,78	44,58%	41,7	33,20%	31,67	24,58%	23,65	14,92%	10,77	38,75%	61,92	38,76%	1,6	37,94%
Kryeministria	24,82	31,81%	37,65	29,98%	32,08	24,90%	23,4	14,76%	10,97	39,47%	25,47	15,94%	1,5	35,57%
Partia Socialiste	3,47	4,44%	1,43	1,14%	5,72	4,44%	3,25	2,05%	1,57	5,64%	21,67	13,56%	0	0
Zv/ Ministra të tjerë	0	0	0,78	0,62%	6,87	5,33%	7,62	4,81%	1,35	4,86%	0	0	0	0
Parlamenti	3,12	3,99%	2,18	1,74%	5,4	4,19%	2,38	1,50%	0	0	4,58	2,87%	0,35	8,30%
Presidenca	1,8	2,31%	1,08	0,86%	3,8	2,95%	1,83	1,16%	0	0	1	0,63%	0	0
Partia Republikane	3,07	3,93%	0	0	0	0	1,8	1,14%	0,68	2,46%	1,47	0,92%	0	0
Partia Lëvizja Socialiste për Integrim	0,47	0,60%	0	0	0	0	1,45	0,91%	0	0	0	0	0	0
Deputet i pavarur	0,43	0,56%	0	0	0,92	0,71%	0	0	0	0	0,38	0,24%	0	0

Gusht 2021

Subjektet	TCH		KLAN		RTSH1		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS		CLUB FM	
	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %
Qeveria	5,05	7,78%	35,15	38,23%	55,6	53,69%	44,02	72,54%	5,03	38,08%	88,7	67,36%	1,88	25,11%
Kryeministria	16,95	26,10%	40,43	43,97%	23,23	22,43%	8,03	13,24%	2,67	20,18%	25,28	19,20%	1,15	15,33%
Partia Demokratike	18,18	28,00%	13,88	15,10%	14,32	13,82%	6,92	11,40%	3,85	29,13%	8,37	6,35%	2,17	28,89%
Partia Socialiste	12,55	19,33%	0,52	0,56%	0	0	0	0	0	0	6,5	4,94%	0,4	5,33%
Zv/Ministra të tjerë	2,27	3,49%	1,5	1,63%	6,55	6,32%	0	0	0	0	2,1	1,59%	0	0
Presidenca	4,58	7,06%	0,47	0,51%	2,78	2,69%	0	0	0,38	2,90%	0,73	0,56%	1,57	20,89%
Partia Lëvizja Demokratike Shqiptare	2,12	3,26%	0	0	0	0	1,72	2,83%	0,78	5,93%	0	0	0	0
Partia Lëvizja Socialiste për Integrim	0	0	0	0	1,08	1,05%	0	0	0,5	3,78%	0	0	0,33	4,44%

Shtator 2021

Subjektet	TCH		KLAN		RTSH1		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS		CLUB FM	
	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha /min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %
Partia Demokratike	48,43	32,08%	63,38	40,14%	45,28	26,31%	25,15	21,63%	13,02	28,81%	91,25	43,12%	3,75	28,34%
Kryeministria	24,62	16,30%	46,48	29,44%	62	36,03%	34,13	29,35%	17,3	38,29%	43,23	20,43%	3,02	22,80%
Qeveria	10,72	7,10%	16,02	10,14%	23,43	13,62%	35,18	30,25%	5,72	12,65%	46,65	22,05%	3,08	23,30%
Partia Socialiste	31,97	21,17%	9,32	5,90%	11,17	6,49%	11,95	10,28%	3,7	8,19%	13,73	6,49%	1,58	11,96%
Parlamenti	30,58	20,25%	12,63	8,00%	18,33	10,65%	8,03	6,91%	3,23	7,16%	7,48	3,54%	0,53	4,03%
Presidenca	2,85	1,89%	5,88	3,73%	8,77	5,09%	1,63	1,40%	2,22	4,91%	4,08	1,93%	0,73	5,54%
Partia Lëvizja Socialiste për Integrim	1,83	1,21%	0,15	0,09%	0	0	0,22	0,19%	0	0	5,17	2,44%	0,27	2,02%
Deputet i Pavarur	0	0	4,05	2,56%	1,13	0,66%	0	0	0	0	0	0	0	0
Zv /Ministra të tjerë	0	0	0	0	1,98	1,15%	0	0	0	0	0	0	0	0

Tetor 2021

Subjektet	TCH		KLAN		RTSH1		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS		CLUB FM	
	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %
Partia Demokratike	52,92	35,63%	71,68	37,61%	58,93	31,01%	37,25	17,27%	17,15	30,93%	123,38	42,92%	6,18	29,78%
Qeveria	30,25	20,37%	41,78	21,92%	54,52	28,68%	101,5	47,06%	15,03	27,11%	56,3	19,58%	4,38	21,11%
Kryeministria	23,7	15,96%	52,93	27,77%	33,98	17,88%	30,63	14,20%	10,13	18,27%	33,85	11,78%	4,68	22,55%
Partia Socialiste	15,48	10,42%	8,65	4,54%	13,82	7,27%	17,88	8,29%	5,9	10,64%	31,03	10,80%	2,55	12,28%
Parlamenti	21,95	14,78%	12,28	6,44%	21,93	11,54%	19,85	9,20%	3,45	6,22%	11,33	3,94%	2,18	10,51%
Partia Lëvizja Socialiste për Integrim	2,08	1,40%	0	0	0,98	0,52%	6,03	2,80%	0,37	0,66%	19,9	6,92%	0,22	1,04%
Partia Demokristiane	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	6,55	2,28%	0	0
Presidenca	1,92	1,29%	0	0	3,4	1,79%	1,85	0,86%	2,13	3,85%	2,62	0,91%	0,55	2,65%
Zv/ Ministra të tjerë	0	0	3,27	1,71%	2,5	1,32%	0	0	0	0	0	0	0	0
Partia Republikane	0	0	0	0	0	0	0	0	0,33	0,60%	0	0	0	0
Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	0,23	0,16%	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Partia për Bashkimin dhe të Drejtat e Njeriut	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Nëntor 2021

Subjektet	TCH		KLAN		RTSH1		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS		CLUB FM	
	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %
Partia Demokratike	45,57	29,40%	81,18	37,37%	58,93	26,52%	29,45	14,25%	12,43	22,83%	139	43,83%	6,9	29,74%
Kryeministria	37,52	24,21%	64,33	29,61%	61,92	27,87%	50,9	24,63%	18,98	34,86%	68,85	21,71%	4,67	20,11%
Qeveria	19,13	12,35%	32,45	14,94%	45,62	20,53%	66,55	32,21%	9,52	17,48%	31,43	9,91%	5,12	22,05%
Parlamenti	30,12	19,43%	11,65	5,36%	26,67	12,00%	32,15	15,56%	5,1	9,37%	18,05	5,69%	0,97	4,17%
Partia Socialiste	13,23	8,54%	14,8	6,81%	12,8	5,76%	17,2	8,32%	3,92	7,19%	19,93	6,29%	2,07	8,91%
Presidenca	5,63	3,64%	4,48	2,06%	10,82	4,87%	6,28	3,04%	3,37	6,18%	11,22	3,54%	2,25	9,70%
Partia Lëvizja Socialiste për Integrim	1,53	0,99%	0	0	0	0	0	0	0,72	1,32%	8,3	2,62%	0,37	1,58%
Zv /Ministra të tjerë	0	0	1,58	0,73%	0	0	0	0	0	0	6,45	2,03%	0	0
Partia Agrare Ambientaliste	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	6,37	2,01%	0	0
Partia Bindja Demokratike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	5,85	1,84%	0	0
Partia Republikane	1,93	1,25%	3,02	1,39%	2,57	1,16%	2,22	1,07%	0,42	0,77%	1,53	0,48%	0,28	1,22%
Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	0,3	0,19%	0	0	0,37	0,17%	0,28	0,14%	0	0	0	0	0	0

Dhjetor 2021

Subjektet	TCH		KLAN		RTSH1		R.TIRANA		TAR		VIZION PLUS		CLUB FM	
	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/ min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/%	koha/min	koha/ %	koha/min	koha/ %
Partia Demokratike	92,65	58,89%	126,55	50,98%	88,27	40,66%	70,08	39,37%	34,43	50,15%	183,83	61,72%	7,93	43,04%
Kryeministria	31,25	19,86%	59,02	23,77%	60,37	27,81%	39,68	22,29%	13,42	19,54%	46,48	15,61%	4,53	24,59%
Qeveria	17,47	11,10%	45,83	18,46%	34,47	15,88%	36,32	20,40%	10,52	15,32%	42,33	14,21%	3,07	16,64%
Partia Socialiste	5,53	3,52%	3,38	1,36%	12,37	5,70%	4,18	2,35%	2,98	4,34%	7,6	2,55%	0,6	3,25%
Parlamenti	4,45	2,83%	5,25	2,11%	11,8	5,44%	10,02	5,63%	3,92	5,70%	7,13	2,39%	0,35	1,90%
Presidenca	5,98	3,80%	3,48	1,40%	5,83	2,69%	6,3	3,54%	3,4	4,95%	4,32	1,45%	1,38	7,50%
Partia Lëvizja Socialiste për Integrim	0	0	0	0	2,15	0,99%	0	0	0	0	4,73	1,59%	0,57	3,07%
Partia Lëvizja për Zhvillim Kombëtar	0	0	0	0	1,57	0,72%	1,05	0,59%	0	0	1,43	0,48%	0	0
Zv/ Ministra të tjerë	0	0	1,42	0,57%	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Partia për Bashkimin dhe të Drejtat e Njeriut	0	0	0	0	0,28	0,13%	0	0	0	0	0	0	0	0

ANEKS 2

ÇËSHTJET GJYQËSORE KU ËSHTË PALË AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

ÇESHTJE GJYQËSORE NË GJYKIM NË GJYKATAT E SHKALLËS SË PARË				
Nr.	Paditës/I paditur	Objekti	Faza gjyqësore në të cilën ndodhet procesi	Fituar/ Humbur në fazën aktuale
1	Paditës: AMA I paditur: Tv Kabllor Saranda	Detyrime financiare	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Fituar/Lidhur kontratë me shërbimin përmbarimor
2	Paditës: AMA I paditur: Tv Kabllor Devi-E.R.I.	Detyrime financiare	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Pushuar/Shlyer detyrimi në mënyrë vullnetare
3	Paditës: Edi Tanushi I paditur: AMA	Shfuqizimi i vendimit të AMA-s, nr. 111, datë 11.07.2019, që ka lënë në fuqi vendimin për dënimin me gjobë nr. 9, datë 24.04.2019.	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Shkodër	Fituar/ Lidhur kontratë me shërbimin përmbarimor
4	Paditës: AMA I paditur: Vlora Channel sh.p.k.	Detyrime financiare	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Fituar/Lidhur kontratë me shërbimin përmbarimor
5	Paditës: AMA I paditur: Shoqëria “Teknomedia” sh.p.k. (Nesër TV)	Detyrime financiare	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Pezulluar (deri në përfundim të themelit në Apel të çështjes për rinovimin e licencës)

6	Paditës: AMA I paditur : Shoqëria “RTV RE.AL” sh.p.k.	Detyrime financiare	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Pushuar/ Likuiduar detyrimi në mënyrë vullnetare
7	Paditës: Bibë Tanushi I paditur: AMA	Shfuqizimi i vendimit të AMA-s, nr. 19, datë 06.02.2019, që ka lënë në fuqi vendimin për dënimin me gjobë nr. 31, datë 14.11.2018.	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Mospranimi i padsisë
8	Paditës: Edi Tanushi I paditur: AMA	Shfuqizimin e vendimit të AMA-s, nr. 163, datë 07.11.2019, për mosrinnovimin e autorizimit të subjektit person fizik Edi Tanushi.	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Fituar
10	Paditës: AMA I paditur: Liberta Thanza (Tv Kabllor Drini)	Detyrime financiare	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Fituar
11	Paditës: AMA I paditur: Individit Hajri Hoxha/ HB-CA	Detyrime financiare	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë	Pushuar/shlyer detyrimi në mënyrë vullnetare
12	Paditës: AMA I paditur: Shoqëria “Triangle Media Group”/ City TV	Detyrime financiare	Në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë Vendimi ka marrë formë të prerë	Fituar
